

EDUKIMI QYTETAR PËR VITIN IV

për shkollat e mesme profesionale

Autor:

Gordana Trajkova Kostovska

Recensentë:

Dr. Emil Sulejmani
Vesna Stefanovska
Gordana Arsovska

Lektor i botimit në maqedonisht:

Violeta Jovanovska

Redaktor teknik:

Gordana Trajkova Kostovska

Përgatitja kompjuterike:

Maja Cvetkova

Përkthyes:

Arkin Jahiji

Redaktim profesional:

Prof. dr. Agim Poloska

Lektor i botimit në shqip:

Rolland Poloska

Botues:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë

Shtypi:

Qendra grafike shpkp, Shkup

Tirazhi:

3.000

Me vendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë nr. 22-4250/1 të vitit 28.07.2010 miratohet përdorimi i këtij libri

CIP – Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св.Климент Охридски” , Скопје
316(075.3)

ТРАЈКОВА Костовска, Гордана

Граѓанско образование за средни стручни училишта / Гордана Трајкова Костовска. -
Скопје : Министерство за образование и наука на Република Македонија, 2010. -
119,

[7] стр. : илустр. ; 30 см

Терминолошки речник: стр. [120-123]. - Библиографија: стр. [126]

ISBN 978-608-226-092-1

COBISS.MK-ID 84256778

Hyrje

Libri Edukimi Qytetar është për nxënësit e shkollave të mesme profesionale. Në këtë libër janë përpunuar përmbajtje nga gjashtë tema kryesore, të cilat kanë të bëjnë me lidhjet e ndërsjella ndërmjet shoqërisë dhe individit.

Përmbajtja është e ndarë si tekst bazik dhe është në funksion të fitimit të njohurive bazike, por edhe si tekst shtesë, i cili është në funksion të shpjegimit dhe të zgjerimit të njohurive të nxënësit.

Përmbajtja themelore është e pasuruar me fotografi, karikatura, grafikone, të cilat e shpjegojnë tekstin themelor. Ato i japin librit qartësi më të madhe.

Të gjitha pjesët përmbajtjes janë shënuara me shenja të veçanta. Ja cilat janë ato.

TITULLI I TEMËS

MËSONI MË
TEPËR

KARIKATURA


DIAGRAMI

TITULLI I MËSIMIT


MBANI MEND

FOTOGRAFIA

Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato



NJERIU, SHOQËRIA, KULTURA



Njeriu si qenie natyrore dhe shoqërore...1

Individi dhe shoqëria ...8

Si hulumtojmë individin dhe shoqërinë10

Kultura...12

Identiteti kulturorë, relativizmi kulturor, etnocentrizmi ...16

Vlerat, normat, zakonet ...20

Religjioni...21

Socializimi ...24

Devijimet shoqërore...27

GRUPACIONET SHOQËRORE



Unë ndërmjet të tjerëve ...30

Rolet shoqërore ...33

Grupet në shoqëri ...35

Familja ...38

Grupet nëpër pozicione (Shtresat dhe lëvizshmëria) ... 40

Grupet etnike ...42

Dallimet gjinore ...44

UNË QYTETARI



Çfarë jemi si qytetarë dhe si banorë ...48

Çfarë nënkuptojmë me pushtet dhe për çfarë shërben ...50

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut ...53

Të drejtat dhe liritë qytetare dhe politike... 55

Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore... 58

Demokracia dhe karakteristikat e saj themelore... 62


Shteti demokratik dhe format tjera të rregullimit shtetëror ..64

Shoqatat qytetare ...67

Përfaqësimi politik – zgjedhjet..70

Sistemi politik në Republikën e Maqedonisë ...73

UNË, PRONAR, PRODHUES, KONSUMUES



Nevojat, puna, prodhimi,
konsumimi ...78
Ndarja shoqërore e punës
dhe specializimi ekonomik ...80
Pronësia dhe kapitali ...83
Tregu dhe paraaja ...88
Shteti dhe tregu ... 94
Llojet e ndërmarrjeve ...101

Politika demografike
(planifikimi i familjes)...106
Mbrojtja sociale dhe
politika sociale ...108
Sigurimi social...110
Ekologjia – mbrojtja e mjedisit
jetësor... 112
Aktiviteti humanitar ...113

NE NË EVROPË DHE NË BOTË



Bota moderne dhe
globalizimi i saj...114
Evropa dhe
integrimet e saj ...116
Maqedonia në Evropë
dhe në botë ...119

JETA SHOQËRORE DHE POLITIKA SOCIALE




Popullsia, struktura, lëvizjet...104



Njeriu si qenie natyrore dhe shoqërore

Në pyetjen se çfarë është njeriu, mund të fitohen shumë përgjigje. Nëse i pyetni biologët ata menjëherë do t'ju përgjigjen se njeriu (qenie njerëzore) bën pjesë në llojin e Homo Sapiensit dhe se të afërmit e tij më të ngushtë janë Shimpanza, gorilla dhe orangutangët.

Pohimet e këtilla bazohen në teorinë e Darvinit mbi evolucionin të quajtur sipas emrit të natyralistit të njohur anglez Çarls Darvin. Ai zbuloi se njeriu, si edhe majmunët e sotëm me pamje të njeriut kanë paraardhës të përbashkët – paramajmunët. Ata gjatë evoluimit të gjatë janë zhvilluar në dy drejtime. Disa u rritën në majmunë me pamje të njeriut dhe të tjerët u zhvilluan në njeri.



Për biologët njeriu është krijesë natyrore. Ai si edhe krijesat tjera të gjalla lind, i përmbush nevojat e veta biologjike, zhvillohet, plakët dhe vdes dhe prandaj themi se edhe për atë vlejné ligjet e natyrës.

Por, prapseprapë, njeriu ka disa veçori kryesore, të cilat nuk i hasim madje edhe te llojet më të zhvilluara të shtazëve. Ata e bëjnë njeriun krijesë natyrore të llojit të veçantë.

Njeriu ec drejt. Drejtshmëria i mundëson të jetë fizikisht aktiv dhe ta njohë botën rreth tij.

Aftësia e të menduarit. Derisa shtazët në luftën për ekzistencë mbështeten në instinktet e veta, njeriu atë e arrin me ndihmën e aftësisë të mendojë dhe të krijojë. Inteligjenca i mundëson atij të mësojë, të fitojë njohuri, të hulumtojë dhe ta kuptojë botën në një mënyrë tjetër.

Të folurit e artikuluar dhe përdorimin e gjuhëve të ndryshme, simbolet, mjetet për komunikim i mundësojnë njeriut të bashkëpunojë me njerëzit tjerë, t'i mbartë njohurit nga gjenerata në gjeneratë.

Njeriu jeton në bashkësi dhe punon. Kjo nuk është karakteristikë vetëm e njeriut. Edhe shtazët jetojnë në bashkësi dhe punojnë, por jeta e njeriut është shumë më komplekse. Zhvillohet në bashkësinë e quajtur shoqëri. Prandaj, njeriu është edhe qenie shoqërore. Për shembull, në një familje bletash ekziston rend dhe organizim. Puna është e ndarë dhe secila bletë, në varësi të moshës së saj bën detyrë të caktuar. Disa i ushqejnë larvat, të tjerat mbajnë nektarin, ndërsa të tjerat e ftohin kutinë. Por, gjithë këtë bletët e bëjnë në mënyrë të pavetëdijshme.

Njeriu është i veçantë për shkak se ai punon me vetëdije, me plan dhe me qëllim të paracaktuar.

Në secilën shoqëri, pa marrë parasysh sesa është e zhvilluar, ekzistojnë rregulla. **Njeriu i respekton rregullat.** Ato i tregojnë se çka është mirë dhe e dobishme për bashkësinë dhe çka jo dhe sipas tyre ai e drejton sjelljen e tij.

INDIVIDI DHE SHOQËRIA



Identiteti im ai që më bën të mos jem i njëjtë me asnjë individ tjetër

Njerëzit jetojnë në shoqëri. Shoqëritë dallohen sipas madhësisë së territorit të cilin e zënë dhe sipas numrit të banorëve, të cilët jetojnë në atë territor. Për këtë arsye themi se disa shoqëri janë më të mëdha dhe më në numër dhe të kundërtën. Për të mbijetuar në shoqëri, njerëzit duhet të bashkëpunojnë. Ata, deshën apo jo, janë në kontakt edhe kur prodhojnë ushqim, edhe kur ndërtojnë vendbanime, edhe kur i rrisin pasardhësit e tyre. Ata bashkëpunojnë në të gjitha fushat e jetesës së përbashkët meqë vetëm ashtu mund të mbijetojnë. Por, parashtrohet pyetja: si mund njerëzit të jetojnë bashkë dhe të bashkëpunojnë kur çdo njeri është individ në vete, kurse individët dallohen sipas temperamentit, arsimit, edukimit, mënyrë së të menduarit, stilit të jetesës dhe të ngjashme. Për t'u përgjigjur në këtë pyetje duhet të dihet se jeta në grupe është më e ndryshme nga jeta personale. Edhe pse njerëzit dallohen sipas cilësive të veta, prapseprapë, kur duhet të arrihet ndonjë qëllim i përbashkët, ata fillojnë të mendojnë ndryshe dhe të sillen më ndryshe. Qëllimi i përbashkët i afron dhe i bën më të ngjashëm. Për ata interesat personale bëhen më pak të rëndësishme. Individët

i përdorin cilësitë e veta personale për t'i ndihmuar grupit të arrijë qëllimin e përbashkët.

Përta arritur qëllimin, njerëzit përcaktojnë rregulla të përbashkëta të sjelljes. Nuk ekziston fushë e jetesës së përbashkët në të cilën nuk ekzistojnë rregulla. Si do të dukej një ndeshje futbolli nëse nuk do të ekzistonin rregulla. Si do të lëviznin veturat dhe këmbësorët pa rregullat e komunikacionit. Rregullat e rregullojnë jetën në shoqëri dhe prandaj çdo individ duhet të mësojë të sillet në pajtim me këto rregulla.

Shpesh individët nuk pajtohen me rregullat, të cilat i krijon shoqëria e tyre, për arsye se mendojnë se ato ua rrezikojnë identitetin personal. Në këtë rast, ata e shprehin pakënaqësinë e tyre në mënyra të ndryshme.

Jeta e njerëzve në shoqëri, në masë të madhe, varet nga ajo sesa ata janë të përgatitur të jetojnë bashkë. Mosnjohja e vetvetes dhe të tjerëve është arsyeja për intolerancën ndërmjet njerëzve, e cila mund të rezultojë me armiqësi, me dhunë madje edhe me luftë.

Si njerëzit mësojnë për njëri-tjetrin?

Përmes njohjes së identiteteve njerëzit fitojnë informacione për njëri-tjetrin, formojnë parafytyrime të sakta për veten, shoqërohen dhe bashkëpunojnë. Në këtë mënyrë, ata e përforcojnë ndjenjën e pjesëmarrjes në shoqëri.



Çdo njeri ka identitet. Edhe ju keni identitet dhe për ta përcaktuar duhet t'i parashtrosh disa pyetje: kusha jam unë? Kujt i përkas? Si sillem?

Identiteti juaj është, në të vërtetë, gjithë ajo çka ju bën të ndryshëm nga çdo personalitet tjetër. Identiteti është mënyrë të njihesh me vetveten, çfarë pikëpamje keni për botën, cilat vlera dhe norma i respektoni, si është sjellja juaj ndaj njerëzve tjerë, por edhe të mësosh çfarë mendojnë të tjerët për ju.

Secili ka identitet personal dhe social.

Identiteti personal është vlerësim që e jep individit për vetveten (si duket, çfarë personi është, çfarë dëshira dhe ambicie ka).

Identiteti social e tregon vendin dhe rolin e individit si anëtar të ndonjë grupi në shoqëri. Sa do të ketë sukses të përshtatet në grup, në shoqëri, më së tepërmi varet nga identiteti i tij personal.

Ja një shembull. Të përpigemi të përcaktojmë identitetin e një individit, i cili jeton në Amerikë, rregullisht shkon në

meshë në kishën katolike, është anëtarë i partisë republikane, nuk punon, është i martuar, ka tre fëmijë, me prejardhje etnike është italian.

Nga ky shembull mund të vijmë në përfundim:

Identiteti gjinor - përmes të cili mund të përcaktojmë nëse individit është burrë apo grua; **plak/i rritur** - përmes të cilit mund të përcaktojmë nëse individit nuk është fëmijë, por i rritur, **shtetësia** - nga i cili mësojmë se ai është Amerikan, **etnik** - ka prejardhje italiane; **identiteti fetar** - i cili na zbulon se individit është katolik.

Nga e dhëna se individit është anëtar i partisë republikane mësojmë se cili është **identiteti partiak** i tij. **Identiteti profesional** i individit në shembullin tonë nuk mund të përcaktohet, për shkak se ai është i papunësuar, por ai ka **identitet familjar**, për shkak se është i martuar dhe ka tre fëmijë.

Individi ka edhe **identitet kulturorë** për shkak se në shoqërinë amerikane në të cilën jeton ekzistojnë vlera, norma dhe ligje të caktuara. Ky lloj identiteti është mjaft i rëndësishëm. Ai u mundëson individëve të ndjehen si pjesëtarë të një kulture, të kenë prirje të njëjta ose të ngjashme, ide dhe aspirata, gjuhë të përbashkët, traditë, vlera, mënyra të sjelljes.

Aktivitet hulumtues

Zbuloni identitetin personal. Përshkruani se çfarë pëlqeni më së tepërmi nga vetvetja. Përpiqu t'i njoftosh identitetet e të gjithë atyre me të cilët jeton, shoqërohesh, bashkëpunon. Kontrolloni sa i njihni të tjerët përreth. Pastaj, shkruani një ese në të cilën do të shpjegoni çfarë është ajo që do të ndryshoni në identitetin personal. Përcaktoni nëse është e nevojshme të ndryshoni sjelljen ndaj dikujt.

SI E HULUMTOJMË INDIVIDIN DHE SHOQËRINË (METODOLOGJIA)

Problemet dhe fenomenet e lidhura me individin dhe shoqërinë gjithmonë kanë qenë dhe do të jenë fushë e gjerë për hulumtim e një numri të madhe shkencëtarësh: historianë, sociologë, antropologë, ekonomistë, shkencëtarët politik, psikologë. Të gjithë këta kanë qasje të ndryshme të hulumtimit në varësi nga ajo çfarë dëshirojnë të mësojnë për fenomenin e hulumtuar. Kështu, për shembull, për një sociolog, i cili dëshiron të hulumtojë problemin e papunësisë në Republikën e Maqedonisë do të jetë me rëndësi të mësojë nëse shkalla dhe lloji i arsimit të njerëzve do të ketë ndikim në përqindjen e papunësisë dhe si papunësia ndikon mbi ardhmërinë e rinisë. Historiani papunësinë do ta kishte hulumtuar më ndryshe. Ai me siguri do të dëshironte të zbulojë cilat masa janë marrë nga ana e qeverisë për parandalimin e papunësisë në Republikë nga ana e qeverisë, për parandalimin e papunësisë në Republikën e Maqedonisë nga viti 1991 e deri më sot. Një ekonomist me siguri do të hulumtonte sesi do të jetë ekonomia pas 20 viteve, nëse gradualisht rritet numri i të papunëve, kurse antropologu do të donte të zbulojë nëse midis të papunëve në Republikën e Maqedonisë ka më tepër burra apo gra, në cilën moshë janë dhe çfarë prejardhje etnike kanë. Të gjitha këto qasje në hulumtime zbulojnë nga ndonjë aspekt, ndonjë karakteristikë për papunësinë në Republikën e Maqedonisë, por edhe perspektiva të ndryshme: sociologjike, historike, antropologjike, etj.

Sot hulumtimet e fenomeneve dhe proceset shoqërore më së shpeshti kanë qasje multidisiplinore. Për shkak të kompleksitetit të fenomeneve të cilat hulumtohen është e domosdoshme përfshirja e hulumtuesve nga fusha të ndryshme shkencore.

Kjo është dëshmi se hulumtimi i problemeve dhe gjendjeve të lidhura me njeriun dhe shoqërinë është shumë punë e vështirë. Pikërisht për këtë në hulumtimet shkencore ekzistojnë një numër i madh i metodave dhe teknikave përmes së cilave arrihet deri te të vërtetat objektive për fenomenet në shoqëri.

Për secilin hulumtim së pari duhet të përgatitet projekt hulumtues në të cilin duhet qartë të përcaktohet tema për studim, çështja hulumtuese, metodat (procedurat) dhe teknikat të cilat do të përdoren gjatë hulumtimit.

Gjatë hulumtimit të fenomeneve shoqërore më shpesh përdoren: metoda sociometrive, eksperimentale, statistikore dhe metoda e analizës së përmbajtjes. Prej teknikave më shpesh përdoret intervista, anketa dhe testi.

Metoda e mbikëqyrjes. Mbikëqyrja është metodë, e cila mundëson t'i ndjekim dhe t'i regjistrojmë fenomenet, të cilat duam t'i hulumtojmë. Përmes kësaj metode, hulumtuesi ka mundësi në mënyrë direkte të mbikëqyrë ndonjë fenomen, person, por me një plan të parapërcaktuar. Kështu, për shembull, mund të mbikëqyret ndonjë person ose grup njerëzish, sjelljen e tyre, temperamentin, të folurit dhe të ngjashme.

Metoda sociometrive. Kjo metodë më shpesh përdoret për hulumtimin e grupeve të vogla në shoqëri (paraleleve, klasës, familjes). Përmes tij shumë lehtë dhe në mënyrë adekuate analizohen raportet e anëtarëve të grupës, pozicionin e secilit individ në grup, në çfarë mënyrë zgjedhet udhëheqësi i grupës dhe të ngjashme. Rezultatet e fituara nga metoda sociometrive analizohen, kurse në mënyrë grafike prezantohen me sociogram.

Metoda e eksperimentit. Eksperimenti është veprim me të cilin shkaktohet fenomeni, i cili duhet të hulumtohet. Pas paraqitjes së tij, hulumtuesi të njëjtin e ndjek, e përshkruan, e analizon, për të ardhur deri te njohuritë e caktuara.

Eksperimenti si procedurë më së shpeshti bëhet në kushte laboratorike dhe nga ato në masë të madhe varet se çfarë rezultate do të fitohen (hapësira, temperatura, ndriçimi, ngjyra e mureve dhe të ngjashme.) Eksperimenti me rregull realizohet në dy grupe:

- Eksperimentale (me të cilën në mënyrë artificiale shkaktohet fenomeni);
- kontrolluese (tek e cila nuk shkaktohet fenomeni).

Rezultatet e fituara nga të dy grupet krahasohen dhe nxirren përfundime të caktuara.

Metoda e analizës së përmbajtjes përdoret për studimin e dokumenteve të shkruara (ligjeve, tekstet e gazetave, shkrimet historike). Me këtë metodë përcaktohet përmbajtja, mesazhi i dokumenteve, rëndësia e disa nocioneve dhe termeve në dokumente (për shembull nga veprat e mendimtarëve antikë mësuam për format e demokracisë dhe të ngjashme.).

Metoda statistikore (mbledhja, klasifikimi, interpretimi dhe analiza e të dhënave) i ndihmon hulumtuesit për ta parashikuar zhvillimin e ardhshëm të ngjarjeve dhe shoqërinë në tërësi.

Intervista është bisedë e përgatitur prej përpara për një problem të caktuar. Shfrytëzohet për mbledhjen e të dhënave, të cilat janë të nevojshme për qëllimin e vetë hulumtimit. Personi, i cili e udhëheq dhe e drejton bisedën, është pyetësi (intervistuesi), ndërsa ai i cili përgjigjet në pyetjet e parashtruara është i pyeturi (i intervistuari). Intervista me rregull duhet të bëhet me individë, posaçërisht kur pyetjet, të cilat i parashtrohen të intervistuarit gjatë intervistës, janë të natyrës intime.



Anketa është instrument më tepër i përhapur për mbledhjen e të dhënave gjatë hulumtimit. Paraqitet në formë të pyetësorit (listë anketuese) në të cilën të anketuarit i shprehin mendimet ose qëndrimet e veta në lidhje me ndonjë problem. Zakonisht përmban pyetje të cilat të anketuarit ose duhet të shkruajnë ndonjë përgjigje ose të rrethojnë njërën prej përgjigjeve të ofruara.

Testi është instrument matës, i cili përbëhet nga detyrat e zgjedhura sipas kriterëve të caktuara. Shfrytëzohet për kontrollimin dhe përcaktimin e njohurive të fituara (çfarë dituri dhe aftësi posedon ndonjë person) ose cilët janë aftësitë e tij. Testi duhet të standardizohet, për shkak se rezultatet e testit maten dhe vlerësohen, kurse pastaj krahasohen. Shembull më i mirë për këtë janë testet përmes të cilave përcaktohen dituritë dhe arritjet e nxënësve në fund të arsimit të mesëm katërvjeçar në Republikën e Maqedonisë (matura shtetërore, provimi përfundimtar).



Maturantët duke bërë testin e ditorisë

KULTURA

Njerëzit dhe kafshët dallohen. Përveç sipas pamjes, inteligjencës, të ecurit, të ushqyerit, ekzistojnë edhe dallime në mënyrën e të jetuarit. E vërtetë edhe se disa kafshë dhe zogj ndërtojnë vendbanime, punojnë shumë sikurse njerëzit, por të gjithë atë e bëjnë për të mbijetuar me ndihmën e instikteve të tyre.

Për dallim nga kafshët, njerëzit gjithçka e bëjnë me planifikim. Për ata nuk është e mjaftueshme vetëm të mbijetojnë.

Ata dëshirojnë ta lehtësojnë dhe ta zbukurojnë jetën. Prandaj ndërtojnë vendbanime



moderne dhe rrugë, konstruktojnë ura dhe aeroplanë, hapin shkolla, fakultete dhe arsimohen. Gjatë punës përdorin pajisje moderne, kompjuterë, bisedojnë në largësi me telefona mobil, zbulojnë ilaç edhe vaksina të reja, vizatojnë dhe shkruajnë romane. Duke e shfrytëzuar natyrën njeriu krijon botën e vet në të cilën dallohen shumë nga kafshët, por edhe nga pjesëtarët e shoqërive tjera. Ajo botë quhet Kulturë.

Në jetën e përditshme shumë shpesh e përdorim fjalën kulturë. Kështu, për shembull, për ndonjërin i cili vepron dhe sillet në kundërshtim me pritjet tona themi se është i pakulturë. Për atë i cili lexon shumë, shkon në teatër dhe shikon shumë filma themi se është i ngritur (në kulturë). Ndërsa nëse shkojnë për darkë me shokët në ndonjë restorant luksoz dhe jemi të kënaqur nga shërbimi,

ushqimi dhe atmosfera aty, atëherë dimë të themi se në restorant ka kulturë organizative.


Termi kulturë rrjedh nga fjala latine “**cultus**” – që fillimisht kishte kuptimin e kultivimit, përpunimit të fushave. Edhe sot ky term ka domethënien e njëjtë. Kështu, për shembull, kur duam të themi se buqësia në një shtet është më e zhvilluar në krahasim me tjerat, atëherë themi se në atë shtet kultivohet agrikultura.

Kohët e fundit, ky term më tepër përdoret në rëndësinë e kulturës shpirtërore (përkujdesjen dhe kultivimin e shpirtit të njeriut). Për këtë shkak ky term përdoret në rëndësinë e shpirtit të arsimuar dhe të fisnikëruar tek njeriu.

Njeriu krijon kulturë. Teoricienti anglez Eduard Teylor e njohu lidhjen e njeriut (si anëtar i shoqërisë) dhe kulturës dhe prandaj pohoi se jashtë shoqërisë nuk ka kulturë.

Kulturën e krijojnë njerëzit për ta lehtësuar jetën, por edhe për t'i përmbushur disa nevoja. Njerëzit përveç se të punojnë kanë nevojë edhe të vizatojnë, të lexojnë,





të hulumtojnë, të merren me sport, të udhëtojnë dhe zbavitën. Në këtë mënyrë ata përmirësohen si personalitete.

Ç' përfshin kultura?

Shkencëtarët e përkufizojnë kulturën në mënyra të ndryshme. Njëra prej përkufizimeve më të pranueshme gjerësisht është ajo e Tayllorit sipas së cilës *“kultura është tërësi komplekse, e cila i përfshin: diturinë, besimet, artin, moralin, ligjet, zakonet dhe cilatdo aftësi dhe shprehje, të cilat kërkohen nga njeriu si anëtar i shoqërisë”*.

Secila kulturë përfshin:

- **sistem vlerash** të cilat mundësojnë drejtimin e sjelljes së njeriut, ndërtimin e qëndrimeve, raportet, dituritë dhe aftësitë;
- **Organizimi, implementimi dhe rezultatet** e aftësive të përgjithshme të njerëzve në të gjitha sferat e jetës dhe të punës;



- **sistem simbolesh**, me ndihmën e të cilave realizohet komunikimi, njihen domethëniet e fenomeneve dhe proceseve në shoqëri ose ndërmjet shoqërive të ndryshme. Në atë sistem të simboleve bëjnë pjesë: gjuha, gjestet, formularët e sjelljes, motivet, idetë, sendet e shenjta dhe të ngjashme;
- **memoria e përbashkët**: mbartja e përvojës së gjeneratës (dituri, mjeshtëri, aftësi). Me të cilën gjenerata nuk krijon kulturë prej fillimi, por ajo mbartet dhe përsoset, ndryshohet nga brezi në brez;
- **Normat** me të cilat realizohen vlerat dhe mbrohen interesat e shoqërisë. Ato tregojnë sesi duhet të sillen njerëzit.

Detyrë



Shkruani një ese në temën: Kultura e të rinjve në Maqedoni. Udhëzues për esenë le të jenë pyetjet vijuese:

1. Si është sistemi i vlerave të të rinjtë deri në moshën 18 vjeçare? Cilat vlera më së tepërmi i çmojnë?
2. Cilat norma të sjelljes ndërmerren nga më të rriturit, dhe cilat janë të reja? Përmendini shembujt për konfliktet më të shpeshta midis gjeneratave.
3. Sipas cilës memorie të përbashkët do të mbahet mend gjenerata e juaj? Cilat janë simbolet e saj kulturore?

Sipas kësaj mund të përfundojmë se kulturën e përbëjnë edhe urat edhe aeroplanët, kompjuterët, kishat, dituritë, arsimit, arti, besimet, zakonet, gjuha, sjellja, dituritë dhe aftësitë në jetën e përditëshme dhe puna, kujtimet, parashikimet, ligjet dhe ligjshmëritë dhe shumë gjera të tjera pa të cilat nuk do të mund të paramendohej jeta e njeriut.

Ngjashmëritë kulturore, dallimet kulturore, të përgjithshmet kulturore

Secila kulturë ndërton vlera të ndryshme sipas të cilave është e vetme dhe e papërsëritshme. Por, kulturat janë edhe të ndryshueshme si rezultat i proceseve të kontakteve të ndërsjellta. Në ato kontakte shpesh arrihet deri te njohuritë për dallimet dhe ngjashmëritë e elementeve të atyre kulturave të vendosura në një kohë dhe hapësirë të caktuar.

Elementet, të cilat hasen pothuajse në të gjitha shoqëritë, quhen ngjashmëri kulturore.



Ushqimi gjindet gjithkund, vetëm se përgatitet në mënyra të ndryshme

Kështu për shembull, në secilën kulturë njerëzit flasin në një gjuhë të caktuar, miratojnë vlera të ndryshme, besojnë në zot, sillen sipas disave modele të sjelljes dhe të ngjashme. Në të gjitha kulturat ekziston institucioni martesë dhe rregullimi i marrëdhënieve familjare. Të gjitha kulturat shfrytëzojnë zbulimet më të larta shkencore. Në secilën prej tyre haset nocioni për bukurinë, pjesëtarët e

së cilës kulturë praktikojnë ceremoni të caktuara fetare.


Edhe pse kulturat paraqesin tërësi të formuara në mënyrë të veçantë, secila prej tyre përmban elementet vijuese:

- **Pikëpamja e botës** në të cilën janë përgjigjet e pyetjeve, të cilat i parashtron njeriu për botën, jetën dhe pozicionin e njeriut në botë;
- **Sistemet e vlerave;**
- **Institucionet** në të cilat zhvillohen proceset kulturore (shkollat, universitetet, muzetë, teatri, bashkësitë fetare;
- **gjuha** si formë e komunikimit ndër-njerëzor;
- **Shkencat aplikative, teknologjia, mjetet për punë, prodhimi i të mirave materiale.**

Elementet janë të përbashkëta për të gjitha kulturat quhen të përgjithshmet kulturore. Ato llogariten si bazë e përshtatshme për mirëkuptim midis kulturave dhe për krijimin e një **kulture universale për gjithë njerëzimin.** Ideja për një kulturë të tillë është e rëndësishme, posaçërisht në botën moderne në të cilën zhvillohen proceset e globalizimit, e lidhjeve politike dhe ekonomike në botë. Sipas sociologëve, kjo kulturë është parakusht bazik për kapërcimin e dallimeve kulturore.



Ngjashmëri në pjesët e veshjeve maqedonas dhe turke si rezultat i përzierjes së kulturave.



A janë dallimet e tyre më të mëdha se ngjashmëritë?

Kur do të gjenden pika të përhershme të ndërsjella në dy kultura të ndryshme, ato në mënyrë aktive ndikojnë njëra mbi tjetrën. Kështu është rasti me lidhjen pesëqindvjeçare ndërmjet kulturës turke dhe maqedonase gjatë periudhës së Perandorisë Osmane. Kjo prekje e kulturave quhet transkulturim. Dëshmi për këtë është ekzistimi i ngjashmërive në veshjet popullore, zakonet, ushqimet

dhe të ngjashme. Ekzistimi i elementeve të përbashkëta në kulturë nuk d.m.th se kulturat janë të njëjta. Ndërmjet tyre ekzistojnë dallime, të cilat dalin nga shkalla e zhvillimit të tyre dhe nga vlerat e miratuara.

Kështu, për shembull, nga kulturat varet çfarë do të shfrytëzohet për ushqim, cila grua do të llogaritet e bukur, lindja e bineqëve a do të llogaritet vlerë apo turp, sa gjatë do të mbahet zi i vdekuri dhe të ngjashme.



Mësoni më tepër

Përderisa te popujt evropianë mishi i derrit është i dëshirueshëm në sofër, myslimanët aspak nuk e konsumojnë atë. Në Indi besimtarët nuk e përdorin mishin e lopës. Në një fis australian nëna e mbyt njërin nga bineqtët, për shkak se sipas mendimit të tyre vetëm kafshët lindin më tepër se një. Në një fis tjetër, në luginën e lumit Kongo nënës dhe bineqve u tregohet respekt i madh. Tek shumë popuj grua e bukur llogaritet

ajo e cila ka më tepër peshë. Tek një fis i Filipinëve është vërejtur se nëna për fëmijën dhe gruaja për burrin mbajnë zi vetëm një ditë. Te disa fise (në Sibir dhe ishujt Fixhi), besohet se secili e vazhdon jetën pas varrit prej në atë gjendje në të cilën ka vdekur. Prandaj, detyrë e djalit të mirë ishte ta vrasë babanë para se të jetojë deri në moshë të thyer, me qëllim që jeta pas vdekjes të mos jetë më e rëndë dhe me tortura.

Identiteti kulturor, relativizmi kulturor dhe etnocentrizmi



Njerëzit nuk e zgjedhin kulturën. Ata bëjnë pjesë në ndonjë kulturë me vetë lindjen e tyre. Nga ai moment jeta e tyre është e përcaktuar nga kultura në të cilën bëjnë pjesë. Ajo u mundëson ta ndërtojnë identitetin e tyre kulturor. Përmes tij individët njihen ndërmjet veti, bëhen të veçantë dhe me cilësë të papërsëritshme. Për këto arsye individët, më tutje, gjatë jetës së tyre janë të gatshëm të mbrojnë identitetin e tyre kulturor. Jo rrallë tregojnë edhe gatishmëri për të sakrifikuar për atë.

Detyrë



Lexoni tekstin, pastaj përpikuni ta përcaktoni identitetin kulturor të Indianëve Navaho.

Në njërën nga shkretëtirat më të mëdha të amerikës shikohen turbullt kullat e errëta me gurrë të cilat e përbëjnë vendbanimin e lashtë të fisit Navaho të quajtur Lugina e përmendoreve. Jeta aty zhvillohet njëjtë si edhe para qindra ose më tepër vitesh. Rajoni rrethohet me kanione, maje vullkanike dhe vargmale ku mbizotëron ngjyra e gjelbër e mbyllur. Kjo tokë e bukur shkakton admirim te vizitorët dhe prandaj, Indianët Navaho janë më tepër të lidhur me atë. Por, krejt çështje tjetër është sesi këta njerëz sigurojnë mjete për jetë në atë bukuri natyrore. Njëqind vjetët e para ishin ushqyer me fruta lokale të egra dhe kanë gjuajtur egërsira. Më vonë janë marrë me bujqësi dhe me blegtori, të cilat i mësuhan nga Indianët Pueblo. Për fat të keq, toka në të cilën jetojnë fisi Navaho mundëson ruajtjen vetëm të disa kulturave bujqësore. Shkalla e vdekshmërisë të ky fis është e lartë. Për shkak se ju dukej se me jetën e tyre menaxhon stihia Indianët Navaho krijuan religjion dhe mënyrë të tillë të jetesës, e cila u ngjall ndjenjë të sigurisë. Shumë nga Zotërat e mirë dhe të këqij këta Indianë i shprehën në gurrë rrerh vendbanimeve të tyre. Sipas besimit të tyre në tokë zotëron perëndesha e quajtur Nëna e ndryshimeve. Ata jetojnë në podrume primitive të quajtura Hogan, pa dritare, kurse hyrja gjithmonë është e kthyer kah lindja në mënyrë që të mund ta përshëndesin Shpirtin e diellit i cili lind. Koka e familjes është zakonisht gruaja më plakë. Afërsia familjare caktohet sipas nënës. Familja është qeliza, bazë e familjes. E përbëjnë gratë, burrat e tyre dhe fëmijët e tyre të pamartuar. Burri është shef dhe gjithçka varet nga personaliteti i tij, por roli i gruas është shumë më e fuqishme. Dashuria e fëmijëve për nënën është e fuqishme, për shkak se babai shpesh mungon. Burrat merren me

përpunimin e lëkurës, sende të arit, marrin pjesë në ceremoni fetare. Udhëtojnë deri në qendrat tregtare. Detyra e tyre më e pëlqyer është ndërtimi i djepit të fëmijës së lindur. Kjo detyrë ka rëndësi rituale. Për ndërtimin e tij përdoren dy lloj të dëllinjave në varësi të asaj nëse fëmija është djalë ose vajzë. Materiali për djepin nuk duhet të jetë nga druri, i cili ka qenë i goditur nga vetëtimja, si dhe në atë nuk duhet të ketë gjurmë të arushës. Druri duhet të rritet në një vend të vetmuar, të jetë i lartë, me moshë të caktuar, i drejtë dhe i shëndoshë. Para se të fillohet me ndërtimin, babai stërpik drurin me pluhur të polenit dhe lutet. Kur djepi është gati, prindërit e vendosin fëmijën brenda dhe i këndojnë këngë. Por, kjo nuk është e gjitha. Djepi luan rol edhe në përfshirjen e fëmijës në jetën familjare dhe prandaj, ai ndreqet. Kur fëmija do gjendet ballë për ballë me anëtarët e tjerë të familjes, atëherë ndjen se u takon atyre.

Për shkak të mbrojtjes së identitetit të tyre, për shkak të pamundësisë të kuptohet kultura e huaj, shpesh individët e lavdërojnë kulturën e vet, kurse e nënvlerësojnë kulturën e të tjerëve. Madje shkojnë edhe më tutje sa që shikojnë me tallje. Këtë fenomen sociologët e quajnë etnocentrizëm.

Si reagim i etnocentrizimit krijohet relativizmi kulturor. Sipas këtij mendimi të gjitha kulturat janë njëjtë të vlefshme për respekt. Për ato nuk mund të sillen aktgjykime. Kulturat mund të kuptohen nga brenda, kur do të zbulohen mënyrat sesi vjen dashuria, lumturia, vlerat, lindja, vdekja, raportet ndërmjet njerëzve, etj.

Gjuha


Gjuha është pjesë përbërëse e secilës kulturë. Prandaj, ajo paraqet vlerë e përgjithshme kulturore. Me ndihmën e gjuhës shënohen elementet e kulturës, kuptimet e saj, besimet, vlerat. Pa gjuhë asnjë kulturë nuk do të mund të zhvillohet dhe të bartet brez pas brezi.

Njeriu jetën e vet e kalon në grupe me njerëz të tjerë. Një nga faktorët më të rëndësishëm, i cili mundëson të përbashkëtën është gjuha. Gjuha paraqet mjet për komunikim midis njerëzve dhe për drejtimin e aktiviteteve të tyre. Ajo është njëra nga sistemet më të rëndësishme të simboleve pa të cilat njeriu nuk është në gjendje të mendojë. Anëtarët e shoqërisë e shfrytëzojnë gjuhën për këmbim të aftësive, përvojave, qëndrimeve dhe ndjenjave të tyre, jo vetëm me ata njerëz të cilët gjenden në afërsinë e tyre, por edhe me pjesëtarët e kulturave të tjera të cilët janë më të largëta edhe në kohë edhe në hapësirë. Prandaj, gjuha zë vend të rëndësishëm në jetën dhe punën e njerëzve.



Gjuha është sistem i artikulimit dhe me rregulla gramatikore dhe simbole standarde, komunikim i ndërmjetësuar përmes së cilës shënohen, komunikojnë, dhe këmbëjnë fakte, ide dhe ndjenjat e pjesëtarëve të një komuniteti.

Secila gjuhë përbëhet nga të folurit dhe nga shkrimi.



Të folurit është aftësi e përgjithshme e njeriut për t'u shprehur në një mënyrë të artikulimit, ndërsa gjuha është vetëm manifestim konkret i atyre mundësive.

Shkrimi është posaçërisht i rëndësishëm për komunikimin e gjeneratave dhe të komunikimit në hapësirë. Pjesa më e madhe e diturive dhe përvojave tona ishin mundësuar me paraqitjen e shkrimit.

Në botë fliten me mijëra gjuhë, kështu që në botën moderne bëhen përpjekje për përpilimin e një "gjuhe" që do të ishte e përbashkët për të gjithë, dhe e cila përbëhet nga elemente të gjuhëve të cilën e flasin pjesa më e madhe e njerëzve në botë (për shembull "esperanto"). Gjuha

është mënyrë më e përshtatshme për përhapjen e ndikimit të kulturës, dhe me këtë edhe ndikimet ekonomike dhe politike, kështu që disa kultura bëjnë përpjekje që gjuhën e vet t'ua imponojnë komuniteteve të tjera të shoqërisë.

Detyrë



Përpikuni të zbuloni pse në botë më tepër flitet gjuha angleze.

Subkultura dhe kultura kundër

Shoqëritë moderne shpesh janë të mëdha dhe përfshijnë një numër grupesh, të cilat praktikojnë mënyra të ndryshme të jetesës. Në ato njerëzit kanë interesa të ndryshme, pikëpamje, vlera dhe sjellje të ndryshme, mënyra të jetesës dhe të ngjashme.

Me nocionin subkulturë (nënkulturë) shprehet veçantia kulturore e një shtrese të shoqërisë, grup, pjesëtarë të mjedisve qytetare ose fshatare, dallueshmëri gjenerate në sjelljet kulturore, e kështu me radhë. Kështu, për shembull, modeli i përgjithshëm kulturor i Maqedonasve dallohet me: respektimin e vlerave tradicionale, shfrytëzimin e gjuhës kombëtare, respektimin e veprave të larta të artit, rregulla të caktuara të sjelljes, sistem të vlerave, religjionin ortodoks sllav, etj. Por në kuadër të këtij modeli të përgjithshëm do të ishin: subkultura e të rinjve, subkultura e qytetarëve dhe fshatarëve, e Shqiptarëve, e Turqve, dhe subkulturat e komuniteteve të tjera etnike në Maqedoni, subkultura e avokatëve, subkultura e elitës.

Një lloj i subkulturës me specifikimet e veta ndikon mbi kulturën dominante. Ajo nuk do të bëjë ndryshime të mëdha mbi atë, por, megjithatë, do të sjellë risi: në muzikë, ushqim, zbavitje, veshje dhe të ngjashme. Në këtë kuptim, veprimi i subkulturës është pozitiv dhe kontribuon për zhvillimin e mëtutjeshëm të kulturës dominante, pasurimin e saj, ndryshimin e shijeve, përparimin në gjuhë, etj.

Megjithatë, përveç se pozitivisht, subkulturat mund të kenë edhe ndikim negativ mbi kulturën dominante.



Të rinjtë dallohen sipas interesit dhe mënyrës së jetesës.

Të tilla janë kundërkulturat (kulturat kundër). Pjesëtarët e këtyre subkulturave veprojnë në dy drejtime: ose në mënyra radikale të ndryshojnë jetën ekzistuese shoqërore dhe kulturore në drejtim të jetës më humane ose janë destruktiv në mënyrë që të shkatërrojnë vlera shumë të rëndësishme shpirtërore pa të cilat nuk do të mund të mbahej bashkësitë shoqërore dhe bashkësitë kulturore. Të tillë janë: narkomanët, krimi, dhuna, prostitucioni dhe etj.


Shembull për kundërkulturën është ajo hipive kah fundi i viteve 60 të shekullit të kaluar, grup i të rinjve mënyra e jetesës e të cilëve është në kundërshtim me atë të shoqërisë në të cilën jetojnë.

Në vitin 1955 në perëndim u krijua një kulturë e re e të rinjve. Besohet se krijimi i saj vijoi menjëherë pas shfaqjes së filmave: “rebel pa arsye” dhe “i egri”, ku, posaçërisht, flitet për rebelimin e gjeneratës së re kundër botës së të rriturve, me qëllim të kërimit të vlerave të reja.

Një kundërkulturë në veçanti është edhe tendenca e të rinjve kur i vizitojnë koncertet e yjet e reja muzikore, entuziazmi i tyre ta lidhin me dhunë. Ritmi dhe entuziazmi

i tyre i përbashkët shkaktojnë tek ata instinkte shkatërrim (thyejnë karrige, gota, inventar, etj.).

Shoqëria moderne në masë të madhe është shënuar me të ashtuquajturën kulturë masive. Ajo është tendencë për qetësimin e vlerave kulturore në kuadër të një shoqërie dhe ndërmjet kulturave në botë.



Njëra nga ikonat karakteristike të kulturës masive

Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato



1. Përcaktojini nocionet subkulturë dhe kundërkulturë .
2. Sugjeroni dhe përshkruani shembuj për subkulturën dhe kundërkulturën në mjedisin tuaj. Kush janë bartësit e tyre?

Vlerat, normat dhe zakonet

Kultura e çdo shoqërie përfshin një numër të madhe të elementeve. Midis tyre me një rëndësi të veçantë janë ato përmes të cilave ajo e siguron mbijetesën e saj, gjegjësisht përmes së cilave shoqëria drejton, e udhëheq dhe e kontrollon sjelljen e anëtareve të saj. Elementet e tilla janë: vlerat, normat dhe zakonet.

Vlerat

Secila shoqëri, grup shoqëror dhe individ, posedojnë qëllime dhe ideale të ndryshme drejt të cilave kanë tendencë të afrohen, të cilat e drejtojnë veprimin e tyre dhe i japin kuptim jetës dhe sjelljes së tyre. Vlerat paraqesin ide të përgjithshme për atë se çka është e mirë, çka është e keqe, çka është e vërtetë, e dëshirueshme dhe e bukur, dhe çfarë e rrejshme, e shëmtuar dhe të ngjashme. Vlerat janë bazë e mënyrës së përgjithshme të jetesës së njerëzve. Të tilla janë: liria, patriotizmi, dashuria, miqësia, nderi, lojaliteti, etj.

Secila shoqëri ka një numër të madh vlerash,, por të gjitha nuk janë njësoj të rëndësishme. Në disa shoqëri vlerë më e madhe është suksesi material, por në disa shoqëri më tepër çmohet tradita (njerëzit drejtohen kah e kaluara dhe u shërben si orientim bazik i jetës).

Vlerat rriten në mënyrë spontane, gjatë socializimit dhe jetës së përbashkët të njerëzve. Vlerat e formuara njëherë mbahen për një periudhë të gjatë. Ato janë pjesa më e përjetshme e kulturës dhe njëkohësisht më e rezistueshme ndaj ndryshimeve.

Normat dhe zakonet

Normat ekzistojnë për të arritur qëllimet të cilat dalin nga vlerat e një kulture. Normat janë pjesë e kulturës njerëzore në përgjithësi, pjesë e jetës së përditshme. Përmes tyre çdo individ e përshtat sjelljen e vet me sjelljen e të tjerëve. Ato njëkohësisht janë edhe rregulla (shembuj të sjelljes) në shoqëri. *Tregojnë se çka është në bashkësinë shoqërore sjellje e arsyeshme, e pranueshme dhe e dëshirueshme e një individëve në situata të caktuara.*

Ekzistojnë më tepër lloje të normave të cilat kanë një rëndësi të madhe për shoqërinë. Të tilla janë: normat morale, normat juridike dhe zakonet.

Zakonet e përkufizojnë atë që në shoqëri është e drejtë. Ato janë rregulla në



Disa norma dhe zakone tradicionale praktikohen edhe sot

aktivitetet e përditshme të njerëzve. Për shembull, mënyra e veshjes, shprehitë gjatë ushqimit, mikpritja, zakonet gjatë takimit me njerëz tjerë e kështu me radhë. Ata të cilët nuk i respektojnë, të tjerët i përqeshin, i marrën nëpër gojë dhe të ngjashme.

Normat morale

Normat morale paraqesin rregulla më të rrepta nga zakonet. Ato tregojnë se si duhet të veprohet. Ato janë rregulla, të cilat e përkufizojnë të mirën dhe të keqen, të pranueshmen dhe të pritshmen.

Normat morale dallohen njëra nga tjera në shoqëri, por ekzistojnë edhe norma universale të cilat mund t'i takojmë në të gjitha shoqëritë. Disa prej tyre paraqesin ndalesa të rrepta të sjelljes të cilat quhen tabu, për shembull, incesti (ndalesa e marrëdhënieve seksuale midis farefisit të afërm), kanibalizmi dhe të tjera.

Normat juridike

Normat juridike paraqesin rregulla të shkruara dhe rreptësisht të sanksionuara të sjelljes së individëve në shoqëri. Zakonisht i cakton shteti (parlamenti, qeveria, ministritë). Por, normat juridike sjellin edhe ndërmarrjet, shoqatat, kisha, etj.

Paralelisht me sjelljen e normave, shoqëria sjell edhe metoda adekuatë (lëvdata dhe dënime) se si të sigurohet respektimi i tyre (sanksione). Për shkeljen e disa normave, sanksionet janë më të vogla, kurse për disa janë të rrepta dhe përfshijnë gjoba, dënime me burg etj. Njeriu u përshtatet normave dhe për fitimin e njohjeve të caktuara shoqërore (lëvdata, çmime dhe të tjera).

Kontrollojini njohurit tuaja dhe përdorini ato



1. Cilat vlera në Republikën e Maqedonisë më së tepërmi vlerësohen (çmohen). Shpjegoni pse?
2. Çfarë është për ju vlerë më e lartë?
3. Përkrahja e një zakoni, i cili praktikohet te pjesëtarët e bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë.

RELIGJIONI

Çfarë nënkuptojmë me religjion?

Religjioni është njëri nga kulturat dhe fenomenet shpirtërore më të përhapura. Ai është i pranishëm në secilën shoqëri të njerëzve gjatë tërë zhvillimit njerëzor. Paraqitet në forma nga më të ndryshmet të besimit dhe të ritualeve. Ai vështirë mund të përkufizohet. Shpesh përcaktohet si besimi në një Zot, si shpjegim sesi u krijua bota, është e barabartë me mbinatyroren, me normat morale, të cilat i kontrollojnë sjelljen e besimtarëve dhe të ngjashme.

Religjioni është sistem ngusht i lidhur i besimit dhe praktikave të cilat vlejnë për sendet e shenjta dhe të cilat i lidhin mbështetësit e këtij sistemi në një bashkësi të vetme morale.



Shpjegoni rëndësinë religjioze të piramidave.

Ekziston një numër i madh i religjioneve. Në thelb, ato kanë elemente të përbashkëta, besime dhe rituale.

Besimet janë ide, që njerëzit i kanë në lidhje me natyrën e sendeve të shenjta dhe me mënyrat si duhet të komunikohet me ato.

Ritualet janë aktivitete, të cilat ndërmerren me qëllim që të realizohet raporti i dëshiruar me botën e shenjtërisë. Kjo do të thotë se njerëzit duhet të besojnë, së pari, në ndonjë qenie të mbinatyrshme,



Sinagogë

ndërsa pastaj të kryejnë aktivitete me të cilat vendoset raport me atë.

Religjioni ka për qëllim të kënaqë disa nevoja reale të njeriut. Ai u ndihmon: ta kalojë frikën nga e panjohura dhe të ardhmen e pasigurtë; t'i japë kuptim ekzistencës së vet përmes orientimit kah vlerat morale dhe t'i kalojë momentet e krizës në jetë.

Por, religjioni ka funksion të caktuar edhe në shoqëri.

Ai përmes vlerave tradicionale e mban rendin shoqëror;



Buda

ndihmon në kontrollin e devijimit shoqëror; e afirmon idenë e barabarësisë ndërmjet njerëzve. Ai ndihmon individët ta zhvillojnë ndjenjën e pjesëmarrjes në bashkësi, ndjenjën për ndihmën reciproke dhe mbështetjen.

Religjionet e mëdha botërore

Pamja fetare e botës moderne është shumë e larmishme, megjithatë, në botë ekzistojnë pesë religjione të mëdha, të cilat për shkak të përhapjes nëpër botë e kanë fituar edhe epitetin religjione botërore. Të tilla janë: judaizmi, krishterimi, islami, budizmi dhe konfuizmi.

Judaizmi, krishterimi dhe islami janë religjione monoteiste (mono ka kuptimin e një), për shkak se bazohen në mësimin në të cilin ekspozohet ideja e ekzistimit të një Zoti.

Judaizmi është religjion i bazuar në rreth 1300 vjetëve p.e.s dhe është religjion më i vjetër monoteist. Sot ai ka një numër më të vogël të besimtarëve për shkak se u rrëfhet vetëm anëtarëve të popullit hebre. Profeti i tij ishte Musa, i cili i shpalli rregullat themelore të jetës fetare, të njohura si Dhjetë Urdhëresat.

Dhjetë urdhëresa:

Unë jam Zoti Perëndia jote, mos ashure perëndi tjetër përveç Meje.

Mos bëj idhuj ose figurë të asaj që është lart në qiell, që është poshtë në tokë dhe që është në ujë, nëntokë, mos iu përkul dhe mos iu shërbe.

Mos e përdor gabimisht emrin e Perëndisë tënde.

Përkujtoju për ditën e pushimit në mënyrë që të festosh, gjashtë ditë punoni dhe mbaroni të gjitha punët, kurse të shtatën ditë kushtojani Zotit, Perëndisë tënde.

Respektojini atin dhe nënën tuaj që të jesh më mirë dhe të jetosh më gjatë në tokë.

Mos vrit.

Mos shkel kurorën.


Mos vidh.

Mos dëshmo rrejshëm kundër të afërmit tuaj.

Mos dëshiro asgjë që është e huaj.

Krishterimi është religjion, i cili u nda nga judaizmi dhe është i përhapur në botë. Themeluesi i tij ishte Jezu Krishti, i cili sipas mësimit krishter është djalë i Zotit. Supozimi i tij themelor është se shoqëria duhet të transformohet në Perandori të Zotit të bazuar në dashuri dhe mirëkuptim ndërmjet njerëzve. Si religjion shtetëror krishterimi ishte pranuar në vitin 313 dhe prej atëherë shpejt u zgjerua në kuadër të Perandorisë romake dhe jashtë saj. Në shekullin e XI krishterimi u nda në atë katolik dhe atë ortodoks, kurse më vonë me Reformimin filluan të ndahen edhe shumë fraksione të tjera të krishterimit.

Islami është themeluar në vitin 622 të erës sonë në Medine në Gadishullin Arabik.



Besimtarët e islamit

Si themelues llogaritet Muhamedi i quajtur Profet, i cili jetoi në shekullin e shtatë. Mësimi i Muhamedit u zgjerua midis popujve të shtresës së ulët në Lindjen e Afërt, kurse më vonë edhe më gjerë. Sipas numrit të besimtarëve është religjioni i dytë në botë.

Pesë shtyllat kryesore të Islamit janë:

Thënia e deklaratës: Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, kurse Muhamedi është rob i tij.

Namazi: pesë herë në ditë me fytyrë të drejtuar kah Meka, Arabia Saudite, të cilit i paraprin marrja e abdesit.

Agjërimi i Ramazanit, agjërim një mujor, nuk hahet dhe nuk pihet nga agimi deri në perëndimin e diellit.

Zekati (dhënia e ndihmës në të holla për të varfërit).

Shkuarja në Haxh: do të shkojë për pelegrinazh në Mekë së paku njëherë në jetë.

Budizmi dhe konfuçizmi janë religjione dominante në Lindjen e largët. Gjithashtu, janë të njohura si religjione etnike për shkak se sipas mësimit të tyre, deri te shpëtimi personal mund të

arrihet vetëm në qoftë se njeriu në këtë botë jeton sipas rregullave të moralit.

Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato



1. Cilat elemente duhet t'i posedojë secili religjion?
2. Përse i nevojitet njeriut religjioni?
3. Shpjegojeni rolin e religjionit në shoqëri.
4. Pse roli i religjionit është më i madh në momentet e krizës në jetën e njerëzve?
5. Cilat janë dallimet dhe ngjashmëritë midis religjioneve të mëdha botërore?

gjatë fëmijërisë së hershme dhe në familje. Në këtë periudhë personi është plotësisht i varur nga prindërit e tij. Mëson të flasë, reagon në miratimin ose jomiratimin e prindërve, dhe përpqet ta ndjekë shembullin e tyre. Më saktë, personi i ri në familje përgatitet të marrë pjesë në jetën shoqërore. Shoqëria për anëtarët e vet cakton mënyra të sjelljes me të cilat e pamundëson kaosin. Kjo arrihet përmes procesit të shoqërizimit.

Pra, **familja** është faktori i parë dhe më i rëndësishëm i shoqërizimit. Familja në të cilën rritet fëmija ka rol vendimtar për atë se si do ta zhvillojë personalitetin e vet. Në qoftë se në familje sundojnë marrëdhëniet harmonike dhe ekziston kujdes i duhur për fëmijën, atëherë janë përmbushur edhe kushtet për zhvillim të duhur të personalitetit të tij.

Por, shoqërizimi vazhdon edhe më tutje, gjatë gjithë jetës së njeriut. Përmes tij njerëzit aftësohen të përballen me problemet e lidhura me secilin veprim të ciklit jetësor, si edhe me të rejat të cilat i sjell jeta.

SHOQËRIZIMI

Çka nënkuptojmë me shoqërizim?

Për të mbijetuar një kulturë, ajo duhet të sigurojë mekanizma me të cilat elementet e kulturës do t'i bartin nga të moshuarit te të rinjtë. *Ky proces i bartjes së planifikuar të njohurive dhe diturive te të rinjtë dhe njëkohësisht miratimi krijues dhe kritik i tyre quhet shoqërizim i individit.*

Shoqërizimi zgjat gjatë gjithë jetës. Por, më e rëndësishmja për individët është shoqërizimi primar, nga i cili varet zhvillimi i personit në individ. Zhvillohet





Pra, në procesin e shoqërizimit përfshihen edhe një varg faktorësh të tjerë. Në fëmijëri përkrah familjes rol të madh ka edhe grupi i shokëve, më vonë ajo bëhet shkolla, mjetet për komunikim masiv (radioja, televizioni, shtypi dhe të ngjashme), kisha, organizimi i punës dhe një varg grupesh të tjera në të cilat anëtarësohet individ.

Në shoqërinë moderne roli i socio-burgut i atribuohet sistemit arsimor, grupit të moshatarëve, grupeve sipas profesionit etj.

Grupi i moshatarëve ka ndikim të fuqishëm mbi fëmijën, posaçërisht në periudhën e adoleshencës. Vendosja e raporteve nga më të ndryshmet me të tjerët dhe duke luajtur me lojëra, fëmija mëson se duhet të respektohen rregullat në bashkësinë në të cilën jeton. Nuk janë të rralla rastet kur nxënësi arrin sukses më të dobët vetëm që shokët (moshatarët) mos mendojnë se ai është “budalla që mëson”. Ndikimi i këtillë i moshatarëve mbi fëmijën mund të lërë pasoja të përhershme në jetën e tij, posaçërisht në planin profesional.

Një fjalë e urtë gjermane thotë: “Nëse dëshiron ta dish kush je, shiko kush janë shokët e tu”.

Mas-mediumet kanë ndikim të madh mbi fëmijën, posaçërisht gjatë periudhës së formimit si individ. Ato janë mjete të fuqishme që njëkohësisht i lidh njerëzit në grupe, por edhe kontribuon për t’u krijuar dallime të mëdha ndërmjet

tyre. Për shembull, mas-mediumet mundësojnë që publicitetet e shumta për produkte të caktuara të arrin deri te të gjithë njerëzit, ndërsa qëllimi është që t’i përafrojnë shijet dhe kuptimet e tyre për atë se çka është e mirë dhe e dëshirueshme.

Shoqërizimi nuk zhvillohet vetëm në fëmijëri. Ai është proces, i cili zgjat gjatë tërë jetës. Përherë kur individ anëtarësohet në një grup të ri ose pranon rol të ri në jetë, themi se i nevojitet kohë për t’u përshtatur dhe atëherë bëhet fjalë për shoqërizim. Studentit – fillestar i duhet kohë të përshtatet me kushtet e reja dhe të njihet me rregullat e sjelljes në fakultet. I njëjtë është rasti edhe me punëtorin në vendin e ri të punës, me të rinjtë në martesë etj.

Lexoni dhe nxirrni përfundim



Flitet se Perandori Akbar, i cili sundoi në Indi prej vitit 1542 deri 1602, urdhëroi që të mblidhen të gjithë fëmijët në një vend dhe të edukohen pa përdorimin e gjuhës. Për ata kujdeseshin njerëzit memecë, me qëllim që të vërtetojë nëse fëmijët do ta mësojnë gjuhën Hidu edhe përkundër izolimit të këtillë. Fëmijët aspak nuk dinin të flisnin. Komunikonin ndërmjet veti vetëm me gjeste.



Unë me të vërtetë jam i shqetësuar për shoqërizimin tuaj!

Ekziston literaturë për fëmijë, nga e cila mësuam se fëmijët mund të rriten nga kafshët. Një rast i dokumentuar me titullin “fëmijët e ujkut nga Midnapor”, flet për dy vajza njëra 2 vjeçe ndërsa tjetra 8 vjeçe, të gjetura në një gropë të ujkut në Bengal në vitin 1920. Vajzat ecnin me katër këmbë, ushqeheshin me mish të gjallë, uluronin si ujë, dhe nuk përdornin asnjë të folur. Nuk dihet nëse këta fëmijë ishin lënë në mal për t'u orientuar vetë ose ato i kanë rritur ujkit. Në cilin përfundim udhëzojnë këta shembuj?

Kontrollojini njohurit tuaja dhe përdorini ato



1. Shpjegoni pse shoqërimi është i rëndësishëm në jetën e secilit individ?
2. Kush e zbaton shoqërimin në secilin individ? Kush janë faktorët e tij?
3. Pse themi se shoqërimi nuk është proces i njëanshëm?
4. Çfarë ndikimi kanë mas-mediumet në formimin e personalitetit në individ?

DEVIJIMET SHOQËRORE

Njeriu është qenie e vetëdijshme, por me kërkesa, nevojat, dëshira dhe interese të ndryshueshme. Ai mund t'i zgjedhë mënyrat se si t'i kënaq ato. Sipas kësaj, dallohet nga qeniet tjera të gjalla të cilat veprojnë në mënyrë instiktive dhe në mënyrë jo të vetëdijshme. Mundësia për zgjedhje fsheh rrezik që të zgjedh mënyrë të veprimit edhe sjellje në kundërshtim me ato, të cilat janë pranuar nga bashkësia në të cilën jeton. Atëherë themi se njeriu sillet në mënyrë anti-sociale dhe të devijuar.

“Devijimi mund të përkufizohet si mospërshtatje ndaj një norme të dhënë ose përmbledhje normash, të cilat janë të pranuar nga një numër i madh njerëzish në një komunitet ose në një shoqëri”.

Gidens

Sjellja devijante e njerëzve është e dëmshme për shoqërinë. Ajo mund të barazohet me sëmundjen e rëndë, e cila e ha indin shoqëror. Në grupën e sjelljes devijante bëjnë pjesë të gjitha format e krimit dhe veprave tjera të dënueshme, alkoolizimi dhe format e toksikomanisë, prostitucioni dhe llojet tjera të devijimeve seksuale, lypësit, rrugaçët, madje edhe vetëvrasja.

Sjellja e njeriut është devijante kur me atë sjellje shkelet ndonjë lloj norme e pranuar nga komuniteti. Në varësi të asaj se cila normë është shkelur, ekzistojnë forma të ndryshme të sjelljes devijante: 1.devijim nga prishja e zakonit, moralit, vlerave, rregullave fetare, modës, standardit ose 2.devijim me shkeljen e normave juridike.



Në rastin e parë bëhet fjalë për mënyrat e sjelljes që kanë të bëjnë me jetën e përditshme të njeriut (sjellje e paedukatë, homoseksualizmi, mbetje pa shtëpi). Sanksionet për sjelljet e këtilla janë relativisht të buta: përqeshje, qortime, vërejtje, por mund të sjellin deri te largimi i individëve të cilët sillen në mënyrë devijante.





Sjellje kriminale llogariten ato mënyra të sjelljes me të cilat shkelen normat, të cilat i cakton dhe i sanksionon shoqëria. Zakonisht këto norma janë në formë të ligjeve të shkruara me të cilat mbrohen të mirat dhe vlerat që janë të interesit jetësor për individët ose për shoqërinë. Të tilla janë: vjedhjet, vrasjet, sjellje të dhunshme me pasoja të rënda për shëndetin psikik dhe fizik, krimet e luftës dhe të ngjashme. Këtu bëjnë pjesë edhe shkeljet më të vogla të ligjeve të shkruara për të cilat vijojnë dënime më të buta, siç janë **kundërvajtjet** (mosrespektimi i qetësisë dhe rendit publik, kundërvajtjet në komunikacion dhe të ngjashme).

Sanksionet, të cilat aplikohen për shkeljen e ligjeve, janë më drastike për mosrespektimin e normave joformale. Mund të jenë gjoba, dënime me burg, dënim me vdekje etj.

Shoqëria moderne ka probleme serioze me sjelljen devijante të njerëzve për shkak të numrit të tyre të rritur. Parashtrohet pyetja: Cilat janë arsyet për gjendjen e këtillë? Nëse biologët dhe psikologët theksojnë se arsyet janë të

natyrës psikologjike, sociologët arsyet për rritjen e sjelljeve devijante te njerëzit i kërkon në familje. Ata theksojnë se në shoqërinë moderne funksionet e familjes janë zvogëluar. Me këtë zvogëlohet edhe fuqia e tyre që t'i drejtojnë, t'i shoqërizojë dhe t'i kontrollojë si duhet anëtarët e saj.

Dendësia e popullsisë, migrimet, urbanizimi, industrializimi dhe modernizimi janë arsyet për ndërlikimin e jetës së njerëzve. Në kushte të këtilla paraqitet divergjencë ndërmjet pritjeve dhe mundësive reale për përmbushjen e nevojave njerëzore. Prandaj, modernizimi i jetës shoqërore është arsyeja kryesore për rritjen e sjelljes devijante te njerëzit.

Kalimi nga një sistem shoqëror në tjetrin dhe ndeshja e vlerave të vjetra dhe të reja, të cilat ndodhin atëherë, mund të jetë arsyeja për paraqitjen e sjelljes devijante. Në kushte të këtilla dobësohet kontrolli shoqëror, njerëzit e humbin sigurinë sociale dhe janë të prirë ndaj devijimeve.

Proceset e globalizimit, rritja e teknologjisë së informatikës edhe më tepër ndikojnë në ndjenjën e pasigurisë. Humben kriteret për përcaktimin e vlerave themelore njerëzore dhe kjo është arsyeja për paraqitjen e llojeve të ndryshme të sjelljeve devijante: krimi i organizuar, korrupsioni, varfëria, tregtia e palejuar me mjete narkotike, prostitucioni dhe të tjera.

Te të rinjtë në Maqedoni, të cilët gjenden në procesin e formimit të identitetit të tyre, ku edhe janë mjaft të prekshëm, rrethanat e këtilla kanë kontribuar, gjithashtu për zgjerimin e sjelljes devijante: kënaqësia me mjetet narkotike, alkoolizmi, pirrja e duhanit, rrugaçëria, sjellja agresive dhe mungesa e tolerancës, prishja e qetësisë dhe rendit publik, prostitucioni dhe të ngjashme.

Mas-mediumet kohët e fundit paraqiten si mjet i fuqishëm për kontroll dhe drejtim të sjelljes së individëve. Përmes televizionit (shikimit të filmave me sjelljes të dhunshme të aktorëve) te individët mund të shkaktojë dy efekte. Njëra palë do të imitojë sjelljen e aktorëve të filmit me qëllim që të çlirohen nga frustracionet që i kanë. Individët tjerë do të përpiqen



ta arsyetojnë sjelljen e tyre devijante me atë që kanë parë në televizion.

Shkolla është institucion për kontroll social të individëve. Ajo përmes arsimimit, dhe posaçërisht edukimit i orienton individët kah sjellja e mirë.



Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato



1. Cilat janë arsyet për paraqitjen e sjelljes devijante te individët?
2. Përpiqu të arrish deri te informacione për atë se cilat forma të sjelljes devijante janë më të pranishme ndërmjet të rinjve në Republikën e Maqedonisë. Në cilën moshë janë pronarët e tyre dhe cilat janë arsyet për një sjellje të tillë?

GRUPIMI SHOQËROR

UNË NDËRMJET TË TJERËVE

Rëndësia e bashkëveprimit

Njeriu nga çasti i lindjes bëhet pjesë e ndonjë komuniteti shoqëror. Aty tashmë jeta është e rregulluar. Kjo d.m.th se aty vlejnë rregulla dhe norma të caktuara të sjelljes, të cilat individi duhet t'i respektojë. Aty njeriu ka raport edhe me njerëz tjerë në bashkësi, që shpie në përfundimin se ai nuk mund të jetë vetë në shoqëri. Ai është i varur nga njerëzit tjerë dhe domosdoshmërisht ka raporte të ndryshme me ata.

Kështu, për shembull, individi së bashku me anëtarët tjerë të familjes përditë kryen detyrime të caktuara familjare. Përgatitjen e ushqimit, kujdesi rreth fëmijëve janë vetëm disa nga aktivitetet e shumta, të cilat individi i kryen bashkë me anëtarët tjerë.

Nocioni me të cilin shpjegohen raportet ndërmjet individëve dhe grupeve në shoqëri quhet bashkëveprimi shoqëror.

Bashkëveprimi

Sjellja e një individi e cila është e drejtuar kah individi tjetër. Ky është veprim shoqëror reciprok. Ai përherë e përfshin qëllimin e vepruesit që të shkaktojë te tjetri reaksion dhe veprim prapa nga ana e tij.

Bashkëveprimi shoqëror është proces i ndërlikuar në të cilin individët janë të lidhur në mënyrë reciproke. Lidhja është e fortë dhe shkakton ndryshime në sjelljen e njerëzve. Ai realizohet me ndihmën e komunikimit ndërmjet njerëzve, kurse

ndodh si nevojë e njerëzve për të arritur deri te ndonjë synim i përbashkët.

Struktura e bashkëveprimit

Në secilin bashkëveprim duhet të ekzistojnë disa elemente: vepruesit, veprimi dhe raporti. Ato e përbëjnë strukturën e bashkëveprimit. Pa ato bashkëveprimi është i pamundur.

Vepruesit janë persona ose grupe të përfshira në bashkëveprim.

Veprimi është aktivitet që e ndërmarrin vepruesit. Veprimi shoqëror përherë është përgjigje për vepruesin tjetër ose përpjekje për të siguruar një përgjigje të tillë. Atë që e bën njëri veprues duhet të jetë e kuptueshme për vepruesin tjetër.

Raporti (bashkëveprimi) realizohet ndërmjet vepruesve të caktuar gjatë një periudhe të gjatë. Pikërisht për shkak të zgjatjes së bashkëveprimit ndodhin ndryshime të caktuara në sjelljen e vepruesve:

1. njerëzit (vepruesit) bëhen të varur njëri nga tjetri dhe presin që bashkëveprimi të zgjatë;
2. secili prej vepruesve pret që veprimet e ardhshme të bazohen në ato të mëparshmet;
3. kur do të vendoset raporti, secili veprues të identifikohet me të tjerët.

Format e bashkëveprimit

Ekzistojnë më tepër forma të bashkëveprimit. Në shkencë nuk ekziston klasifikim i vetëm, por, megjithatë, ekziston pajtueshmëri për ekzistimin e dy llojeve të bashkëveprimit: bashkëveprimi, i cili i afron njerëzit dhe bashkëveprimi, i cili i ndan njerëzit. Në të parin, zhvillohen raporte miqësore dhe në këtë grup mund të numërohen: kooperimi (bashkëpunimi), këmbimi,

ndërsa në grupin tjetër të bashkëveprimit bëjnë pjesë: gara dhe konflikti.



Kooperimi (bashkëpunimi)

Bashkëpunimi është raport shumë i rëndësishëm i njerëzve në shoqërinë moderne. Ai është parakusht themelor për suksesin e individëve në planin personal dhe atë profesional. Për shkak të kompleksitetit dhe dinamikë së jetës, njerëzit (grupet) duhet të bashkëpunojnë dhe të plotësojnë njëri-tjetrin, të kërkojnë kompromis edhe kur interesat e tyre janë tërësisht të kundërta. Për shembull, partitë politike, sipas rregullës, janë në kundërshtim me njëra-tjetrën në garën për marrjen e pushtetit, por në situata të caktuara ato duhet të bashkëpunojnë posaçërisht nëse është në pyetje mbijetesat e shtetit. Bashkëpunimi ndërmjet njerëzve ekziston në të gjitha fushat e jetës shoqërore, në familje, ndërmjet anëtarëve të saj, në institucionet shoqërore etj.

Këmbimi

Në thelb të gjitha raportet (bashkëveprimet) ndërmjet njerëzve përfshijnë në vete njëfarë këmbimi. Kur dy veta komunikojnë, ata në mënyrë verbale bëjnë këmbim të ideve, mendimeve dhe qëndrimeve për çështje të caktuara. Njerëzit ndonjëherë, bile edhe sot, më së shumti bëjnë këmbim

gjatë shitblerjes. Kështu, për shembull, para paraqitjes së ekonomisë monetare ata këmbenin mall për mall, kurse më vonë mall për të holla. Njerëzit këmbenin banesa, vetura, por përveç këmbimit të të mirave materiale, njerëzit mund të këmbëjnë edhe dituri, përvoja, dashuri dhe shumë gjëra të tjera.

Gara

Marrja pjesë në garë është raport në të cilin individët ose grupet përpiqen të arrijnë një qëllim të njëjtë më të mirë dhe më tepër se personat tjerë ose grupet tjera. Edhe sipas karakterit të vet është në kundërshtim me bashkëpunimin dhe shkakton efekte të kundërta, gara lehtë shndërrohet në proces të bashkëpunimit. Gara ndonjëherë mund të paraqitet edhe si mjet, i cili motivon dhe drejton kah zhvillimi, progresi, sukcesi. Ajo do të varet nga karakteri dhe pozita e individëve dhe grupeve, të cilat marrin pjesë në garë, motivet e garës, rëndësisë dhe qëllimet që duhet të arrihen me atë.

Kështu, për shembull, në disa shkolla nxënësit nuk janë të motivuar për arritjen e rezultateve më të larta në mësim, për shkak të mosekzistimit të shpirtit garues. Në histori janë të njohura ndodhitë historike (luftërat), të cilat ndodhnin pikërisht për shkak të garës së shteteve për të fituar numër më të madh të territoreve të huaja. Atëherë gara kalon në konflikt.

Konflikti

Në kohën e sotme konfliktet janë pjesë përbërëse e jetës. Ndodhin kur njerëzit nuk mund të pajtohen me dëshirat, interesat dhe nevojat e tyre. Në qoftë se një konflikt nuk mund të kapërcehet, ai mund të shkaktojë pasoja të rënda.

Konflikti është forma më e ashpër e garës, për shkak se aty njëra nga palët kundërshtarë ose dobësohet ose shkatërrohet.



Arsyeja për konflikt mund të jetë dëshira për t'u treguar, zilia, xhelozia, ofendimi, mungesa e singjeritetit dhe kështu me radhë. Por, më shpesh arsye për konfliktet është mostoleranca. Njerëzit jotolerantë veten e llogarisin për më të mirë. Ata janë të bindur se janë më të mençur, më të urtë dhe i nënvlerësojnë të tjerët. Te njerëzit jotolerantë nuk ekziston dëshira për të zbuluar anët e mira të njerëzit. Ata nuk përpiqen t'i pranojnë njerëzit ashtu siç janë.

Konflikti për njerëzit është i padëshirueshëm, posaçërisht nëse nënkupton dhunë dhe viktima dhe vlerësohet si fenomen negativ për shoqërinë. Por, në një moment të caktuar ai mund të jetë i pakalueshëm për shoqërinë, në qoftë se paraqet mundësi e vetme për t'u nxitur përparimi shoqëror.

Çfarë është e nevojshme që të arrihet bashkëveprimi

Edhe pse njerëzit jetojnë në bashkësi, ata dallohen sipas nevojave, dëshirave, ndjenjave, stilit të jetës, vlerave të miratuara. Mosnjohja e vetvetes dhe të tjerëve është arsyeja për mosdurim midis njerëzve i cili mund të mbarojë me armiqësi, dhunë, luftë. Në kushte kur njerëzit nuk dinë asgjë për njëri-tjetrin, ndërmjet tyre vështirë se mund të realizohet ndonjë lloj bashkëveprimi.

Që të mund të realizohet ndonjë bashkëveprim është e nevojshme që secila nga palët e përfshira ta kuptojë

qëndrimin e palës tjetër. Domethënë, duhet të ekzistojë komunikim, veprim me ndihmën e të cilit njëri veprues do të mund t'i zbulojë qëllimet, motivet dhe synimet e vepruesit tjetër. Vepruesi tjetër duhet të përgjigjet, në mënyrë që të rregullojë sjelljen e tij në bazë të kërkesave të të parit.

Ky rregullim i sjelljes si përgjigje ndaj situatës së dhënë shoqërore quhet marrja e rolit.

Secili person, i cili hyn në një bashkëveprim të caktuar, duhet të supozojë se kush janë miqtë dhe si ata e perceptojnë dhe e kuptojnë situatën e dhënë.

E para gjë që duhet të bëhet është të përpiqet të mbledhë informacione bazike për të tjerët në bashkëveprim: për gjininë, moshën, profesionin, përkatësinë etnike, fenë dhe të ngjashme. Këto të dhëna do t'i ndihmojnë për të krijuar mendim fillestar për ata.

Por, ky mendim mund të jetë edhe i gabuar në qoftë se nuk plotësohen me informacione më konkrete. Pasqyrë të qartë për individin tjetër do të fitohet nëse siguron edhe informacione të tjera, për shembull cila është pamja e tyre fizike.

Pamja fizike e individëve është shumë me rëndësi në bashkëveprimin shoqërorë. Përmes figurës, veshjes, sjelljeve, hipinë personale, frizurën, grimin mund të vlerësohen personalitetet, karakteristikat e tyre morale. Në bashkëveprim është më rëndësi nëse personi është me vetëbesim, i rregullt, krenar, sentimental, i lumtur, agresiv, pagan, etj.



Detyrë

Përpiquni për një kohë të caktuar të mbikëqyrni se çfarë do të ndodhë nëse ndonjë nga shokët me të cilët më së shumti shoqërohesh fillon të sillet në mënyrë shumë më ndryshe nga ajo e zakonshme. A do të rritet bashkëveprimi ndërmjet jush apo do të zvogëlohet? A do të ndryshojë bashkëveprimi ose jo? Cilat do të jenë efektet e bashkëveprimit?

ROLET SHOQËRORE



Rolet dhe personaliteti

Çdo individ gjatë jetës së tij kryen disa veprimtari, profesione ashtu që ai njëkohësisht është edhe bartës i roleve të shumta. Kështu për shembull, ai mund të jetë njëkohësisht edhe baba, bashkëshort, sportist, anëtarë i nji partie politike, besimtar, etj.

Fjala “rol” e përdorur në këtë kontekst nuk nënkupton rol teatrorë në shfaqje, por sjellje e caktuar e individit e cila pritët nga ai kur ai merr ndonjë pozicion (pozitë) në shoqëri. Kështu për shembull, të qenurit prind është pozitë shoqërore. Por, nga ai pritët që t’ju jap fëmijëve të tij mbështetje ekonomike dhe morale, t’i arsimojë, t’u mundësojë ardhmëri më të mirë për shkak se ky është roli i prindit. Të

qenurit mjek është pozitë shoqërore, por roli i tij është të kujdeset për të sëmurët, t’i shërojë, të punojë sipas etikës së mjekut dhe të ngjashme. Përmes rolit mjek hyn në bashkëveprim me njerëzit tjerë (pacientët, personeli mjekësorë dhe të ngjashme).

Rolet janë pritje nga anëtarët e shoqërisë të cilët marrin pozitë të caktuar. Këto pritje përfshinë si detyra ashtu edhe çmime të cilat janë të lidhura me pozitën e veçanta.

Gjatë kryerjes së roleve shpesh ndodh ndeshje e roleve, që mund të jetë e pavolitshme për individin.

Kështu për shembull, pothuajse çdo nxënës dëshiron, njëkohësisht edhe të merret me sport edhe të jetë në shoqëri me shokët, të vizitojë kurse për mësimin e gjuhëve të huaja, dhe me sukses t'i kryejë detyrat e shtëpisë. Kryerja e gjithë këtyre detyrave (roleve) disa nxënësve mund t'u shkaktojë vështirësi. Ata nuk janë në gjendje secilin rol ta kryejnë në mënyrë të barabartë. Në këtë rast, ata duhet të zgjedhin cilit rol do t'i japin përparësi, sepse për ndryshe do të ndodhë ndeshje ndërmjet detyrave (**konflikt i roleve**).

Në shoqërinë moderne individët janë të ndarë mes detyrave. Shembull tipik është gruaja moderne, e cila për hatër të karrierës, duhet të braktisë rolin e nënës.

Gjatë kryerjes së roleve individët duhet të sillen në një mënyrë të caktuar, për shkak se të tjerët (shoqërua) pret nga ai, individi në mënyrë të rregullt t'i kryejë rolet e veta. Pritjet e këtilla quhen **normative**.

Megjithatë, individët ndonjëherë kryejnë role të caktuara, të cilat ua inponon situata në të cilën janë gjendur momentalisht. Kështu, për shembull, nga ata pritët të ndihmojnë në shuarjen e zjarrit, të ndihmojnë të lënduarit në

aksidentet e trafikut dhe të ngjashme. Pritjet e këtilla quhen të **situatës**.

Pritjet personale janë pritje të individëve nga kryerja e roleve të veta. Rolet individët i mësojnë përmes procesit të shoqërizimit gjatë jetës së tyre. Përmes kryerjes së roleve individët mësojnë si të sillen në situata të ndryshme të jetës, gjegjësisht mësojnë çka pritët nga ata gjatë jetës.

Zakonisht, rolet shoqërore janë të rregulluara me rregulla të caktuara shoqërore dhe ekzekutimi i tyre ndonjëherë shkakton sanksion shoqërorë që mund të jetë pozitive (çmim për sjellje të mirë) dhe negative (dënim për sjellje të keqe).

Nga kjo del se individët njëkohësisht luajnë më tepër role të cilat mund të jenë pozitive: rolin baba, nënë, shok, profesor, mjek dhe të ngjashme, por edhe negative: hajdut, lypës, kontrabandist, kriminel, etj.

Rolet në jetën e përditshme

Gjatë jetës sonë ne luajmë shumë role. Ato i fitojmë në dy mënyra: 1) në bazë të rregullave të caktuara; dhe 2) në bazë të arritjeve tona personale. Pra, edhe rolet ndahen në: *role e përcaktuara dhe rolet e arritura*.

Rolet e përcaktuara. Ato u ndahen njerëzve në bazë të karakteristikave të tyre personale, më shpesh sipas gjinisë dhe moshës. Megjithatë, në disa shoqëri ndarja e roleve bëhet edhe sipas disa karakteristikave siç janë raca, religjioni, familja, prejardhja, vendbanimi dhe të ngjashme.



Rolet e përcaktuara përmbajnë në vete një dozë të madhe të detyrimit. Individët janë të detyruar ato t'i kryejnë dhe atë kur nuk dëshirojnë. Ato u imponohen. Fëmijët janë të detyruar të shkojnë në shkollë, madje edhe kur ata nuk dëshirojnë.

Rolet e arritur individët i fitojnë në bazë të aftësive të demonstruara për kryejnë e tyre. Rolet e tilla kanë kërkesa të përcaktuara shoqërore dhe individët duhet të dëshmojnë se ato i përmbushin në mënyrë që t'u jepen rolet e dëshiruara. Këto kërkesa ndonjëherë janë shumë specifike, ndonjëherë nuk janë shumë të qarta. Për shembull, për të fituar rolin e mjekut është e nevojshme të dëshmohet se posedon diplomë për mbarimin e fakultetit të medicinës; për punë administrative mund të kërkohej një shkallë e caktuar e arsimit, pa mos u potencuar specifika e tij (p.sh., arsim të mesëm); për ndonjë anëtarësim në asociacion vullnetar aspak nuk kërkohej shkallë e caktuar e arsimit, por supozohet disa prire.

Rolet në të kaluarën ishin përcaktuar në masë të madhe. Sot, në shoqëritë demokratike, më i madh është numri i roleve të arritura.

Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato



1. Cili është roli i individëve në funksionimin e bashkësive shoqërore?
2. Si rregullohen rolet shoqërore?
3. Theksoni shembull konkret për konflikt të roleve. Shpjegoni si ka ndodhur konflikti dhe si e keni kapërcyer këtë situatë.
4. Cilat elemente ndikojnë në përcaktimin e pozitës shoqërore të individëve?

GRUPET NË SHOQËRI

GRUPET SHOQËRORE

Njeriu nga krijimi i vet e deri më sot jeton në forma të ndryshme të shoqërimit dhe lidhjeve mes veti. Kjo lidhje e njerëzve del nga natyra e njeriut si qenie shoqërore. Për t'i përmbushur kërkesat dhe interesat e veta nga më të ndryshmet bashkë me njerëzit tjerë, ai vendos raporte të ndryshme me ata. Si rezultat i kësaj paraqiten grupet shoqërore.

Ekzistenca dhe veprimtaria e njeriut zhvillohet në kuadër të një numri të madhe të grupeve të ndryshme. Pikërisht nga këto arsye, çështja për grupet shoqërore bëhet çështje qendrore në sociologji. Grupi paraqet përmbledhje të më tepër njerëzve të cilët janë në bashkëveprim dhe të cilët kanë karakteristika të përbashkëta të përcaktuara. Zakonisht, sa më tepër një shoqëri të jetë e zhvilluar, në mënyrë të diferencuar dhe komplekse, aq më tepër mënyra të grupimit ekzistojnë në atë.

Karakteristikat e grupeve shoqërore

Grupin e përbëjnë më së paku dy veta, por zakonisht më tepër njerëz. Shkalla



e organizimit të grupeve, pozita dhe rolet e individëve në atë janë të vendosura në mënyra të ndryshme. Normat, synimet dhe nevojat e përbashkëta, të cilat grupet i miratojnë, i pranojnë të gjithë anëtarët e saj. Secila pozitë në shoqëri është e ndjekur me rregulla të sjelljes, gjegjësisht pritje të cilat duhet t'i përmbushin bartësit e pozitës dhe kjo është baza e homogjenitetit të grupës. Secila grup ka rregulla, të cilat vlejnë vetëm për anëtarësinë e saj. Zakonisht në grup ekzistojnë interesa, ideale dhe vlera të përbashkëta. Interesi i bashkon njerëzit për realizimin sa më të mirë dhe më efikas të synimeve të përbashkëta (shoqëri sportive, familje, fqinjësi, etj.). Secila grup ka sistem të njohjeve dhe sanksioneve, me të cilat u ndan çmim anëtarëve të saj për kryerjen e mirë të roleve ose i dënon për shkak të shkeljes së normave të grupit.

Në bazë të të gjitha këtyre karakteristikeve mund të përfundojmë se *grupi shoqëror paraqet një bashkësi relativisht të përhershme të njerëzve, ndërmjet veti të lidhur për shkak të kryerjes së ndonjë veprimtarie shoqërore dhe për përmbushjen e disa interesave dhe nevojave të përbashkëta.*



Këngëtarë të korit



Çfarë grupi janë fansat e një ndeshjeje sportive?

Klasifikimi i grupeve shoqërore

Grupet shoqërore janë të llojllojshme sipas natyrës dhe prandaj mund të klasifikohen në mënyra të ndryshme: Sipas veprimtarisë së tyre, niveli i ndjenjës së përkatësisë, sipas madhësisë së grupës, synimit dhe të ngjashme. Sipas funksionit dhe veprimtarisë që njerëzit bëjnë në grup, ato mund të ndahen në farefis familje, ekonomike, edukativo-arsimore, politike, kulturore dhe religjioze. Duke pasur parasysh nivelin e rregullshmërisë së raporteve midis anëtarët, grupet mund të ndahen në formale dhe joformale. Për grupet formale karakteristike janë raportet e forta dhe të rregullta midis anëtarëve të grupeve. Ato janë të parapara dhe të sanksionuara me norma oficiale. Të tilla janë partitë politike, grupet e nxënësve, disa grupe religjioze dhe të ngjashme.

Në grupet joformale, pozita e anëtarëve dhe raporti i tyre ndërmjet nuk është i rregulluar. Ato rregullohen në vetë grupin. Këto grupe krijohen në mënyrë spontane dhe në varësi të nevojave dhe interesave konkrete të individëve.

Grupet e këtilla janë: grupet e shokëve, shikuesit e ndonjë manifestimi sportiv dhe të tjera. Mes klasifikimeve më të

njohura të grupeve shoqërore është ajo, e cila i ndan grupet në primare dhe sekondare. Grupet primare janë të parat dhe bazike dhe aty formohet dhe shoqërizohet natyra e njeriut. Ato bazohen në shkallën e lartë të intimitetit të raporteve midis anëtarëve dhe ndjenjës së zhvilluar të përkatësisë ndërmjet veti, dashurisë dhe respektit. Në grupet e këtilla janë: familja, grupet e moshatarëve, por deri diku edhe fqinjët e vjetër. Në grupet primare anëtarët plotësisht i janë dhënë grupit me vullnet, emocione dhe arsye. Në këto grupe ekziston komunikim intensiv dhe komunikim i besueshëm.

Grupet sekondare sipas natyrës së tyre janë shumë më të zgjeruara nga ato primare. Ato janë bashkësi më të gjerë shoqërore të cilat bazohen në raportet e rregulluara në mënyrë formale. Në ato mungon tërheqja emocionale. Njerëzit në këto grupe shoqërohen me qëllim që



Çfarë grupi është orkestra?

t'i përmbushin ndonjë synim konkret. Për shembull, shoqatat tregtare, organizatat prodhuese, etj.

Sipas asaj nëse në grupe zhvillohen të gjitha proceset, veprimtaritë dhe raportet shoqërore ose vetëm disa prej tyre, ato mund të ndahen në **globale dhe parciale**.



Çfarë grupi janë udhëtarët në stacionin e autobusit?

Në ato globale zhvillohen të gjitha proceset dhe veprimtaritë shoqërore. Ato janë të qëndrueshme, anëtarët janë të lidhur ngusht ndërmjet veti. Shembull, për grupet e këtilla janë hordhitë, gjinia, fisi, populli dhe kombi.

Parciale janë ato grupe në të cilat zhvillohen vetëm disa llojet e veprimtarive, proceseve dhe raporteve shoqërore. Ato nuk janë vetë të mjaftueshme për t'i përmbushur të gjitha nevojat e njerëzve, kurse janë të krijuara në kuadër të grupeve globale shoqërore, si pjesë përbërëse të tyre. Shembull për grupet parciale shoqërore janë: profesionet e ndryshme, klasat, shtresat, etj.

Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato



1. Çka nënkuptojmë me grup shoqëror?
2. Për çfarë arsye njerëzit i formojnë grupet shoqërore?
3. Si mund të ndahen grupet shoqërore?

FAMILJA



Familja si grup shoqëror për secilin është e afërt, e njohur dhe e kuptueshme, sepse, pothuajse secili individ në familje e fillon dhe e mbaron jetën e vet.

Familja është pasojë logjike e martesës, kurse martesa është marrëdhënie e pranuar shoqërore ndërmjet burrit dhe gruas. Gjatë historisë martesa takohet në forma të ndryshme.

Për shoqëritë e civilizuara karakteristike është martesa monogami (një burri dhe një gruaje). Martesa mund të lidhet për shumë arsye dhe në shumë mënyra dhe krejt kjo varet se çfarë raporte do të vendosen ndërmjet bashkëshortëve. Nuk janë të rralla martesat ndërmjet dy vetave, të cilët nuk e kanë regjistruar martesën, të njohur si bashkëjetesë, martesa pa fëmijë, si edhe martesat e homoseksualëve (martesa midis dy personave të gjinisë së njëjtë).

Martesa paraqet bashkësi (lidhje) të përhershme relative gjinore dhe shoqërore ndërmjet burrit dhe gruas, të cilën e njeh shoqëria.

Martesa e sotme ndërmjet çiftit është martesë civile. Lidhet parapërfaqësuesve të organeve shtetërore dhe rregullohet me rregulla juridike. Në histori janë të njohura martesat e zakoneve, tipike për shoqëritë tradicionale; martesat në kishë të lidhura para organeve kishtare dhe të rregulluara me norma kishtare.

Martesa mund të paraqitet në më tepër forma:

- **Monogamia** - bashkësi e një burri dhe një gruaje;
- **Poligamia** - bashkësi e më tepër partnerëve në martesë, e cila mund të jetë: poligini (një burri dhe më tepër gra) dhe poliandri (një gruaje

- dhe më tepër burra
- **Bashkëjetesë:** bashkësi e dy vetave, e cila nuk është e rregulluar juridikisht.
 - **Jeta beqare:** popullsi e pa martuar, numri i të cilave në shoqëritë moderne është gjithnjë në rritje.
 - **Martesa pa fëmijë;** bashkësi martesore pa fëmijë.
 - **Çiftet homoseksuale** - bashkësi e personave të së njëjtës gjini.

Me lindjen e fëmijëve bashkëshortët bëhen prind dhe fitojnë role të reja. Ndërmjet tyre vendosen raporte më të ndryshme, detyrat u shtohen. Martesa kalon në familje në të cilën vendosen raportet farefisnore. Farefisnia është lidhje biologjike ndërmjet anëtarëve të familjes, si rezultat i marrëdhënies martesore. Ndalon incestin, d.m.th marrëdhëniet seksuale midis babait dhe vajzës, nënës dhe djalit, vëllait dhe motrës.

Familja është bashkësi intime, por me organizimin strukturor, që d.m.th se ajo nuk lehet në vullnetin e anëtarëve të saj. Marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve rregullohen me norma juridike dhe morale, gjë që flet për rëndësinë e familjes në jetën shoqërore.

Familja ka zhvillimin e vet historik. Në secilën epokë historike të historisë njerëzore janë zhvilluar forma adekuatë të familjes dhe marrëdhënieve familjare.



Në të kaluarën kanë dominuar familjet e mëdha, në të cilat babai kishte pozitë të detyruar mbi gruan dhe fëmijën.

Sot mbizotëron familja e vogël **bërthamore**. Aty mbizotërojnë marrëdhëniet demokratike. Burri dhe gruaja janë të barabartë. Ata, në të shumtën e rasteve, në mënyrë të barabartë kontribuojnë për sigurimin e të mirave materiale. Ata i ndajnë detyrat në udhëheqjen e amvisërisë së përbashkët, si dhe rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Autoriteti në familjen moderne është i ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet burrit dhe gruas.

Funksionet e familjes

Pavarësisht nga numri i anëtarëve, secila familje ka më tepër vepra funksionale shoqërore. Sipas kësaj, ajo dallohet nga grupet tjera shoqërore. Funksioni i parë i familjes është funksioni *biologjik dhe psikologjik*. Kjo do me thënë se bashkëshortët në kuadër të familjes i përmbushin marrëdhëniet gjinore, i rrisin fëmijët dhe vendosin raporte dashurie, respekt dhe lidhshmëri reciproke.

Njëra nga funksionet më të vjetra të familjes është funksioni socializues. Përmes edukimit nga ana e prindërve foshnja përgatitet për jetë në shoqëri. Njihet me nocionet dhe pikëpamjet më të përgjithshme për shoqërinë, normat dhe vlerat si dhe marrëdhëniet me atë. Përmes shoqërizimit i pranon formalitetet kulturore të bashkësisë në të cilën lind dhe rritet.

Funksioni ekonomik i familjes përbëhet nga sigurimi dhe konsumimi i mjeteve materiale për jetën e anëtarëve të saj.

Familja moderne

Në familjen moderne është reduktuar numri i anëtarëve dhe funksionet e saj.



Burri më shpesh në mënyrë të pavarur vepron në procesin e punës, kurse kjo kërkon mungesë më të madhe nga shtëpia dhe nga familja. Gruaja në përpjekjet për t'u barazuar me burrin, më tepër kërkon të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në sigurimin e mjeteve për ekzistencën jetësore. Në kushte të këtilla, kujdesi dhe shoqërimi i fëmijëve lihet në çerdhet për fëmijë dhe në shkollë. Lindja e fëmijëve kufizohet me një ose me dy lindje. Në këtë mënyrë rolet e anëtarëve në familje ndryshojnë. Raportet ndërmjet bashkëshortëve, prindërve dhe fëmijëve gjithnjë e më tepër fitojnë karakter të "ortakërisë" që, njëkohësisht, d.m.th distancimin e tyre psikologjik. Megjithatë, funksionet themelore mund të kryhen vetëm në familjet e shëndosha. Vetëm në familjet e shëndosha, në të cilat ka dashuri dhe mirëkuptim fëmija mund të zhvillohet në individ të shëndoshë.

Detyrë



Shkruani një ese në temë – Familja sot. Udhëzues për esenë le të jenë pyetjet e mëposhtme:

1. Cilat janë dallimet ndërmjet familjes tradicionale dhe familjes moderne?
2. Cilat janë mendimet tuaja për familjen në të ardhmen?
3. Shpjegojeni ndikimin e bashkësive jashtëmartesore në bazë të strukturës demografike të popullsisë?

GRUPET E POZICIONIT (SHTRESAT DHE LËVIZSHMËRIA)

Jetojmë në një kohë në të cilën vlerë të lartë ka ideja e barabarësisë. Por, veç kësaj, në shoqëri ekzistojnë dallime të shumta mes njerëzve. Njerëzit ndërmjet veti dallohen sipas pasurisë që e posedojnë, sipas reputacionit që e gëzojnë dhe sipas fuqisë me të cilën disponojnë për të imponuar ndikimin e vet në shoqëri.

Pabarazia ekziston në të gjitha llojet e shoqërive njerëzore. Madje edhe grupe e vogla njerëzore në të cilat nuk ekzistojnë dallime në pasuri, pabarazia është prezente përmes dallimeve në gjini (burrë dhe grua), moshë (të rinj dhe të moshuar), por, gjithashtu, edhe përmes dallimeve në reputacionin e lidhur me aftësitë individuale. Këto pabarazi në realitet njerëzit i ndajnë në grupe të llojllojshme, të cilat kanë pozitë të veçantë në shoqëri, të emëruar si shtresa. Pabarazia e këtillë ishte arsye për ndeshjet e shumta në histori.

Gjatë historisë të njohura janë pesë sisteme të shtresave: skllavëria, kasta, prona, klasa dhe shtresa.

Skllavëria. Ajo është formë ekstreme e pabarazisë në të cilën disa njerëz janë të poseduar nga disa të tjerë si pronë e tyre.

Kastat. Ato janë grupe të mbyllura, me vend të posaçëm në shoqëri. Bazohen në rregulla të rrepta religjioze. Ato përfshijnë normat për sjellje në kuadër të secilës kastë, si dhe ndalesat për përzierjen e kastave. Kasta është tipike për Indinë.

Pronat. Ato janë grupe, karakteristike për shoqëritë evropiane të mesjetës.

Në shoqëritë e pronave për secilin pronar janë caktuar detyra të posaçme, të drejta dhe norma të sjelljes. Pronat më të njohura ishin: shenjtëria, bujari, fshatarësia dhe qytetaria.

Klasa. Klasat janë grupe relativisht të hapura, karakteristike për shoqëritë, duke filluar nga faza e hershme e industrializimit deri më sot. Pjesëmarrja në ato nuk është e bazuar në rregulla juridike dhe religjioze, por është e kushtëzuar me pozitën e njeriut në tregun, si dhe nga përfitimet, të cilat vijnë nga ajo pozitë. Njeriu furnizohet me pozitë të caktuar klasore, varësisht nga ajo nëse ka ose jo pronësi, sa përfiton, çfarë profesioni ka, cila është pozita e tij në organizimin e punës, gjegjësisht, para së gjithash gjendjes ekonomike. Ekzistojnë klasifikime të ndryshme të klasave, por më e shpeshtë është ajo, e cila njerëzit i ndan në tre grupe: klasa e lartë, klasa e mesme dhe klasa e ulët.

Shtresat. Karakteristike për shoqëritë moderne industriale, në të cilat ekziston ndarje e madhe e punës dhe diversitet aq të madh në shpërndarjen e pasurisë, reputacioni dhe fuqia, ku është e pamundur të bëhen dallime të qarta. Kriteret bazike, sipas të cilave përcaktohen shtresat në shoqëritë moderne, janë: profesioni, të ardhurat, arsimimi dhe mënyra e jetesës.

Në shoqëritë moderne shumë më e madhe është rëndësia e arsimit për arritjen e pozitës më të lartë shoqërore.

Njerëzit kryejnë role të ndryshme në shoqëri. Pastaj, të gjitha rolet nuk llogariten të rëndësishëm së barabartë. Secila shoqëri ka kriteret përmes së cilave e përcakton rëndësinë e roleve shoqërore.

Një kriter është koha, e cila është e nevojshme për të fituar ndonjë rol. Pikërisht, rolet shoqërore kërkojnë kohë të ndryshme të përgatitjes: për disa është e nevojshme të ketë arsim fillestar,

për të tjerë të mesëm, për të tretët arsim sipëror. Zakonisht, si më të rëndësishëm llogariten rolet për përgatitjen e të cilave është e nevojshme më tepër kohë.

Kështu, p.sh., rolet mjek, gjykatës, inxhinier dhe të ngjashme, për të cilat është e nevojshme arsim shumëvjeçar përcaktohen si më të rëndësishme se rolet pastrues, karrocier, gërryes dhe të ngjashëm., për të cilat nuk nevojitet aq arsimim i gjatë. Nga ana tjetër, shumë çmohen edhe ato role për të cilat kërkohet të kenë talente specifike. Është e nevojshme të kenë aftësi të mira të dëgjimit dhe aftësi të mira të zërit për t'u bërë këngëtar, talent për vizatim për t'u bërë piktorë dhe të ngjashme. Këto aftësi nuk janë shumë të shpeshta mes njerëzve dhe prandaj ata të cilët i kanë duhet të motivohen.

Lëvizshmëria shoqërore

Lëvizshmëria shoqërore (mobiliteti) paraqet ndryshim të vendit dhe pozitës së individëve dhe të grupeve shoqërore në shoqëri, më sakt ndryshime në profesione.

Lëvizshmëria horizontale shoqërore realizohet atëherë kur një individ (grup) kalon në vend të ri të punës, i cili përafërsisht është njësoj i paguar dhe i vlerësuar si i pari. Për shembull, kur një motër medicinale do të trajnohet për fizioterapi ose për punë në sportel nga komuna kalon si punonjëse në arkivin e gjykatës. Individit e ndryshoi vendin e punës, por ai ka të njëjtat të ardhura, fuqi dhe prestigj si në vendin e punës së parë.

Lëvizshmëria vertikale nënkupton lëvizje në profesion sipas vertikales përpjetë ose tatëpjetë. Nëse ndonjë inxhinier ka filluar të punojë si inxhinier i energjisë në ndonjë fabrikë, kurse më vonë bëhet udhëheqës i grupit të menaxhimit në fabrikën e njëjtë ose në një fabrikë tjetër, atëherë ne themi se ka realizuar lëvizshmërinë e grupit të menaxhimit në fabrikën e njëjtë ose në një fabrikë tjetër, atëherë ne themi se ka realizuar lëvizshmëri vertikale të përpjetë. Lëvizshmëri tatëpjetë do të realizonte nëse për shkak të konsumimit të madh të alkoolit nga udhëheqës bëhet rojtar i ndonjë objekti ndërtimor.

Në shoqëritë e vjetra, në të cilat vendi i individëve në shoqëri ishte përcaktuar me rregulla, njerëzit nuk kishin mundësi ta ndryshonin pozitën e vet shoqërore. Pjesëtarët e një gjenerate kishin pozitë të njëjtë si edhe prindërit e tyre, dhe kjo vazhdonte në më tepër gjenerata. Megjithatë, në shoqëritë moderne, në të cilat pozita shoqërore në masë më të madhe është e përcaktuar përmes arritjeve të individëve, një numër i madh i pjesëtarëve të secilës gjenerate arrin pozitë më të lartë nga prindërit e tyre. Në këtë lëvizje të përpjetë më i madh është roli i arsimit.

Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato



1. Çka nënkuptojmë me shtresim i shoqërisë?
2. Cilat llojet të sistemeve të shtresimit i njeh?
3. Çka nënkuptojmë me lëvizshmëri shoqërore?

Detyrë



Përpiquni të identifikoni shtresat e shoqërisë në Maqedoni, dhe pastaj klasifikojini profesionet sipas çmueshmërisë?

Grupet etnike

Çka nënkuptojmë me grupe etnike?

Grupet etnike (greqisht “ethnos” – popull) janë të përhershme dhe më tepër – grupet funksionale shoqërore, të cilat u krijuan historikisht me bashkimin dhe jetën e përbashkët të më tepër grupeve të përafërta në ndonjë territor.

Në histori ka ndodhur, ndërsa edhe sot ndodh që njerëzit me karakteristika të caktuara kulturore të hyjnë në përbërjen e shteteve në të cilat shumica e popullsisë kanë karakteristika tjera kulturore. Më herët ka ndodhur me shpërnguljen e popujve dhe luftërave, kurse sot njerëzit, duke kërkuar ekzistencë më të mirë e lëshojnë vendin e vet dhe krijojnë vendbanime në vende të tjera më të pasura dhe më të zhvilluara.

Sot, popullsia në më tepër shtete të botës nuk ka karakteristika të vetme kulturore. Pothuajse në të gjitha vendet ekzistojnë kategori të popullsisë të cilët nga të tjerët dallohen sipas prejardhjes, sipas gjuhës, religjionit, traditës dhe karakteristikave të tjera. Ata e shohin veten si të ndryshëm nga shumica e popullsisë, kurse edhe ajo, gjithashtu, i sheh si të ndryshëm nga vetvetja. Këto kategori shkenca i quan **pakica etnike**, kurse në të folurit e përditshëm i takojmë si grupe etnike ose komunitete.

Grup etnik quhet ai grup anëtarët e së cilës kanë traditë kulturore të përbashkët dhe ndjenjë të përbashkët të identitetit. Dallohen nga anëtarët tjerë të shoqërisë sipas disa karakteristikave. Më shpesh kanë gjuhën e vet, religjionin, zakonet e veta. Karakteristike për ata është ndjenja se janë më të ndryshëm nga të tjerët.

Distancimi etnik ose përafrimi

Nëdmjet pakicave etnike dhe popullsisë shumicë mund të vendosen më tepër lloje të raporteve, si për shembull: raporti i respektit dhe afërsisë midis veti, por edhe raporte të kundërshtimit mes veti, mostolerancës, mosrespektimi i dallimeve midis tyre, madje edhe konfliktet e hapura.

Në rastin e dytë realizohen proceset, të cilat gjithnjë e më tepër i distancojnë grupet, kurse më të rëndësishme mes tyre janë: *distancimi etnik ose ndarja, paragjykimet etnike dhe diskriminimi etnik*.

Vetëdija etnike

Kur ekziston kundërshtim i hapur ose i fshehur, pjesëtarët e grupeve etnike ndjehen të rregulluar dhe të kërcënuar në kuadër të grupit të shumicës. Atëherë fillojnë të praktikojnë sjelljet me të cilat dëshirojnë të ndjehen më të sigurtë në jetën e përditshme me grupin e shumicës. Kështu me pjesëtarët e grupit të vet ndërtojnë raporte më të afërta, sesa me pjesëtarët e grupeve të tjera, posaçërisht në lidhje me punën, lidhjet familjare, lidhjet martesore dhe lidhje të tjera. Ky drejtim kah vetja, i cili pjesërisht si pasojë e nevojës për të ndarë problemet e jetës me ata të cilët janë më të afërt, ndërsa pjesërisht në përpjekjen për t'i larguar nga vetja grupin e shumicës, kontribuon në zhvillimin e ndjenjës së dallueshmërisë etnike. Ata fillojnë ta paraqesin prejardhjen e tyre etnike, i theksojnë zakonet dhe shprehitë e veta, të cilat janë karakteristikë e tyre, si për shembull, paraqiten me veshje të ndryshme, si dhe me vendet ku e kalojnë kohën e tyre të lirë. Shpesh krijojnë vetëdije për vete si grup i ndryshëm, i kërcënuar dhe i rregulluar në raport me grupet e tjera në shoqëri dhe në këtë aspekt i edukojnë edhe gjeneratat më të reja, d.m.th., kultivojnë ndjenjë për vetëdije etnike ose identitet etnik. Por,

ajo ndjenjë kultivohet edhe kur grupi etnik nuk është i kërcënuar ose i shtypur nga grupi i shumicës edhe i gëzon të drejtat dhe ka kushte për zhvillim.

Paragjykimet etnike

Shpesh grupet e ndryshme etnike dhe rasore në një bashkësi përpigjen ndërmjet veti të vlerësohen. Ndodh që pjesëtarët e njëres grup ta vlerësojnë grupin e vetë si më të mirë, kurse për pjesëtarët e grupeve tjera me pavetëdije dhe pa argumente formojnë qëndrime dhe opinione negative. Në këtë rast bëhet fjalë për paragjyime etnike. Zakonisht, paragjykimet ndiqen nga emocione të forta dhe vështirë ndryshohen. I rëndojnë raportet në shoqëri dhe paraqesin burim të përhershëm të armiqësive dhe të konflikteve.

Diskriminimi etnik

Paragjykimet janë bazë për armiqësi të hapur. Kur ato do të zënë rrënjë në mes, kur kah pjesëtarët e një grupi do të shprehet urrejtje dhe gërditje për shkak se është pjesëtarë i atij grupi, e jo pse e meriton atë, atëherë hapen mundësi për sjellje armiqësore. Paragjykimet e hapin rrugën e diskriminimit, të mënyrës së sjelljes drejt të tjerëve, që nuk është korrekte. Atyre u ndalohet të hyjnë në vende, të cilat janë të paracaktuara për pjesëtarët e grupit të shumicës. Në konkurset për punësim nuk u jepet vendi i duhur për shkak se janë pjesëtarë të ndonjë grupi tjetër pakicë. Nuk i bëjnë shok dhe nuk martohen ndërmjet. U thonë fjalë të ashpra dhe fjalë ofenduese dhe bëjnë tallje në llogari të tyre.

Diskriminimi ende më shumë e thellon dhe e nxit armiqësinë ndërmjet grupeve etnike, që mund të sjellë deri te konfliktet e hapura dhe të dhunshme. Prandaj, njerëzimi lufton kundër paragjytimeve dhe kundër diskriminimit me shumë mjete: juridike, ekonomike, politike, kulturore.

Në shoqërinë tonë ka më tepër grupe etnike. Më shumë në numër prej tyre janë grupi etnik shqiptar, turk, rom, serb dhe vllah. Karakteristika themelore përmes së cilave ata dallohen nga populli shumicë maqedonas janë: gjuha dhe religjioni, gjegjësisht kombinimi i këtyre karakteristikave.

Multikultura

Ndërmjet grupeve etnike nuk është e thënë përherë të zhvillohen raporte armiqësore. Sot në shoqëritë e zhvilluara demokratike bëhen përpjekje të nxitet bashkëpunimi dhe respektimi reciprok ndërmjet grupeve të ndryshme etnike, pa mos u rrezikuar mbijetesa e karakteristikave të veçanta të kulturave të tyre. Secila kulturë i kultivon karakteristikat e veta të veçanta kulturore, dhe njëkohësisht ka respekt edhe për karakteristikat e grupeve të tjera në atë shoqëri. Kjo njohje e ndërsjellë krijon një multikulturë, e cila paraqet pasuri kulturore për një shoqëri dhe mundësi për të ndërtuar një klimë të qetë dhe të relaksuar për jetesë në atë shoqëri. Me rëndësi është qytetarët në një shoqëri të gëzojnë të njëjtat të drejtat qytetare dhe të njëjtën pozitë shoqërore.

Mëso më tepër



Miliona zezakë në Amerikë nuk i kishin të drejtat e njëjta si të bardhit. Ishin të distancuar nga të bardhit dhe ishin

vendosur në vende të posaçme për jetesë. Shkonin në shkolla të veçanta, vizitonin restorante dhe parqe të veçanta, krejt kjo për shkak të ngjyrës së zezë të lëkurës. Kjo zgjati deri në vitin 1965 kur zezakëve iu dha e drejta e votës. Në pjesët jugore të Amerikës u paraqit organizata e quajtur Klu Klux – klan, i cili filloi t'i terrorizojë zezakët. Ua digjnin shtëpitë, i rrihnin me këmba dhe i vritnin. Mbanin mbulesa të bardha. Vazhdimisht pohonin se Zoti është i bardhë dhe prandaj të gjithë njerëzit e zi duhet të jenë të nënshtruar.

Zaptuesit spanjollë, të cilët në mënyrë të pamëshirshme i grabitën vendet e zbuluara rishtas në Amerikën e Mesme dhe atë Jugore dhe i vritnin Indianët vendas, këtë e bënë me shpjegimin se indianët nuk janë njerëz si spanjollët.

Aktivitet hulumtues



Shkruani ese mbi temën: Të rinjtë dhe etnia në Republikën e Maqedonisë. Udhëzues për përpunimin e esesë le të jenë pyetjet vijuese:

1. Si janë raportet etnike në Maqedoni sipas jush?
2. A ekziston diskriminim etnik dhe si manifestohet?
3. Si është raporti i të rinjve drejt etnisë. A ekziston midis tyre padurim dhe si shprehet ai? Jep shembuj dhe argumente për këtë.

Dallimet gjinore

Si u krijua ideja për pabarazinë midis burrit dhe gruas

Shkencëtarët bëjnë dallim midis termeve gjini dhe seks. Kur e përdorin termin seks kanë parasysh dallimet biologjike ndërmjet njerëzve dhe ndarja e tyre në mashkullore dhe femërore. Termin gjini e përdorin kur dëshirojnë t'i nxjerrin në pah dallimet ndërmjet burrave dhe grave në raport me profesionet, pozitën të cilën e kanë në ekonomi, politikë dhe të ngjashme.

Në librin e parë “Zanafilla” e Mojsiut (Musës a.s), Zoti i thotë gruas: “Do t'i zmadhojë vështirësitë kur je shtatzënë; me dhimbje do të lindësh fëmijë dhe do të jesh nën urdhrin e burrit tënd dhe ai do të jetë pronari yt”.

Sipas kuptimit religjioz gruaja e ka bërë mëkatën e parë në parajsë. E ka shijuar pemën e ndaluar, e ka sjellë Ademin në sprovim dhe prej atëherë ajo vuan. Në të kaluarën, (por, për fat të keq edhe sot në disa shoqëri dhe kultura) ekzistonte kuptimi se burrat dhe gratë janë të ndryshëm në mënyrë biologjike dhe për këtë shkak duhet të ekzistojnë punë (detyra) burrash dhe punë grash. Sipas kësaj burrat shkonin në gjah, kurse gratë kujdeseshin për fëmijët. Këto role nuk ishin të çmuara në mënyrë të barabartë. Burrat gëzonin reputacion më të madh dhe kishin më shumë të drejta.

Kështu për shembull, gruaja në Afganistan nuk kishte të drejtë të arsimohet. Ajo



ishite plotësisht e mbuluar nga koka deri te thembrat dhe kur dilte jashtë shtëpisë duhej të shoqërohej nga një anëtarë i familjes (burrë). Gruaja malltrenohej edhe fizikisht, bile edhe nëse shihej se ha akullore. Në ishullin Alora në Indonezi, gratë merren me rritjen dhe mbledhjen e ushqimit dhe prandaj ato përherë ishin jashtë fshatit. Ditën e katërmëdhjetë të lindjes, gratë ktheheshin në fushë, kurse për foshnjën kujdeseshin fëmijët më të mëdhenj vëllezërit dhe motrat, babai, gjyshja dhe të ngjashëm. Në Pakistan ende është në zbatim zakoni prindërit të zgjedhin burrë vajzës së tyre.

Deri në vitet e 70-ta të shekullit XX, gratë në Gjermani duhet të merrnin leje nga bashkëshorti se pajtohen të shkojnë në punë.



Cila nga këto gra ka luftuar për të drejtat e saj?



"Bëheni burra, por mos i malltertoni gratë!" janë fjalë, të cilat ende i thonë gratë në mbarë botën.

Shkencëtarët e sotëm pohojnë se përveç lindjes së fëmijëve, që ekskluzivisht i takon gruas, të gjitha rolet tjera ajo i fiton nga bashkësia në të cilën jeton. Edhe pse sot nuk flitet më për atë nëse gruaja dhe burri duhet të jenë të barabartë, megjithatë parashtrohet pyetja: sa në të vërtetë i është mundësuar gruas së sotme të jetë njëkohësisht edhe nënë edhe grua e suksesshme në të gjitha sferat e jetës shoqërore? Nëse apeli për barabarësinë midis seksit mashkullor dhe femëror nuk arrin deri në veshët e të pangopurit për larjen e parave. Në Gjermani ekziston mundësi ligjore që njëri nga prindërit të shkojë në pushim pa pagesë në kohëzgjatje deri në 3 vjet. Punëdhënësi është i detyruar t'ia ruajë vendin e punës. Kjo mundësi është e hapur për të dy prindërit, por në realitet punët janë më ndryshe. Nuk është e mjaftueshme vetëm të thuhet se duam më tepër gra të punësuar. Nënkat kanë nevojë të kenë garancion për vend të punës me pagë të mirë dhe mbrojtja nga nxjerrja prej pune. Në shumicën e shteteve me natalitet të ulët, fëmijët llogariten pengesë për të arritur vend pune mirë të paguar dhe të çmuar. Ende gratë për punë të cilën e punojnë burrat, marrin 20% pagë më të ulët se ata.

Në shoqëritë demokratike burrat dhe gratë janë të barabartë. Grave u lejohet gjithçka që është e lejueshme për burrat. Gratë kanë edhe të drejta të veçanta të mbrojtura me dokumente të veçanta ndërkombëtare. Në ato dokumente theksohet kontributi i madh i gruas në familje dhe në shoqëri. Njëra prej tyre është Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas. Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente janë të detyruar të sigurojnë mbrojtje dhe të dënojnë çfarëdolloj diskriminimi ndaj gruas. Ata janë të obliguar të ndërmarrin masa adekuate të cilat do t'i mundësojnë gruas zhvillim dhe përparim të plotë në të gjitha sferat: në familje, politikë, në sferën e punës, në kulturë. Ata duhet të sigurojnë mundësi për kuptim të duhur të amësisë, për të cilën gjë gratë më shpesh janë të diskriminuara. Një numër i konsiderueshëm i njerëzve në shoqëritë e zhvilluara industriale, të cilët mendojnë se familje e suksesshme është ajo në të cilën burri duhet të punojë, ndërsa gruaja të kujdeset për fëmijët dhe për shtëpinë.

Gruaja moderne, shpeshherë gjendet e ndarë midis dëshirës për të qenë nënë e mirë dhe grua e suksesshme.

Kështu, për shembull, në Gjermaninë e sotme, 40% e grave me arsim sipëror e lënë anash amësinë në favor të përparimit në profesion. Nga ana tjetër, 40% e grave të cilat kishin vendosur të bëhen nëna, pas lindjes nuk kthehen në punë. Gratë shpesh janë viktime të dhunës familjare dhe tregtisë me njerëz. Supozohet se 4 milion persona në vit në botë janë viktimë e tregtisë me njerëz, prej të cilëve pjesa më e madhe janë gra dhe fëmijë. Nëpërmjet premtimeve të rrejshme për punë të cilat i japin kriminelët, një numër i madh i grave në botë futen në zinxhirin e shitjes dhe të prostitucionit. Në disa mjedise gratë ende janë viktime edhe të dhunës familjare, e cila shkakton fyerje tmerruese, maltretim psikik dhe fizik,

lëndime trupore, kërcënim ndaj sigurisë së saj dhe humbje të dinjitetit.

Detyrë



Lexoni tekstin, pastaj nxirrni përfundim.

1. Si ndikon karriera e suksesshme e një gruaje mbi martesën e bashkëshortëve?
2. Gjeni në tekst qëndrime diskriminuuese të seksit dhe mendimet e burrit?
3. Cilat janë parashikimet e juaja për këtë martesë?

Karriera e gruas – stres – test për martesën

Ora është 6:30 e mëngjesit dhe bashkëshortja sapo doli për në punë. Para tre muajve ajo filloi karrierë të re si broker në bursë. Bashkë ramë në përfundim se është një ide e mirë: dhe se ajo mund ta tregojnë talentin e vet dhe se do të rriten të ardhurat tona. Përfunduam se arritën 5 minutat e saj dhe se kjo duhet të shfrytëzohet.

“Ne kemi martesë të mirë. Ti je e re dhe e aftë, duhet të ndërtosh karrierë.” – e këshilloja.

Ajo 22 vitet e fundit kujdesej për nevojat tona. Ajo kryente me mijëra punë, kaloi mijëra kilometra me veturën, kujdesej për financat në familjen tonë, i ndreqte defektet në shtëpi dhe sipas meje ajo ishte edhe grua edhe burrë në shtëpi. Tash gjithçka ndryshoi dhe nuk është e lehtë, siç mendoja se do të jetë. Në sipërfaqe dolën brengat, dyshimet, shenja të xhelozisë dhe të ofendimit.

Derisa po vozitja deri në zyrën time, dëgjoja radio se burrat, gratë e të cilëve punojnë duhet të kenë më pak pritshmëri, sesa burrat gratë e të cilëve janë amvise.

Por, gruaja ime më nuk shkon në shitore për të blerë, gjithnjë e më pak i hekuros teshat, kurse kopshti mbeti pa kositur.

Unë nuk i vizitoj kurrë shitoret, por dukem shumë qesharak kur jam i veshur me kostum dhe e shty qerren e shitores dhe duhet të rikujtohem (nga lista) çfarë duhet të blej. Desha të zhdukem kur më takoi një shoqe dhe më pa në dorë që mbaj një kuti të madhe me pluhur për larje, kurse në tjetrën pelenat për vajzën më të vogël. Me ngushëllim në sytë e saj më pyeti nëse është gjithçka në rregull. Në vend se të përgjigjem, u drejtova kah pika e pagimit. Pagova dhe u largova.

Kur arrita në shtëpi, vetura e gruas nuk ishte. Edhe një traumë tjetër. Ajo përherë më përqaftonte pa hyrë brenda, kurse tash ende nuk është kthyer. Shtëpia ishte e errët, pa errën e gurabijave të freskëta, kurse gjithçka që bleva nga shitoret duhet t'i vendos diku në kuzhinë.

Nuk mund të shkojmë as në pushim bashkë. Më paralajmëroi se do të shkojë 7 javë në trajnim. Ajo ishte plotë me entuziazëm të ri. Karriera e saj kërkon energji maksimale dhe kohë. Dhe çka me mua? Ajo dhemb, më mbush me indinjatë. Atëherë pse jemi në martesë?

UNË, QYTETARI

Çfarë jemi si qytetarë dhe shtetas

“Anëtarët e përbashkët të një shoqërie quhen popull, veçmas si pjesëmarrës në pushtetin më të lartë quhen qytetarë, kurse si subjekte të pushtetit qendrorë – shtetas”.

Zhan Zhak Ruso

Njeriu sipas natyrës së vet është i paracaktuar të jetojë në shoqëri. Kjo d.m.th se vetëm në bashkësinë shoqërore, me njerëzit të tjerë dhe bashkë me ata mund të jetojë, të krijojë, të prodhojë dhe t'i përmbushë nevojat e tij jetësore, shpirtërore dhe kulturore. Por, për të jetuar sëbashku dhe për të bashkëpunuar, raportet midis njerëzve duhet të jenë të rregulluara me rregulla. Rregullat e përbashkëta u tregojnë individëve sesi duhet të sillen. Zakonet i drejtojnë në sjellje të ndershme dhe të njerëzishme (të përshëndeten, të qëndrojnë në rend kur rinë në bankat shkollore, postë, shitore, të përdorin vegëlëri për haje dhe të ngjashme).

Ligjet janë rregulla të shkruara. Ato i përcakton shteti. Nuk ka sferë të jetës shoqërore në të cilën nuk ekzistojnë ligje, për shkak se ato u mundësojnë njerëzve siguri dhe jetë të sigurtë.

Por, për ta mbajtur rendin në shoqëri nuk janë të mjaftueshme vetëm rregullat. Ato rregulla duhet të respektohen. Respektimi i rregullave është obligim i secilit pjesëtar të shoqërisë.

Mosrespektimi i ligjeve nga ana e individëve llogaritet për shkelje, kurse

për secilën shkelje shteti parasheh dënim (gjobë, burg, dënim dhe të ngjashme). Pra, shteti është mjeti më i fuqishëm për detyrim. Ai përmes aparatit të tij shtetëror (ligjeve, gjykatave, policisë, ushtrisë) i detyron pjesëtarët e shoqërisë t'i respektojnë rregullat. Prandaj themi se të gjithë njerëzit janë pjesëtarë të shtetit, gjegjësisht ata janë njerëz të tij, shtetas.

Shtetësia është lidhje e përhershme juridike dhe politike e individit me një shtet në të cilin jeton. Ajo lidhje rregullohet me akt të veçantë ligjor, në të cilin janë të përfshira të drejtat, liritë dhe detyrat e shtetasve në raport me shtetin dhe e kundërta.

Shteti nuk është mjet vetëm për të detyruar. Ai i mbron shtetasit edhe nga rreziqet dhe sulmet e jashtme, respektivisht organizon mbrojtje të bashkësisë. Gjithashtu, organizon mbrojtje edhe nga fatkeqësitë natyrore dhe elementare, e ruan qetësinë e brendshme dhe rendin në shoqëri, u ndihmon shtetasve, të cilët kanë nevojë për ndihmë sociale dhe kryen shumë funksione të tjera shoqërore.

Qytetarët kanë të drejtë t'i parashtrojnë kërkesa shtetit, por kanë edhe obligime dhe detyrime ndaj tij. Ata kërkojnë nga shteti mbrojtje, t'i sigurojë dhe të kujdeset për ta, por prandaj ata kanë obligime të paguajnë tatime. Domethënë, pjesëmarrja e qytetarëve në jetën shoqërore nuk nënkupton vetëm kërkesa të qytetarëve nga shteti, por pranim dhe shlyerje të obligimeve ndaj tij.

Qytetar është njeriu, i cili i gëzon të drejtat dhe liritë e njeriut në një shtet, por i cili ka përgjegjësi ndaj tij.

E drejta e qytetarit nuk fitohet me lindje. Ajo e drejtë fitohet në një periudhë të caktuar të jetës. Ekziston dallim midis shtetasit dhe qytetarit. Në disa shtete, posaçërisht në të kaluarën, njerëzit trajtoheshin vetëm si njerëz të shtetit.

Stevan Nemanja, një sundues serb në mesjetë në një rast iu drejtuar njerëzve të vet me fjalët:

“Fëmijë të mi të rritur nga unë. Të gjithë ju e dini se Zoti në të menduarit e tij më caktoi mua të suundoj me ju; dhe si në fillim gjeta një tokë të shkatërruar; dhe si me ndihmën e zotit, aq sa kisha fuqi nuk i lashë vetes hapësirë për të pushuar deri sa nuk rregullova gjithçka. Dhe me ndihmën e perëndisë u shtova edhe në gjatësi edhe në gjerësi, siç e dini të gjithë...Prandaj, fëmijë të mi, të dashur mos harroni mësimin e të drejtës suaj dhe të së drejtës së predikuar nga unë”.

Xhozef Voren, mjek dhe politikan amerikan i shekullit të 18 për qytetarët tha:

“...Nuk ka dyshim se e drejta më e madhe dhe më e rëndësishme e qytetarit britanik është se ligjet e tyre nuk mund të drejtojnë me atë, me përjashtim të atyre, për të cilët ai ka dhënë pajtimin e vet, qoftë personalisht ose përmes përfaqësuesve të vet. Kjo është bazë e lirisë dhe e themelit britanik të kushtetutës britanike, kopja e të cilës është edhe kushtetuta jonë (amerikane). Pa pajtueshmërinë tonë nuk ka askush të drejtë të mos tatimojë...”

Nëse i krahasojmë këto dy tekste do të vërejmë se bëhet fjalë për forma të ndryshme të pushtetit – monarki dhe demokraci. Edhe njerëzit edhe qytetarët u nënshtrohen ligjeve. Por, njerëzit u nënshtrohen ligjeve, të cilat janë sjellë pa pajtimin e tyre, ndërsa qytetarët i respektojnë ligjet të cilat janë sjellë në

kuvend. Ndërsa në kuvend vendosin deputetët e zgjedhur nga qytetarët.

Çka nënkuptojmë me pushtet dhe për çfarë shërben

Shoqëria paraqet një grup të madh njerëzish të cilët jetojnë dhe bashkëpunojnë bashkë. Por, jeta e përbashkët është e pamundur, nëse në atë nuk ekziston pushtet. Pushteti i sjell rregullat e përbashkëta të sjelljes. Ato u tregojnë anëtarëve të shoqërisë si duhet të sillen dhe çka nuk guxojnë të bëjnë.

Për ata, të cilët i sjellin dhe i zbatojnë rregullat, themi se kanë fuqi mbi të tjerët. Prandaj, fuqia përkufizohet si mundësi dikush të imponojë vullnetin e vet mbi të tjerët, të ushtrojë kontroll mbi punën dhe mbi sjelljen e të tjerëve.

Ekzistimi i pushtetit është i pashmangshëm dhe prandaj pyetja thelbësore në secilën shoqëri është: si të rregullohen raportet ndërmjet pushtetit dhe popullit? Ata, të cilët qeverisin, duhet ta dinë pse qeverisin, dhe kush u ka dhënë pëlqim për të qeverisur. Fuqi më të madhe në shoqëria ka **shteti**.



Detyrë

Lexoni tekstin, pastaj nxirrni përfundim, pse është i nevojshëm ekzistimi i pushtetit.

Njëra nga synimet më të rëndësishme në shoqërinë e indianëve Siuks ishte si të organizohet gjah i suksesshëm. Për këtë qëllim ishte i nevojshëm bashkëpunimi i mirë ndërmjet anëtarëve, si dhe raportet e mira të vendosura të fuqisë.

Gjatë muajve të verës, bizonët të cilët ishin burim kryesor i ushqimit të fisit, mbledheshin në kope të mëdha të një terreni të rrafshët në Amerikën Veriore. Gjuajtja e bizonëve ishte një lëvizje në shkallë të madhe. Gjuetia e suksesshme kërkonte organizim të përpiktë, udhëheqësi dhe disiplinë të rreptë.

Për këtë qëllim ishin vendosur sherifët. Gjuetia zhvillohej sipas urdhrat dhe pushtetit të tyre. Sherifët kujdes të madh u kushtonin luftëtarëve të rinj të padurimtë, të cilët mund të nisnin në aksion më herët, ta frikësojnë kopenë e bizonëve dhe ata të iknin. Kjo nuk guxonte të ndodhte, për shkak se bizonët ishin ushqimi kryesor i fisit. Prandaj, sherifëve u ishte dhënë pushteti t'i rrahin të gjithë ata, të cilët nuk u binden rregullave. Me vetë faktin se fisi u kishte dhënë fuqi sherifëve të dënojnë, ata në realitet e pranonin fuqinë e tyre si të arsyeshme.

Duke pranuar fuqinë, ata në realitet pranuan të nënshtrohen për shkak se nga nënshtrimi kishin dobi. *Kur nënshtrimi i fuqisë është i pranueshëm, për atë fuqi themi se ka kaluar në pushtet.*

Shteti është bashkësi organizative e njerëzve, i cili ka të drejtë dhe fuqi të gjithanshme të rregullojë raportet në një bashkësi dhe në territorin e tij, duke përfshirë edhe përdorimin e detyrimit.

Si fitohet pushteti

Në varësi të asaj kush e ka pushtetin dhe si e ka fituar pushteti mund të jetë: demokratik, monarki, tirani dhe diktaturë. Nëse pajtueshmërinë atyre që qeverisin ua ka dhënë populli, atëherë bëhet fjalë për pushtet demokratik. Në qoftë se ai nuk është dhënë nga populli, por është marrë me dhunë atëherë e kemi fjalën për pushtet jodemokratik.

E drejta dhe fuqia e gjithanshme e rregullimit të raporteve në atë shoqëri dhe në atë territor quhet **sovrانيت**, ndërsa atë që shteti e kryen sovranitetin e ligjeve në mënyrë plotësisht të pranuar, quhet **legjitimitet**.

Në shoqëritë demokratike qytetarët e zgjedhin pushtetin. Zgjedhja bëhet me votim të fshehtë. Votimi i fshehtë është formë e shprehjes, e cila siguron anonimitet të plotë, gjegjësisht, votimi nuk mund të kontrollohet nga ana e organeve shtetërore, d.m.th., sovraniteti i takon popullit për shkak se del nga



Pushteti mund edhe të trashëgohet

populli. Kështu për shembull, nëse pjesëtarët e shoqërisë së Maqedonisë kanë pranuar se Kuvendi (Parlamenti) kanë të drejtë të sjellin vendime të caktuara edhe nëse ato vendime i konsiderojnë ligjore, atëherë pushteti i kuvendit bëhet legjitim, pushtet i pranuar.



Në demokraci pushteti zgjedhet

Sovraniteti ka rëndësi të brendshme dhe ndërkombëtare. Pikërisht, shtetet tjera nuk guxojnë të përzihen në punët e brendshme të atij shteti. Ato duhet ta respektojnë pushtetin e atij territori, rendin e brendshëm të tij, dispozitat shtetërore, ligjet. Zakonisht, shtetet njihen ndërmjet veti, dhe vendosin të ashtuquajturat marrëdhënie diplomatike.

Sovraniteti i shtetit ka edhe simbolet e veta: stemën, flamurin dhe himnin e shteti. Respektimi i sovranitetit nënkupton respektimin e atyre simboleve.

Në nenin e parë të Kushtetutës është shkruar se “Republika e Maqedonisë është shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe shtet social”. Ai është sovran për shkak se mund dhe ka fuqi vetë t’i rregullojë marrëdhëniet në territorin e vet pa intervenime nga jashtë. Ai është demokratik për shkak se pushteti i takon popullit, qytetarëve (pushtetin e ushtrojnë drejtpërdrejtë, përmes përfaqësuesve të

zgjedhur). Maqedonia është shtet social për shkak se u takon të gjithë qytetarëve dhe për shkak se u jep ndihmë sociale atyre shtresave shoqërore, të cilat kanë nevojë për atë.

Kushtetuta e një shteti është akti më i lartë ligjvënës, i cili del nga sovraniteti i shtetit dhe i rregullon parimet e raporteve shoqërore dhe organizimin e shtetit. Të gjitha ligjet, dispozitat dhe normat në shtet, të cilat i përcakton cilido organ shtetëror, duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën. Përndryshe themi se janë jo kushtetues ose në kundërshtim me kushtetutën dhe rendin e shtetit.

Në nenin 8 të Kushtetutë së Republikës së Maqedonisë thuhet se pushteti

· i garanton liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit,

- do t’u mundësojë qytetarëve të drejtë, lirisht të shprehin përkatësinë e tyre kombëtare,
- do të mundësojë qeverisjen e të drejtës
- do të ndahet në pushtet ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor,
- do të sigurojë zgjedhje demokratike të lira dhe të drejtpërdrejta,
- do të mbrojë pronësinë e qytetarëve,
- do të mundësojë vetëqeverisje të mjediseve lokale,
- do të kujdeset për rregullimin, humanizmin dhe përparimin e mjedisit jetësor.



Nxirrni përfundim:

Shteti është i fuqishëm dhe organ i gjithanshëm shoqëror, i cili detyron të gjithë t'i respektojnë normat e sjelljes të përcaktuara në një shoqëri. Por, shteti nuk është vetëm mjet detyrimi. Ai i mbron shtetasit e vet edhe nga rreziqet dhe sulmet e jashtme, gjegjësisht organizon mbrojtje të një bashkësie të dhënë. Ai, gjithashtu, i mbron pjesëtarët e vet nga fatkeqësitë natyrore dhe elementare, e ruan qetësinë e brendshme, sigurinë dhe përparimin, i ndihmon shtetasit, të cilët kanë nevojë për ndihmë sociale dhe ka shumë funksione tjera.

Si e para, askush në mbretëri nuk mund të jetë i uritur. Banorët e Sikellit vetë prodhojnë ushqim dhe ai ushqim u ndahet të gjithëve. Secila familje fiton shtëpi në shfrytëzim pa kompensim. Madhësia e shtëpisë varet nga numri i anëtarëve në familje. Gazi për amvisni dhe për ngrohjen e shtëpive, si dhe riparimet e shtëpive janë pa pagesë. Mjeku është përherë në dispozicion për të gjithë të sëmurët, kurse në 6 muaj, secili banor i Sikellit mund pa pagesë të bëjë kontrollim sistematik të shëndetit të tij. Profesionalistët shëndetësorë rregullisht i vizitojnë njerëzit e moshuar, foshnjat dhe të gjithë ata, të cilët kanë nevojë për kujdes.

Detyrë për meditim



Lexoni tregimin për Mbretërinë Sikell, pastaj shkruani një ese sipas pyetjeve vijuese:

Kush e ka mbretërinë Sikell? Çfarë pushteti është?

A janë të lumtur banorët në një pushtet të tillë?

A është pushteti i mbretërisë Sikell forma e vërtetë e pushtetit që u duhet njerëzve?

A do të kishit dashur që edhe shoqëria juaj të jetë e organizuar si mbretëria Sikell?

Në mbretërinë Sikell të gjitha sendet e mira janë në dispozicion për secilin. Secila familje fiton kupona, me të cilat mund të blejë prodhime luksoze: parfum, stoli, erëza dhe të ngjashme.

Si mundën banorët e Sikellit gjithë këtë ta organizojnë?

Me mbretërinë Sikell gjithmonë ka sunduar familje mbretërore. Sundues i tanishëm është mbreti Sik i treti. Ai vendos për numrin e punëtorëve, për prodhimin e ushqimit, për ndërtimin e shtëpive, për shërbimin mjekësor. Qysh në moshën 5 vjeçare, fëmijët dërgohen në shkollim në shkollat adekuate. Mbreti më së miri e di kush për çfarë është i talentuar, të jetë mekanik, ose mjek. Të gjithë të tjerët, kur do të arrijnë moshën e caktuar, mbreti Sik i punëson në pallatin e vet mbretëror.

Më e çuditshme është se në mbretëri nuk ekzistojnë të holla. Askush nuk merr rrogë, për shkak se çdokush merr aq sa ka nevojë.

Ndoshta mund të pyetni, a ka dikush që ankohet për diçka në mbretërinë Sikell. Kjo ndodh shumë rrallë. Kush do të ishte ankuar nga një jetë e tillë, apo jo?

Mbretëria Sikell

Mbretëria Sikell gjendet lartë në disa male. Me shekuj thuhet se nuk ka kontakt me pjesën tjetër të botës.

Mbretëria Sikell, edhe pse është shumë e vogël, tërheq interes të madh. Arsye për këtë është organizimi shumë i pazakontë i jetës në mbretërinë.

Detyrë

Sipas jush, cilat nga funksionet e përmendura i ka shteti modern.

Të shtypë të holla dhe të mbledhë tatime	Të organizojë prodhim
Të mbajë disiplinë mes qytetarëve	T'i mbrojë kufijtë shtetërorë
Të nxisë zhvillim teknologjik	Të organizojë gara sportive
Të ruajë qetësinë dhe rendin publik	Të botojë gazeta dhe të emitojë programe televizive
T'ju japë kredi qytetarëve	T'i punësojë të papunët
Të sjellë ligje dhe dispozita ligjore	T'i mbrojë dhe t'i respektojë të drejtat e qytetarëve
Të organizojë zgjedhje për deputetë	Të ndërtojë fabrika

TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT

Prejardhja dhe zhvillimi i idesë për të drejtat e njeriut

Ideja për të drejtat e njeriut si edhe të gjitha nocionet tjera të rëndësishme të lidhura me ato (jeta, liria, barazia, drejtësia) është e vjetër. Rrjedh nga shtetet antike të Evropës, kurse më vonë ngadalë dhe me më vështirësi depërtoi nëpër mesjetë, deri në fillimet e revolucioneve moderne qytetare në shekullin 18 dhe më vonë.

Kështu, për shembull, nga këngët e Homerit mund të nxjerrim përfundim se në kohën e tij nuk janë respektuar dhe nuk janë çmuar të gjithë njerëzit në mënyrë të barabartë. Më tepër çmoheshin njerëzit, të cilët dalloheshin me aftësi fizike, posaçërisht fitimtarët e garave sportive. Çmohej edhe trimëria luftarake dhe pasuria, përmes tyre nxirrej në pah personaliteti i individit.

Poeti antik Hesiodi, (shek. 8 p.e.s.) e përshkruante punën si tipar njerëzor, i cili krijon mirëqenie dhe siguri shoqërore. Punën dhe drejtësinë i llogariste për matje sipas të cilave përcaktohej morali i individëve. Në këngën e tij "Punë dhe ditë" ai thotë:

"Çdoherë keni kujdes për drejtësinë dhe dhunën asnjëherë mos e mendo, njerëzve ligj – të këtillë u dhuroi Zoti i lartë; peshqit, shtazët grabitqare dhe shpezët me krah njëri tjetrit ta hanë, për shkak se nuk e dinë të drejtën; njeriut i dhuroi drejtësi dhe ajo është e mira më e madhe"

Sipas Aristotelit "njerëzit sipas natyrës janë ose të lirë ose skllav. Sundimtari është pronar i skllavit, i cili atij i takon plotësisht, për shkak se ai, i cili sipas natyrës i takon tjetrit, e jo vetëm vetvetes, është skllav. Skllavi është pronë e dikujt, kurse pronësia është mjet për përdorim dhe prandaj sundimtari ka të drejtë të shërbehet me skllavin. Skllavi është pjesë e gjallë e pasurisë, ai është mjet i gjallë. Skllavërit janë të domosdoshëm për shkak të mirëmbajtjes së familjes, por edhe për të qenë qytetarët të lirë nga kryerja e punëve të rënda fizike. Ata duhet të kenë kohë të lirë të përgatiten për kryerjen e punëve shtetërore".

Iluzioneve të Aristotelit iu kundërvu Alkidamanti. "Zoti të gjithë i la të lirë, asnjërin natyra nuk e bëri skllav". Me këtë fjali nga "Ligjëratë e gatuar" e mbron dinjitetin njerëzor dhe lirinë e njeriut si të drejta natyrale të njeriut.

Më vonë e njëjta fjali do të gjendet edhe në nenin e parë të deklaratos franceze për të drejtat e njeriut, si vijon: “Njerëzit lindin dhe janë të barabartë në të drejtat e tyre”.

Jeta e njerëzve në mesjetë zhvillohej sipas rregullave kishtarë. Në religjionin e krishterë barabarësia dhe drejtësia ndërmjet njerëzve ishte shprehur përmes besimit të përbashkët në Jezu Krishtin. Dhjetë urdhërat llogariteshin rregulla, sipas të cilave njerëzit i drejtojnë sjelljet e veta.

Zakonisht të drejtat dhe liritë e njeriut përfshihen dhe përcaktohen në akte juridike të shteteve të veçanta dhe të bashkësive ndërkombëtare. Sipas rregullës ato janë kushtetutat e shteteve, deklaratat, konventat ndërkombëtare, paktet, etj. Gjatë historisë ka shumë dokumente të tilla.

Në vitin 1215 në Angli, ishte përgatitur një dokument, i cili do të jetë bazë për deklaratat e ardhshme të mëdha për të drejtat e njeriut, i njohur me emrin **“Magna Carta Libertatum” – Karta e madhe për lirinë**. Karta u paraqit si revoltë ndaj baronëve – feudalët kundër mbretit Xhon, i cili i kufizonte të drejtat e tyre.

Në gusht të vitit 1789 feudalizmi në Francë pushoi së ekzistuari. Pushteti i mbretit Lui i XVI ishte rrënuar dhe kishte kaluar në duart e përfaqësuesve të popullit (Kuvendit). Të gjithë francezët u bënë të barabartë përpara Ligjit, paguanin tatime në mënyrë të barabartë dhe kishin të drejtë në të gjitha funksionet shtetërore.

Me 26 gusht të vitit 1789 Kuvendi Popullor i Francës e solli **Deklaratën për të drejtat e njeriut dhe qytetarit**. Në atë shkruante: “Njerëzit lindin dhe ngelin të lirë dhe të barabartë në të drejtat e tyre”. Shteti duhet t’i garantojë të drejtat e patjetërsueshme të njeriut dhe

qytetarit dhe atë: lirinë e të menduarit, lirinë e besimit, mbrojtja nga paraburgimi vullnetarë dhe imponimi i tatimeve, e drejta e pronësisë, e drejta e votës e kushtëzuar me posedimin e pronës.

Gjatë Luftës së dytë botërore nazizmi gjerman bëri gjenocid ndaj hebrenjve dhe ndaj romëve. Kjo e detyroi Bashkësinë Ndërkombëtare të përgatisë një dokument, me të cilin do t’i rregullojë raportet juridike dhe humanitare ndërmjet shteteve dhe do ta ruajë paqen. Dokumenti është quajtur Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut.



Eleanor Ruzvelt me Deklaratën universale

Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut është miratuar në Asamblenë e përgjithshme në Kombet e bashkuara në Paris, me 10 dhjetor të vitit 1948 dhe përmban 30 nene. Deklarata universale u krijua për shkak se: “mosrespektimi dhe mospërfillja e të drejtave të njeriut shpie drejt veprimeve barbare, të cilat e fyejnë ndërgjegjen e njerëzimit; për shkak të krijimit të botës në të cilën qeniet njerëzore do të gëzojnë lirinë e fjalës dhe të besimit, do të jenë të lirë nga frika dhe skamja.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, liritë dhe të drejtat e njeriut, të cilat janë të pranuar ndërkombëtarisht, mund të ndahen në dy grupe më të mëdha. Në grupin e parë bëjnë pjesë të drejtat dhe liritë qytetare dhe politike, kurse në grupin e dytë të drejtat dhe liritë ekonomike, sociale dhe kulturore. Këto të drejta dhe liri vlejnë në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët e saj.

Mbani mend



Të drejtat e njeriut i mundësojnë njeriut t'i përmbushë nevojat e tij elementare. Për një person themi se i gëzon të drejtat nëse shteti i ka mundësuar një jetë të denjë: të ketë shtëpi të mirë, të arsimohet, të punojë dhe për këtë të marrë kompensim adekuat, të merret me shkencë, të zgjedhë në cilin zot të besojë, të krijojë pasuri materiale dhe shpirtërore. Duhet të bëhet dallim ndërmjet dëshirave dhe nevojat elementare, për shkak se të drejtat e njeriut i mbrojnë vetëm nevojat elementare të njeriut. Por, në shoqëritë moderne nevojat e njeriut vazhdimisht rriten dhe me këtë vazhdimisht zgjerohet lista e të drejtave të njeriut.

Dokumentet më të njohura ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut sot janë:



Deklarata për të drejtat e njeriut dhe të qytetarit, 26 gusht 1789.

Deklarata universale për të drejtat e njeriut, në OKB të vitit 1948;

Pakti ndërkombëtar për të drejtat politike dhe qytetare, gjithashtu në OKB, viti 1966;

Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, gjithashtu në OKB, viti 1967;

Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, në Këshillin e Evropës, viti 1951.

Liritë dhe të drejtat politike dhe qytetare

Këto të drejta quhen edhe gjenerata e parë e të drejtave të njeriut. Të drejtat qytetare janë matës sipas së cilave vlerësohet si është pozita e qytetarëve në shoqëri: nëse shteti u siguron jetë të denjë dhe në çfarë niveli jeta e tyre është e siguar.

Përmes të drejtave politike vlerësohet sa qytetari është aktiv në politikë. Në këto të drejta bëjnë pjesë:

- E drejta e jetës
- Lirinë e besimit, vetëdijes, mendimit dhe të shprehurit në opinion
- Të drejtën në gjykim të drejtë
- Të drejtën e lirisë së shoqërimit
- Të drejtën e shtetësisë
- Të drejtën e votës

E drejta e jetës është e drejtë personale e qytetarit. Ato këtë të drejtë mund ta realizojnë vetëm nëse ndjehen si personalitete. Nëse askush nuk i degradon, nuk i dënon, nuk i mundon, nëse në mënyrë të pavarur zgjedhin vendbanim dhe martohen me dëshirë; nëse lirisht lëvizin dhe udhetojnë në kuadër të shoqërisë së vet, nëse mund lirisht të shprehin mendimet e veta dhe kur askush nuk u përzihet në jetën e tyre


private dhe familjare. Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë jeta e njeriut është e pacënueshme, dhe kjo d.m.th. se askujt nuk guxohet t'i kërcënohet jeta në asnjë farë baze. Me këtë të drejtë ndalohet çdo formë e mundimit, dënimit dhe sjelljes jonjerëzore.



E drejta e lirisë është e drejtë e pacënueshme e njeriut. Në këtë të drejtë bazohet edhe realizimi i shumë të drejtave të tjera. Ajo është shprehje e humanizmit dhe është bazë e demokracisë. Sipas kësaj të drejte askujt nuk mund t'i kufizohet liria, përveç me vendim të gjykatës. Ashtu shkruan edhe Neni 12 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë “asnjë qytetari nuk guxohet t'i kufizohet liria, përveç nëse ashtu ka vendosur gjyqi”. Sipas Ligjit për përfaqësim të drejtë, çdo person, i cili është thirrur ose është arrestuar në stacionin policor duhet menjëherë t'i shpjegohen arsyet pse është i dyshuar, kurse në afat prej 24 orë nga momenti i arrestimit të nxirret para gjyqit. Gjatë procedurës gjyqësore çdo person ka të drejtë të thërrasë mbrojtës dhe të mbrohet në liri. Personi, i cili është i akuzuar për ndonjë vepër të dënueshme do të llogaritet si i pafajshëm derisa të dëshmohet e kundërta me vendim gjykate.

E drejta e lirisë i mundëson qytetarit të lëvizë lirshëm në territorin e shtetit dhe i lirë mund të zgjedhë vendbanim.

Liria e besimit, ndërgjegja, liria e mendimit dhe të shprehurit publikisht janë liri të garantuara të çdo personi. Përmes tyre njeriu mund të shprehë individualitetin dhe dinjitetin e tij, të ndjehet i barabartë dhe me të drejta të barabarta. Këto liri i mundësojnë personit në mënyrë publike, me fjalë ose me mjete të tjera (karikatura, piktura) t'i shprehë pikëpamjet e tij për jetën, bindjet e tij madje edhe kur janë më të ndryshme prej të tjerëve. Kuptohet, këto liri personi nuk guxon t'i keqpërdorë.



Çdokush ka të drejtë të zgjedhë besimin e tij

Prandaj, zakonisht në shtetet demokratike, ndalohet me ligj fjalimet dhe paraqitjet publike të cilat nxisin urrejtje kombëtare, fetare dhe racore. Në kuadër të këtyre **lirive bëjnë pjesë edhe ato me të cilat u lejonet qytetarëve të parashtrojnë sugjerime, pandehje dhe ankesa** deri tek organet kombëtare, ndërkombëtare dhe shërbimet publike. Liritë e këtilla të qytetarëve e detyrojnë pushtetin të punojë në mënyrë transparente. Qytetarët kanë të drejtë të informohen përmes mediumeve (të shkruara dhe elektronike) se çfarë ndodh në shoqëri.



Të drejtat e njeriut në vepër.

E drejta e lirisë së besimit është e drejtë personale. Nënkupton mundësi për qytetarin lirshëm, sipas vetëdijes së vet të zgjedhë besimin të cilit do t'i përkulet. Kjo e drejtë e përfshin edhe lirinë – qytetari ta ndryshojë religjionin e tij ose bindjen, në mënyrë individuale ose në bashkësi me njerëz të tjerë, në mënyrë private ose publike, ta manifestojë religjionin ose bindjen e vet përmes mësimdhënies, adhurimit ose liturgjisë.

E drejta e lirisë së shoqërimit është e drejtë thelbësore e qytetarëve. Duke u thirrur në këtë të drejtë, njerëzit kanë mundësi të veprojnë bashkë, posaçërisht në politikë. Në bazë të kësaj të drejte qytetarët formojnë parti politike, sindikate, bashkësi fetare, shoqata për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, shoqata vullnetare dhe në këtë mënyrë i shprehin bindjet e tyre politike, ekonomike, kulturore dhe bindje tjera.

Bashkësitë e këtilla kanë për qëllim t'i aktualizojnë problemet në bashkësi dhe

ta detyrojnë pushtetin sa më shpejtë t'i zgjidhë.

E drejta e shtetësisë. Asnjë person në rruzullin tokësor nuk duhet të jetë pa shtetësi. Përmes kësaj të drejte përcaktohet raporti ndërmjet qytetarit dhe shtetit: a është pjesëtar i tij, a është anëtarë i tij. Vetëm ai individ, i cili ka fituar të drejtën e shtetësisë mund të ketë qasje deri te të gjitha të drejta tjera qytetare.



E drejta e votës. Këtë të drejtë njerëzit e realizojnë në më tepër mënyra. Kështu, për shembull, sipas kësaj të drejte çdo individmembushjen 18 vjetmund të marrë funksion publik në shoqëri, të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur. Duke shfrytëzuar të drejtën e votës, qytetarët zgjedhin përfaqësuesit në pushtet. Kandidohen dhe zgjedhin kryetar, deputetë në



Burra, gra, të moshuar dhe të rinj, të zi dhe të bardhë, besimtarë dhe jobesimtarë –të gjithë kanë të drejta të barabarta

kunved, kryetar komune, këshilltarë në komuna. Kjo e drejtë u mundëson të debatojnë dhe të shkruajnë për çështje të caktuara politike, të formojnë dhe të anëtarësohen në parti politike, të marrin pjesë në fushata zgjedhore dhe të protestojnë. E drejta e pjesëmarrjes në jetën politike u mundëson qytetarëve ta zgjedhin pushtetin, por edhe të ndikojnë në vendimet, të cilat i sjell ai pushtet.



Mbani mend

Të drejtat personale dhe liritë e qytetarëve siç janë e drejta e jetës, e drejta e lirisë, mendimit të lirë, lirisë së lëvizjes, lirisë së besimit, e drejta e shtetësisë duhet të kuptohen si vlera njerëzore. Ato e mbrojnë dinjitetin njerëzor dhe e pamundësojnë diskriminimin. Këto të drejta janë bazë për realizimin e të gjitha të drejtave të tjera.

Të drejtat politike dhe liritë i mundësojnë qytetarit të marrë pjesë në jetën politike të bashkësisë. Këto të drejta ndryshojnë dhe zgjerohen në varësi të demokracisë dhe të strukturës së shoqërisë.

Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore

Të drejtat sociale-ekonomike janë të njohura edhe si gjenerata e dytë e të drejtave të njeriut, për shkak se në krahasim me të drejtat politike dhe qytetare, këto të drejta janë të pranura shumë më vonë. Në këtë grup të të drejtave bëjnë pjesë:

- e drejta e punës dhe mbrojtja nga papunësia,
- rrogë të njëjtë për punë të njëjtë,
- të ardhura të mjaftueshme për jetë të denjë për individin dhe për familjen e tij,
- të drejtë për pushim vjetor të paguar,
- sigurim në rast të papunësisë, sëmundjes, dobësisë dhe plakjes.

Këto të drejta janë shumë të rëndësishme. Ato ua sigurojnë njerëzve sigurinë ekonomike dhe sociale në shoqëri, i mbrojnë njerëzit nga papunësia, u sigurojnë mundësi në mënyrë të pavarur të zgjedhin profesionin, të punojnë dhe të sigurojnë për vete dhe për familjen mjete për ekzistencë. Personat, të cilët i gëzojnë këto të drejta, kanë të ardhura të mjaftueshme për t'i përmbushur nevojat



Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato

1. Analizojini, cilat të drejta i gëzoni. Përmendini shembujt në të cilat nuk janë respektuar të drejtat tuaja?
2. Hartoni një listë të të drejtave të qytetarëve sipas rëndësisë së tyre?
3. Cili është mendimi juaj për ekzistimin e të drejtës për mësimin e informatikës? Kontrollojeni a përmendet kjo e drejtë në listën e të drejtave të njeriut?
4. Disa njerëz kanë dy shtetësi. Cilat janë përparësitë dhe dobësitë e kësaj?



Çdo kush ka të drejtë ta zgjedhë profesionin



Të gjithë këtyre u nevojitet ndihmë nga të tjerët

themelore për jetë: shtëpi komode, ushqim, veshje.

Me të drejtat ekonomike dhe sociale njerëzve u është dhënë mundësia edhe të kenë pronë (personale ose të përbashkët).

Gjithashtu, përmes këtyre të drejtave u sigurohet njerëzve ndihmë adekuate medicinale dhe sociale. Në rast kur individët nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën e punës (sëmundje, invaliditet, mplakje dhe të ngjashme) dhe nuk mund të sigurojnë mjete për jetë, atëherë sipas këtyre të drejtave njerëzve u takon ndihmë sociale nga shteti.

Këto të drejta, të drejtat politike njerëzve nuk u duken shumë të rëndësishme. Dinjiteti njerëzor nuk mund të mbrohet nëse shteti (qeveria) nuk e përcakton rrogën më të ulët dhe nëse nuk i mbron njerëzit kur ata ngelin pa punë, kur do të sëmuren ose kur do të plaken.

E drejta e arsimimit është njëra nga të drejtat ekonomike dhe sociale. Kjo e drejtë nuk është e rëndësishme vetëm për individët, por edhe për familjen dhe gjithë bashkësinë. Njeriu mëson dhe aftësohet për një profesion të caktuar, kurse përmes profesionit siguron mjete për përmbushjen e nevojave të veta.

Arsimimi, qytetarët e përgatitur dhe të aftësuar janë pasuri themelore e secilës bashkësi shoqërore, për shkak se ata janë bartës të zhvillimit ekonomik dhe kulturor të bashkësisë.

Të drejtat kulturore u mundësojnë njerëzve të marrin pjesë në jetën kulturore të bashkësisë, të gëzohen në artin, t'i shfrytëzojnë përfitimet e përparimit shkencor dhe ta shfrytëzojnë kohën e lirë ashtu si ata dëshirojnë dhe dinë.



Secilit duhet t'i mundësohet të arsimohet

Njerëzit, të cilët i gëzojnë këto të drejta janë mirë të informuar për gjendjen e shoqërisë, kanë kohë të lirë për pushim dhe rekreacion. Marrin pushim të paguar (disa ditë në vit) të cilin e shfrytëzojnë për udhëtim, pushime verore, pushime dimërore.

Njerëzit kanë nevojë ta zhvillojnë personalitetin e vet. Prandaj, njerëzit lexojnë, merren me sport, merren me art, hulumtojnë. Këto nevoja i përmbush përmes të drejtave kulturore.



Këta njerëz dinë çka është e mirë për ata

Me të drejtat kulturore, krijuesit i mbrojnë veprat e veta shkencore, letrare dhe artistike. Liria për krijimtari shkencore dhe artistike u garanton se veprat e tyre nuk do të jenë të ndaluara, kurse krijuesit nuk do të nënvlerësohen dhe nuk do të dëbohen për atë që do ta publikojnë.

Njerëzit kanë nevojë të jetojnë në mjedis të pastër dhe të pandotur, e mbrojtur nga shkatërrimet e mundshme. Secili ka të drejtë personale ta mbrojë shëndetin e vet nga ndikimet e dëmshme të ajrit, ujit dhe trualli të ndotur. Të gjitha këto ia mundësojnë të drejtat kulturore.

Cilat të drejta i realizojnë gjatë vizitës në galeri,



muze, ekspozitë, kur shkoni në kinema, në teatër, në koncert?

Në këtë grup bëjnë pjesë edhe të ashtuquajtura drejtat e pakicave, sipas së cilave bashkësitë e vogla etnike në një shoqëri kanë mundësi ta praktikojnë

kulturën e vet (gjuhën, doket, traditën, folklorin, etj.).

Lista e të drejtave të njeriut të njohura ndërkombëtarisht të përfshira në Deklaratën universale nuk është përfundimtare. Mënyra moderne e jetës ka imponuar nevojën e zgjerimit të listës me kategori të reja të të drejtave të njeriut. Kështu për shembull, me zhvillimi e shkencave medicinale, posaçërisht inxhinierinë e gjenetikës, transplantimit të organeve njerëzore, dhe të tjera, bashkësia ndërkombëtare duhet të mendojë për zgjerimin e listës së të drejtave të njeriut.



Të drejtat e njeriut janë të kushtëzuara dhe të lidhura reciprokisht, prandaj dhe janë njësoj të rëndësishme për njeriun. Në Deklaratën universale për të drejtat e njeriut thuhet se secili ka të drejtë të standardit jetësor, i cili i siguron shëndet dhe mirëqenie atij dhe familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen, shtëpinë. Por, kjo e drejtë nuk mund të realizohet, pa të drejtën e punës dhe mbrojtjen nga papunësia. Njeriu mund edhe të punojë, por megjithatë të mos ketë të ardhura të mjaftueshme për të siguruar ekzistencën e cila përgjigjet me dinjitetin njerëzor. Prandaj, e drejta e punës udhëzon në të drejtën e të ardhurave të mjaftueshme për një jetë të mirë, d.m.th., këto dy të drejta ndërmjet veti kushtëzohen dhe plotësohen. Secili ka të drejtë të pushimit dhe të argëtimit. Por, kjo e drejtë nuk mund të plotësohet, në qoftë se koha e punës nuk përcaktohet dhe nuk kufizohet me

ligj dhe nëse nuk ekziston e drejtë për pushimin e paguar periodikisht.

Të drejtat dhe liritë e disa, nuk duhet t'i rrezikojnë të drejtat dhe liritë e njerëzve të tjerë.

Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato



Analizoni shembujt dhe përpiquni të nxirrni përfundim se cilat nga të drejtat e njeriut janë të shkelura? A i plotëson obligimet e veta shteti ndaj qytetarëve?

1. Konsumimet për përkujdesjen mjekësore në shtet aq shumë janë rritur, saqë qytetarët nuk mund t'i paguajnë. Qeveria refuzon të sjellë shërim shtetëror (mbrojtje shëndetësore) për të gjithë, për arsye se mendon se është shtrenjtë.

2. Në një vend të varfër qeveria sjell vendim për të ndërtuar termocentral në të cilin duhet të punësohen me qindra punëtorë. Ai do të punojë me thëngjill pa filtra. Qytetarët, të cilët jetojnë në afërsi të termocentralit, i cili do të ndërtohet, nuk pajtohen me vendimin e qeverisë dhe organizojnë protesta. Protesta ndërpritet me intervenimin e policisë.

3. Prindërit bujq thonë se nuk e lejojnë djalin e vet 10 vjeçar të shkojë në shkollë. Thonë se ai duhet t'i ruajë lopët. Përgjegjësit në shkollë thonë se ky është problem i familjes.

4. Qeveria thotë se grevat e punëtorëve shkaktojnë dëme të mëdha në ekonomi. Ajo i ndalon grevat dhe formon këshilla industrial, të përbërë nga biznesmenë, përfaqësues të Qeverisë dhe udhëheqës të sindikatave, të cilët dihet t'i zgjidhin problemet.

Si mbrohen të drejtat dhe liritë e njerëzve dhe qytetarëve?

Liritë dhe të drejtat e qytetarëve duhet të njihen në mënyrë që të mund të mbrohen. Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë kjo është e drejtë dhe detyrë e qytetarëve, por është edhe obligim i shtetit që t'i mbrojë.

Shteti ka obligo t'i mbrojë të drejtat dhe liritë e qytetarëve, veçanërisht kur u rrezikohet jeta, liria dhe prona e tyre. Për këtë qëllim shteti disponon me aparat shtetëror: policinë, prokurorinë dhe gjykatat, organet drejtuese dhe inspektuese, avokatin e popullit, por edhe organet më të larta shtetërore si – Kuvendi i Maqedonisë, Gjykata Kushtetuese, Qeveria dhe të tjera.

Kur qytetarëve u shkelet ndonjë e drejtë dhe liri, ata, së pari, i drejtohen gjykatave të rregullta, pastaj edhe të gjitha organeve të tjera, ku japin shkesat e tyre, ankesat, paditë, etj. Por, është shumë me rëndësi ata të dinë se ekzistojnë edhe mënyra tjera dhe mjete për realizimin e të drejtave dhe të lirive të veta, si për shembull: përmes njoftimit të publikut dhe mediat publike, shoqatat qytetare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, organet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe të ngjashme.



DEMOKRACIA DHE KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË SAJ

Njerëzit gjatë jetës vazhdimisht sjellin vendime të ndryshme: në familje, në vendet e punës, në rrethin e shokëve dhe të ngjashme. Zakonisht, tentojnë vendimet e veta t'i përshtatin me vendime e të tjerëve.

Kur në një shoqëri qytetarët kanë të drejtë të sjellin vendime të cilat janë në interes të jetesës së tyre të përbashkët, themi se në atë shoqëri ekziston demokraci.



Demokracia e Athinës

Zanafilla e demokracisë

Demokracia për herë të parë u paraqit në qytetin-shtetin e Athinës në shek. V p.e.s. Për shkak se nuk ekzistonte Kryetari i shtetit, qeveri, kryeministër. Me shtetin udhëhiqte Kuvendi, i përbërë nga të gjithë burrat e rritur, i cili numëronte prej 5 deri 6 mijë anëtarë. Gratë, skllevërit dhe të huajtë nuk përfshiheshin. Kuvendi sillte vendime për të gjitha sferat e jetës.

Demokracia e këtillë në Athinë ishte quajtur demokraci e drejtpërdrejtë.

Me rritjen e shteteve ishte e pamundur të gjithë qytetarët të mblidheshin në një

vend (siç ishte rasti me Athinën) për t'i vendosur bashkë për ndonjë çështje.

Prandaj sot, forma më e praktikuar e demokracisë është demokracia e përfaqësuar, në të cilën qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre, të cilët në emrin e tyre vendosin, menaxhojnë dhe sjellin ligje. **Sipas kësaj, demokracia është pushtet i popullit. Thelbësore për atë, sepse ajo është pushtet i shumicës.** Por, si zbatohet ajo?

Kjo zakonisht është përcaktuar në Kushtetutën e secilit shtet. Qytetarët, respektivisht zgjedhësit, në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe të përgjithshme zgjedhin përfaqësuesit në trupin më të lartë ligjvënës. Ky trup në Republikën e Maqedonisë quhet Kuvend (Parlament). Në vende të ndryshme ka emra të ndryshëm.

Emrat e trupit më të lartë ligjvënës - Parlamentit	
Maqedoni	Kuvendi i Republikës së Maqedonisë
Francë	Kuvendi nacional
Federata Ruse	Duma
SHBA	Dhoma e përfaqësuesve
Poloni	Sejm
Slloveni	Fjalë shtetërore
Spanjë	Kortez

Demokracia e vërtetë ka edhe një parim: se ata të cilët do të ngelin në pakicë me votën e tyre, interesa dhe qëndrime, duhet të respektohen dhe të mbrohen, duhet të mos pësojnë nga ajo se kanë ngelur në pakicë. Kushtetutat e shteteve moderne atë e rregullojnë.

Demokracia përfaqësuese quhet demokraci parlamentare. Në qoftë

se shteti për udhëheqës ka Monark (për shembull, mbret, perandor dhe të ngjashëm), atëherë ai është monarki parlamentare. Në qoftë se ka për shef – kryetar të Republikës – paraqet republikë parlamentare, (që është rast me Maqedoninë).

Secili shtet demokratik duhet të ketë parlament. Ai i përfaqëson qytetarët dhe i sjell ligjet e shtetit.

Parlamenti, sipas rregullës e zgjedh **qeverinë**. Qeveria i zbaton ligjet dhe prandaj quhet pushtet ekzekutiv. Parlamenti e zgjedh edhe gjykatën më të lartë dhe organet gjyqësore, të cilat bashkë e përbëjnë pushtetin gjyqësor. Pushteti gjyqësor kujdeset për respektimin e ligjeve dhe për secilin mosrespektim cakton dënime.

Në këtë mënyrë, pushteti shtetëror ndahet në tre degë: pushtet ligjvënës, ekzekutiv dhe pushtet gjyqësor.

Në demokraci është rregull të tre degët e pushtetit të jenë të pavarura njëra nga tjetra dhe të mos përzihen në kompetencat. Kështu, parlamenti e zgjedh qeverinë dhe mund ta ndryshojë, por në kuadër të kompetencës së tij, qeveria është përgjegjëse dhe organ i pavarur. Gjykatat duhet të gjykojnë sipas ligjeve, e jo sipas këshillave ose mendimeve të qeverisë ose të deputetëve ose kushdo qoftë tjetër. Prandaj, thuhet se midis tre degëve të pushtetit duhet të ekzistojë baraspeshë.

Publiku është karakteristika thelbësore e shoqërisë demokratike.

Tomas Xheferson, burrshteti amerikan në vitin 1801 në një rast ka thënë:

“Secilit person, të cilit i është mundësuar të marrë pjesë në sjelljen e vendimeve të rëndësishme në interes të shtetit dhe të kombit, jo vetëm një ditë kur janë zgjedhje, por çdo ditë të vitit...ai, së pari do të lejonte t’ia nxjerrin zemrën, sesa t’ia marrin fuqinë, si ndonjë, Cezar ose Bonapart”.

Kjo do të thotë se çdo qytetar ka të drejtë të shprehjes, mendimit, të ketë qëndrimin e vet dhe kritikën. Për shkak se puna në organet shtetërore është publike për qytetarët, në këtë mënyrë ata i shprehin edhe qëndrimet e veta në raport me çështjet e rëndësishme të politikës dhe të shoqërisë.

Përmes publikut, pushteti kontrollohet dhe drejtohet drejt interesave dhe nevojave të qytetarëve.



Mediumet ndikojnë mbi formimin e mendimit publik

Në shoqëritë jodemokratike gjithmonë ka ekzistuar mundësia për keqpërdorim dhe tirani mbi qytetarët.

Në emrin e shtetit, individët ishin mbyllur, u ishin marrë pronat, ishin munduar, dëbuar, madje edhe ishin mbytur pa arsytim ligjor. Shoqëria demokratike nuk mund të tolerojë sjellje të këtillë drejt qytetarëve.

E drejta e barabarësisë përpara Ligjit është e drejtë themelore në secilën shoqëri të drejtë demokratike. Pa dallim, nëse bëhet fjalë për individ më të pasur ose më të varfër, pjesëtarë të një besimi ose besimi tjetër, të gjithë kanë të drejtë për mbrojtje të njëjtë përpara ligjit.

Nuk guxon me dhunë të futet në shtëpinë e dikujt dhe të bastisë pa urdher të gjykatës edhe me shkas të

arsyetueshëm. Në demokraci nuk ka vend për vizitat e natës të policisë. Askush nuk guxon të mbahet në arrest pa aktpadi.



Në demokraci janë të ndaluara vizitat e këtij lloji

Në shoqëritë jodemokratike, pushteti përqipet të krijojë qytetarë të dëgjueshëm dhe pasiv pa iniciativë. Në mënyrë që të mund të aplikojnë demokraci në praktikë, qytetarët duhet të posedojnë kulturë qytetare. Ajo fitohet përmes mësimi. Prandaj, themi se arsimit është i një rëndësie vitale për suksesin e demokracisë. Synimi i shoqërisë demokratike është të krijojë qytetarë të pavarur, të cilët do të jenë kritikë në mendime dhe njohës të mirë të të drejtave dhe obligimeve të tyre. Kurse për këtë u nevojitet dituri.



Mësoni më tepër

Nëse e ndjekim zhvillimin historik të demokracisë si pushtet i popullit, nga populli dhe për popullin do të vërejmë se përparimi i demokracisë ec me kufizimin e pushtetit absolut të mbretit.

Demokracia në Angli, në shek. XVII është e lidhur me emrin dhe me veprën e Oliver Kromvell. Mbreti Çarlisi I e thirrte parlamentin vetëm kur duhej të caktonte ndonjë tatim të ri dhe pastaj e

shpërndante. Prandaj, ndodhi konflikti midis Parlamentit dhe mbretit.

Parlamenti formoi ushtrinë e vet, të cilën e udhëhiqte Kromvelli. Ai dy herë e mendi ushtrinë e mbretit, ku edhe mbreti u pushkatua. Anglia u bë monarki parlamentare.

Parlamenti, sipas pushtetit të tij, ishte mbi mbretin, sillte dhe abrogonte ligje. Tatime mund të mblidheshin vetëm me miratimin e parlamentit. Ai, gjithashtu, përcaktonte sa të holla do të shpenzonte mbreti. Njëqind vjet më vonë, shembullin e Anglisë filloi ta ndjekë edhe Franca.



Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato

1. Përcaktoni karakteristikat kryesore të demokracisë.
2. Përmendini dallimet ndërmjet demokracisë së drejtpërdrejtë dhe demokracisë së përfaqësuar.
3. Në cilën mënyrë qytetarët ndikojnë në vendimet e pushtetit?

SHTETI DEMOKRATIK DHE FORMAT TË TJERA TË RREGULLIMIT SHTETËROR

Shteti është formë e shoqërisë së organizuar në të cilën puna e pushtetit është e ndarë nga veprimtaritë tjera: bujqësia, zëjtaria, tregtia. Kjo d.m.th. se një grup e caktuar e njerëzve marrin detyrë të menaxhojnë me njerëz të tjerë në shoqërinë.

Prandaj, në secilin shtet popullsia është e ndarë, në ata të cilët qeverisin dhe në ata të cilët janë të nënshtruar ndaj pushtetit.

Ekzistimi i pushtetit është i pashmangshëm, por pyetja thelbësore është si

do të jetë ai pushtet (si do të rregullohen raportet ndërmjet pushtetit dhe popullit). Ata, të cilët qeverisin, duhet ta dinë pse qeverisin, dhe kush u ka dhënë pëlqim për të qeverisur.

Ако согласността да владеат им ја дал
Нëse pëlqimin për të qeverisur ua ka dhënë populli, atëherë bëhet fjalë për shtet demokratik. Në qoftë se nuk është dhënë nga populli, por është marrë me dhunë, atëherë bëhet fjalë për shtete jodemokratike.

Monarkia është shembull për pushtetin jodemokratik. Kryesisht është pushtet i një njeriu (mbretit, perandorit, sulltanit). Në shtetet mesjetare feudale monarku pushtetin e tij e arsyetonte me vullnetin e Perëndisë. Respektivisht, monarku ka marrë pëlqim nga Zoti për të menaxhuar me shtetin.

Pushtetin e mbretit e trashëgonin pasardhësit e tij.

Ekzistojnë dy lloje të monarkisë: monarki absolute dhe kushtetuese.


Monarkia absolute është shtet në të cilin pushteti i monarkut (mbretit) është i pakufizuar. Monarkia kushtetuese është shtet në të cilin pushteti i sunduesit

është i përcaktuar, gjegjësisht ai është i kufizuar me kushtetutë. Kushtetuta është ligj themelor i shtetit me të cilën i rregullojnë raportet ndërmjet pushtetit dhe popullit.

Kur në monarkitë kushtetuese sillet ndonjë ligj, sunduesi duhet të kërkojë pëlqim nga përfaqësuesit e popullit.

Në shtetet jodemokratike mund të numërohen edhe shtetet komuniste dhe diktaturat luftarake. Qeveritarët në shtetet komuniste thonë se pushtetin e kanë marrë me pëlqimin e popullit – përmes zgjedhjeve. Por, populli nuk zgjedh, por vetëm formalisht voton. Nuk mund të zgjedhë për shkak se ekziston vetëm një parti politike (partia komuniste). Për shembull, nëse kuvendi ka gjashtëdhjetë deputetë, në listën e votimit janë listuar po aq kandidatë. Në ato shtete ka edhe kryetarë deri në fund të jetës. Shteti në ato shoqëri siguron vende pune, njerëzit mundeshin të arsimohen pa pagesë dhe kishin sigurim shëndetësor dhe invalidor. Shteti ishte social, por nuk i mbronte të drejtat themelore të njeriut, të cilat llogariten si themel i pushtetit demokratik.

Edhe një formë e pushtetit jodemokratik, ku të drejtat e përmendura të njeriut nuk



respektohen, janë diktatorët luftarakë. Tek ata formalisht ekzistojnë më tepër parti politike, por zgjedhjet nuk janë të lira. Gjatë zgjedhjeve mbi votuesit bëhen shtypje të formave të ndryshme, si për shembull, për kë të votojnë dhe gjithmonë zgjedhen ata kandidatë, të cilët kanë mbështetjen e pushtetit. Prandaj, diktaturat luftarake janë jodemokratike.



Demokracia si vlerë

Demokracia është realizim i qeverisjes së popullit përmes përfaqësuesve të zgjedhur të tij. Ata, të cilët i ka zgjedhur populli të qeverisin në emër të tij, duhet ta arsyetojnë qeverisjen e tyre. Nëse populli ka punë, mbrojtje shëndetësore kualitative, nëse ata mundin fëmijëve të tyre t'u sigurojnë arsim, nëse pensionistët marrin pensione të mira, atëherë ai popull është i kënaqur nga pushteti dhe ai e ka arsyetuar qeverisjen e tij. Nëse populli është i pakënaqur nga qeveria, atëherë ai mund ta ndryshojë me zgjedhje të rregullta ose të parakohshme.

Mundësinë që populli ta vendosë dhe ta ndryshojë pushtetin nëpërmjet rrugës së zgjedhjeve e mundëson demokracia. Prandaj, demokracia është vlerë.

Në kushte të papunësisë së madhe dhe të varfërisë, populli e humb besimin në demokracinë. Në rast të këtillë pushteti jodemokratik e shpërndan parlamentin, i ndalon partitë politike, e ndalon lirinë e shprehjes së mendimit, i shpërndan sindikatat dhe në mënyrë të pavarur sjell vendime. Por, kur shoqëria përsëri do të bjerë në krizë, kur në popull do të rritet pakënaqësia, pushtetin jodemokratik nuk ka kush ta ndryshojë.

Kështu për shembull, deri në vitin 1933, miliona amerikanë ishin pa punë. Me mijëra e përshkonin tokën në kërkim të ushqimit, punës dhe për strehim.

“Vëlla mund të më japësh dhjetë centë?”, dëgjohej kudo si refren i një kënge e famshme. Shoqëria u nda në të pastrehë dhe në milionerë.

Në këto kushte, kryetari amerikan Franklin Ruzvelt në një fjalim të drejtuar popullit në radio në vitin 1938 bëri me dije për mundësinë e zhdukjes së demokracisë:

“Demokracia u zhduk edhe në disa kombe të tjera të mëdha, jo për shkak se popujt e këtyre kombeve pushuan ta duan demokracinë, por për shkak se: ata mbetën të lodhur nga papunësia dhe mungesa e sigurisë, nga shikimi i fëmijëve të tyre të uritur, nga ndjenja e pashpresë, të ballafaquar me konfuzionin shtetëror, dobësia e pushtetit dhe mungesa e udhëheqjes...më në fund, në dëshpërim, ata zgjedhën ta viktimizojnë lirinë me shpresë se do të fitojnë diçka për të ngrënë. Ne në Amerikë e dimë se: institucionet tona demokratike mund të ruhen dhe të funksionojnë. Por, për t'i ruajtur, ne duhet ...të dëshmojmë se pushteti demokratik në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme

do të kujdeset për ruajtjen e sigurisë ekonomike të njerëzve...”

Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato



1. Si zgjedhet qeveria në shtetet demokratike dhe si në shtetet jodemokratike?

2. Bëni dallimet ndërmjet shteteve demokratike dhe atyre jodemokratike.



Bllokimi i rrugës

Shoqatat qytetare

Qytetarët në demokraci nuk janë vetëm zgjedhës, të cilët herë pas here votojnë për përfaqësuesit e vet në pushtet. Ata janë edhe aktivë drejtpërdrejtë në vendosjen në shoqëri dhe atë përmes shumë formave: referendume dhe anketa, vetëqeverisje lokale, organizimi i sindikatave, iniciativat qytetare dhe shoqatat, protesta dhe të shprehurit aktiv të pakënaqësisë me vendimet dhe politikat e qeverisë. Qytetarët, gjithashtu, mund të shkruajnë ankesa, peticione, t'i drejtohen publikut më të gjerë.

Gjithë kjo nënkupton se shoqëria e qytetarëve, ose siç e emërojmë –

shoqëria qytetare, është e pavarur dhe aktive në raport me shtetin. Shteti vetëm i siguron kushtet dhe dispozitat ligjore për veprim të shoqërisë qytetare.

Roli i sindikatave

Të drejtat sindikaliste dhe liritë janë pjesë e pandarë e të drejtave të njeriut. Ato janë përfshirë në Deklaratën universale të të drejtave të njeriut në Kombet e Bashkuara, por edhe në Kushtetutën e RM-së. Sindikatat janë organizata të pavarura të punëtorëve, të formuara në bazë të parimeve demokratike. Ato paraqesin informetë vjetërtë organizimit për veprim, jo vetëm të punëtorëve, por edhe të qytetarëve në përgjithësi, si dhe kanë traditë shumëvjeçare. U paraqitën me zhvillimin e kapitalizmit, gjegjësisht me rritjen e eksploatimit të punës. Sindikatat janë organizata më të fuqishme joqeveritare, për shkak se kanë anëtarësi më të madhe. Dalin në mbrojtje të të drejtave ekonomike-sociale të punëtorëve. Kujdesen për lartësinë e rrogës, përmirësimin e kushteve të punës, i mbrojnë punëtorët nga largimi prej pune, me qëllim të rritjes së standardit jetësor. Shumë me rëndësi është roli i tyre për vendet në tranzicion.



Greva është mjet ligjor i lejuar



Shoqatat ekologjike

Shoqëritë moderne gjithnjë e më tepër bëhen shoqëri të ndotura. Për gjendjen e këtillë kontribuojnë ndotjet e përditshme të ambientit jetësor me materialet mbeturina, prodhime kimike, gazrat ndotës, të cilët çdo ditë lëshojnë veturat, objektet industriale, fabrikat. Me qëllim që të sigurojnë më tepër përfitim, pronarët e fabrikave u shmangen shpenzimeve për instalimin e pajisjeve me të cilat zvogëlohen materiet e dëmshme. Më së tepërmi ndotet pastërtia e ajrit dhe ujit me çka rrezikohet edhe mbijetesa e përgjithshme e botës së gjallë në planetin Tokë. Mungesa e ndërjegjes te qytetarët, edhe më tepër e rrit rrezikun nga katastrofa ekologjike.

Në shumë shtete janë formuar shoqata ekologjike dhe organizata, të cilat marrin një seri aktivitete për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Detyra themelore e tyre është ta rrisin vetëdijen ekologjike të qytetarëve, por edhe të ndërmarrin edhe masa për mbrojtje. Ata përmes mediumeve e bëjnë publike problemin dhe ndikojnë mbi pushtetin ligjvënës të sjellë ligje, me të cilat do të mbrohet e drejta e mjedisit jetësor të shëndetshëm.

Detyrë



Lexoni tekstin, pastaj komentoni mbi tekstin. Si do ta kishit zgjidhur problemin, nëse do t'u jepej pushtet.


Fragment prej një teksti në Agjencinë Informative të Maqedonisë (MIA),

21 janar 2008

Koalicioni i gjelbër nga Velesi kërkon dislokimin e Shkrites

“Përfaqësuesit e organizatave qytetare nga Velesi të bashkuar në Koalicionin e gjelbër u takuan me anëtarët e Këshillit të Komunës dhe kërkuar të përshpejtohet iniciativa e tyre për ndryshimin e planit detal urbanistik në pjesën e lokacionit të Shkrites për plumb dhe zink. Ata nuk janë kundër prosperitetit ekonomik të qytetit, por, jo në mënyrën e cila shkakton pasoja në shëndetin e qytetarit...Mbi 90% e banorëve të Velesit mendojnë se zgjidhja e vetme për qytetin është Shkriterja të disloketohet 18 kilometra në jug...Koalicioni i gjelbër, parashtrij iniciativë deri në Qeveri për të ndarë mjete nga buxheti për dislokimin e Shkrites”...“Qeveria deri tani nuk ndau mjete për t'i dëmshpërblyer qytetarët për pasojat mbi shëndetin gjatë 30 viteve të fundit të punës së Shkrites. Por, tash ka mundësi t'i përmirësojë gabimet nga e kaluara dhe ta mbrojë ardhmërinë e qytetarëve të Velesit”, tha – përfaqësuesi i Koalicionit të gjelbër.





Iniciativat qytetare e avancojnë demokracinë

Në periudhën nga 1890 deri në vitin 1917, në SHBA u paraqit lëvizja reformatore e quajtur – progresivizëm, që kishte për qëllim t'i mënjanojë prapambeturitë në shoqëri, të vendosë drejtësi sociale dhe demokraci më të madhe.

Progresistët në mënyrë të ashpër iu kundërvunë korrupsionit politik, keqpërdorimit të pushtetit, vjedhjeve në punë dhe të tjera. Bartësit e aktiviteteve ishin shkrimtarë dhe gazetarë. Njëri prej tyre ishte edhe shkrimtari i njohur Mark Tven. Ai në veprën e tij “Jetë e çmendur” e kritikoi demokracinë në SHBA.

Në gazetatat ditore dhe javore u paraqitën shkrime, të cilat i zbulonin keqpërdorimet që i bënte pushteti dhe ndërmarrjet e

mëdha. Në Gazetën “Kulier”, gazetari Ida Mej Tarbel publikoi skandalin financiar të firmës Standard Oil. Në publik ishte i njohur me emrin – zbulues i skandaleve.

Në novelën “Xhungël”, shkrimtari Apton Sinkler e përshkroi të vërtetën se përpunimi i mishit në një fabrikë të madhe të Çikagos bëhen në kushte skajshmërisht johigjienike. Shkrimtari i njohur amerikan Teodor Drajzer në romanet e tij “Financier” dhe “Titanik” në mënyrë shumë të thjeshtë përshkroi keqpërdorimet dhe mashtrimet në bizneset e mëdha në shoqërinë e atëhershme amerikane. Shkrimtari Frank Noris në veprën “Vrimë” i tregon publikut se tregtarët ndikojnë në çmimin e grurit. Me këtë vepër ai i nxiti bujqit në protesta.

Në veprën “Turpi i qyteteve” shkrimtari Linkolln Stivens e zbulon korrupsionin politik në SHBA.

Të gjitha shembujt shprienë në përfundim se iniciativat qytetare kishin ndikim të madh mbi politikën. Me fuqinë e fjalës së shkruar, shoqatat e shkrimtarëve dhe të gazetarëve e dallgëzonin publikun e atëhershëm amerikan dhe i detyronin udhëheqësit politikë të ndërmarrin masa konkrete. Menjëherë pastaj në shumë shtete të SHBA-së ishin sjellë ligje, me të cilat ishin përmirësuar kushtet për punë dhe për jetë.



Kultura e rendit demokratik politik paraqet përmbledhje të vlerave, standardeve dhe rregullave të sjelljes së qytetarëve. Përmes tyre qytetarët orientoheshin në sjellje demokratike: t'i respektojnë interesat dhe mendimet e të tjerëve, po ashtu edhe të vetat, t'i respektojnë cilësitë e ndryshme të të tjerëve.

Ky lloj i kulturës i aftëson qytetarët si të jenë tolerantë, të kujdesshëm dhe të hapur për dialog dhe si të pajtohen me të tjerët, të cilët janë më të ndryshëm se ata.

Përfaqësimi politik - zgjedhjet

Pse janë të nevojshme partitë politike?

Njerëzit jetojnë në bashkësi, por nuk kanë nevoja, dëshira dhe interesa të njëjta. Për të jetuar bashkë ata duhet të vendosin rregulla të sjelljes dhe t'i përshtatin dëshirat dhe interesat e veta.

Mendimtarët, të cilët e studiuan demokracinë antike, erdhën deri në përfundim se edhe aty (edhe pse mendohet se është forma më e pastër e demokracisë) kishte grupe kundërshtarë të njerëzve për shkak të mospajtimeve të ndërsjella, konflikt mendimesh dhe interesash të ndryshme. Edhe pse në demokraci anëtarët e bashkësisë kanë të drejtë të vendosin vetë, kjo nuk do të thotë se ata jetojnë në harmoni, se nuk do të grupohen njëri kundër tjetrit, se interesat e njërës palë nuk do të kundërshtohen ose të rregulluar sipas interesave të të tjerëve.

Edhe në shoqëritë e sotme demokratike ekzistojnë konflikte të mendimeve dhe interesave, por ato tejkalohen përmes rrugës së diskutimit, debateve, marrëveshjes së ndërsjellë, përmes vendimeve të sjella bashkë.

Ideja për njohjen dhe respektimin e interesave të ndryshme në shoqëri e hap rrugën drejt krijimit të partive politike.

Në vitin 1788 në revistën "Federalist", Xhejms Medison kështu e shpjegonte nevojën e ekzistimit të partive politike:

"Dëshira për epërsi, fuqi dhe fitim është gjurmë e përhershme e sjelljes së njeriut e cila gjithmonë e ndante njerëzimin, ndezte armiqësi ndërmjet veti dhe ishte arsye njërapalë t'i shtypë të tjerët, në vend se të bashkëpunojnë. Kjo aftësi njerëzore për armiqësi të ndërsjellë është aq e fuqishme, që edhe kur nuk ka nevojë, nxit epshe armiqësore dhe shkakton konflikte të ashpra".

Arsye më e shpeshtë e cila i grupon njerëzit në tabore armiqësore, sipas Medison është shpërndarja jo e barabartë e pasurisë.

Nëse pjesëtarët e shoqërisë kanë interesa të ndryshme, ata (në mënyrë të fshehtë ose të hapur) do të grupohen për t'i realizuar interesat e veta. Prandaj është e nevojshme t'u mundësohet formë e shoqërimit përmes së cilës në mënyrë publike do t'i shprehin interesat e veta.

Mundësia më e mirë për këtë është nëse u lejohej të formojnë parti politike. Prandaj, partitë politike përkufizohen si organizata të njerëzve të një mendimi politik, të grupeve sociale, të cilat kanë interesa dhe qëndrime të njëjta në politikë.

PARTITË POLITIKE NË SHOQËRINË MODERNE

E drejta e votës së qytetarëve paraqet shtyllë të secilës shoqëri demokratike, edhe për shoqërinë në Maqedoni. Qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e vet për institucionet e ndryshme, organe të ndryshme dhe trupat e ndryshme në shtet. Për shembull: zgjedhin përfaqësues në këshillat e komunës, këshillat e qyteteve, këshillat e shkollës, qendrat publike, në ndërmarrje dhe të ngjashme. Megjithatë, më të rëndësishme janë zgjedhjet të cilat mbahen çdo katër vite, kur qytetarët i zgjedhin deputetët në kuvend, dhe çdo pesë vite kur zgjedhin kryetarin e shtetit. Kandidatët për këto funksione shtetërore i propozojnë partitë. Qytetarët do të votojnë për ata kandidatë për të cilët janë të bindur se i përfaqësojnë interesat e tyre dhe të cilët u sigurojnë status/pozitë më të mirë ekonomike.

Në republikën e Maqedonisë ka të drejtë të zgjedhjes?

Sipas nënit 22 të kushtetutës: qytetari, gjegjësisht shtetasi, i cili i ka mbushur 18 vjet të jetës së tij; e drejta e zgjedhjes është e barabartë, e përgjithshme dhe e drejtpërdrejtë dhe realizohet në zgjedhje të lira me votë të fshehtë.

E drejta e zgjedhjes në zgjedhje të lira me votë të fshehtë.

Studimi i sjelljes politike te ne tregon se qytetarët janë të orientuar për ato oferta politike, të cilat, para së gjithash, i kënaqin interesat personale, e jo ato, të cilat janë në interes të së mirës së përbashkët (siguri e përbashkët, mbrojtje shëndetësore më e mirë, arsimim kualitativ dhe të tjera).

Në orientimin e votuesve se për kë do të votojnë ndikojnë: përmbajtjet dhe synimet e programeve të partive politike (ofertat e partive, të cilat kanë të bëjnë

me zhvillimin ekonomik të vendit, hapjen e vendeve të reja të punës dhe të tjera).

Por, mbi orientimin e votuesve ndikojnë edhe faktorë të tjerë. Njëri prej këtyre faktorëve është përkatësia partiake. Anëtarët e partive politike, zakonisht votojnë për kandidatët e partisë së vet.

Ekzistojnë parti politike të ndryshme. Sipas ideologjisë të cilën e përfaqësojnë, partitë ndahen në të majta dhe në të djathta. Kjo ndarje është bërë në të kaluarën dhe është mbajtur edhe sot. Sipas kësaj partitë e majta më tepër angazhohen për interesat e punëtorëve, ndërsa të djathtët për interesat e kapitalit dhe pronarëve. Ekzistojnë edhe parti të qendrës të cilat i mbrojnë interesat e klasës së mesme.

Ekziston edhe një ndarje e partive. Sipas kësaj ekzistojnë parti ekstremiste, të cilat angazhohen për revolucione, për zgjidhje dhe vendime jodemokratike dhe parti mesatare programet e të cilave dallohen me tolerancë, me demokraci. Për këtë shkak ato janë të pranueshme për një numër të madh të qytetarëve.

Edhe partitë kanë interesat e veta edhe pse i përfaqësojnë interesat e qytetarëve në parlament. Interesi i partive politike është që sa më gjatë të qëndrojnë në pushtet.





sisteme i quajmë sisteme dypartiake. Në vende të tjera – ka më tepër (pesë, dhjetë e më tepër) parti politike. Sistemi i tyre është quajtur sistem shumëpartiak, dhe shumë shpesh në pushtet janë lidhje të ndryshme të më tepër partive për të cilat themi se janë koalicione.

Për të gjitha ato sisteme është me rëndësi që partia që qeveris ose lidhja e partive, të kenë shumicën e votave në parlament dhe të formojnë qeverinë e vet. Partia ose lidhja e partive që ka fituar më pak vota – janë opozitë, e cila në parlament e kritikon qeverinë, e mbikëqyr dhe kërkon nga ai përgjegjësi, por nuk mund ta ndryshojë.

Sipas të dhënave në Entin republikan për statistikë në RM ka 39 parti të regjistruara politike. Ato formohen në pajtim me Ligjin për partitë politike në Republikën e Maqedonisë. Sipas tij programet, statutet dhe veprimet e partive politike në Maqedoni nuk guxojnë të drejtohen drejt rrëzimit të rendi kushtetues në Republikën e Maqedonisë. E ndaluar është nxitja ose thirrja në agresion ushtarak dhe ndezja e urrejtjes dhe padurimit kombëtarë, fetar dhe racor. Puna e partive politike është publike. Të gjitha angazhohen për pjesëmarrje në pushtet.

Në disa vende, në sistemin zgjedhor sipas rregullës dhe sipas traditës mbisundojnë dy parti të mëdha dhe ato



Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë

Formimi i shtetit modern maqedonas

Themelet e shtetit modern maqedonas janë vendosur gjatë Luftës së Dytë botërore. Me 6 prill të vitit 1941 ishte sulmuar mbretëria e Jugosllavisë. Në përbërjen e saj gjendej edhe shteti ynë, por jo si pjesë e veçantë, por si pjesë e Serbisë nën emrin Banovina e Vardarit. Shpejtë ushtritë gjermane, bullgare dhe italiane hynë në shtetin tonë dhe e okupuan. Atëherë Partia komuniste e thirri popullin maqedonas në luftë për t'u çliruar nga okupatori. Përveç maqedonasve në Luftën Nacionale-Çlirimtare morrën pjesë edhe shqiptarët, turqit, serbët, vllehët dhe të tjerë.

Më 2 gusht të vitit 1944 në manastirin Prohor Pčinjski, Kuvendi Antifashist i Çlirimit Kombëtarë të Maqedonisë (KAÇKM) e mbajti mbledhjen e parë. Në këtë mbledhje Maqedonia ishte shpallur shtet. U përcaktuan organet më të larta të pushtetit. Gjuha maqedonase ishte shpallur gjuhë zyrtare e shtetit. Të gjithë qytetarët e Maqedonisë ishin pranuar si të barabartë pa dallim se cilit popull, gjinie ose besimi i takojnë.

Pas Luftës së dytë botërore, shteti i atëhershëm i Maqedonisë bashkë me pesë republikat e krijuan shtetin e ri – Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë. Më vonë shteti i përbashkët e ndryshoi emrin dhe quhej Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ). Në vitin 1991 RSFJ-ja u shkatërrua.

Me 8 shtator të vitit 1992, qytetarët e Republikës së Maqedonisë përmes referendumit vendosën Maqedonia të ndahet nga Republika socialiste federative e Jugosllavisë dhe të het shtet i pavarur dhe sovran. Me 18 nëntor u miratua Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë sipas së cilës ajo është demokraci parlamentare. Pushteti u nda në: ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Qytetarët zgjodhën njerëz, të cilët do të drejtojnë me shtetin (pushtetin), ndërsa pushteti përgatiti ligje dhe rregulla sipas të cilave duhet të organizohet jeta në territorin e ri të shtetit. U krijuan simbole të reja shtetërore.

Por, në shtetin e ri ishin të nevojshme edhe shumë institucione të tjera, të cilat do të kujdesen për rendin, paqen dhe sigurinë në shtet. Prandaj, u formuan gjykatat, policia, ushtria e RM-së. U formuan edhe institucione përgjegjëse të kujdesen për arsimin, kulturën, prodhimin, tregtinë.

Prandaj, 8 shtatorin për çdo vit e festojmë si *ditë të pavarësisë së Republikës së Maqedonisë*



Qytetarët në Referendum thanë “po” për Republikën e Maqedonisë.

Kuvendi (Parlamenti) i RM-së i përfaqëson qytetarët dhe është bartës i pushtetit ligjvënës.



Kuvendi i Republikës së Maqedonisë


Për të punuar në mënyrë efikase, Kuvendi themelon trupa të përhershëm dhe të përkohshëm. Trupat e përhershëm janë komisionet. Kuvendi ka kryetar dhe një ose më tepër nënkryetarë. Përveç këtyre funksionarëve, Kuvendi ka edhe sekretar. Kryetari i kuvendit i cakton seancat dhe kryeson me ato. Ai i shpall zgjedhjet për deputetët dhe për zgjedhjen e kryetarit të Republikës.


Kompetencat e Kuvendit

Numri i deputetëve në kuvend nuk është gjithmonë i njëjtë dhe lëviz nga 120 deri 140 deputetë. Nga zgjedhjet e para parlamentare deri sot numri i deputetëve është 120.

Deputetët në Kuvend janë të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë me mandat prej katër vitesh.

Kuvendi punon me seanca dhe sipas rregullores së përcaktuar për punë, kurse kompetencat e tij janë të përcaktuara me Kushtetutë. Kompetenca e tij primare është të sjellë ligje. Ai ka të drejtë jo vetëm ta ndryshojë dhe ta plotësojë Kushtetutën me amendamente kushtetuese, por edhe të sjellë kushtetutë të re. Kuvendi shpall edhe referendum, dhe jep amnisti (faljen e dënimit). Përveç këtyre, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ka edhe kompetenca të tjera.





Deputetët

Deputetët janë bartës kryesorë të aktivitetit dhe iniciativave të Kuvendit. Me zgjedhjen e tyre, votuesit u kanë dhënë të drejtë të marrin pjesë në punën e Kuvendit dhe të vendosin. Çdo deputet ka të drejtën individuale të propozojë ligje. Deputetët kanë të drejtë të kërkojnë përgjegjësi për punën e secilit anëtar të Qeverisë (për shembull, ministër) ose të ngrejë çështje për besimin e Qeverisë. Këtë zakonisht e bëjnë deputetët e opozitës. Përkrah të drejtës për kërkesë të përgjegjësisë, deputetët disponojnë edhe me një mjet për kontrollin e punës së “qeverisë” parashtrimin e pyetjeve të deputetëve.

Gjatë ushtrimit të funksionit deputet, deputetët gëzojnë imunitet. E drejta e imunitetit nënkupton se deputeti është përjashtuar nga veprimi i disa ligjeve (nuk mund të arrestohet ose të përgjigjet para gjyqit për atë që ka folur ose ka votuar në Kuvend, nuk mund të privohet nga liria pa pëlqimin e Kuvendit dhe të tjera). Mandati i deputetëve është katër vjet, por mund edhe të vazhdohet vetëm në rast të gjendjes së jashtëzakonshme ose të luftës. Kuvendi mund të shpërndalet edhe përpara kohe, nëse për këtë voton shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Detyra e opozitës

Partitë opozitare në Kuvend (Parlament) e krijojnë dhe e ruajnë kulturën demokratike. Ata e kontrollojnë punën e pozitës (deputetët nga partitë e pushtetit), i kritikojnë veprimet e tyre, por ofrojnë edhe zgjidhje të mundshme.

Pozita dhe opozita janë pjesë të rëndësishme të sistemit politik demokratik.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Qeveria e RM-së është bartëse e pushtetitekzekutiv. Ajo është përgjegjëse t’i zbatojë ligjet dhe dispozitat tjera. Autorizimet e saj janë të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. Qeveria është organ ekzekutiv kolektiv, të cilin e përbëjnë kryetari i qeverisë dhe ministrat. Ata nuk mund të jenë deputetë në Kuvend. Qeverinë e zgjedh Kuvendi me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve (me shumicë absolute). Ajo i propozon ligjet, buxhetin republikan dhe dispozitat të tjera, të cilat sillen në Kuvend. Me punën e Qeverisë udhëheq premieri.

Qeveria e organizon punën e ministrive dhe organeve të tjera të drejtorisë dhe bën mbikëqyrjen e punës së tyre, vendos për njohjen e shteteve dhe qeverive; vendos marrëdhënie diplomatike dhe konsullore me shtet tjera etj. Këto janë vetëm disa nga kompetencat e Qeverisë.



Në punën e vet Qeveria mbështetet në organet e administratës shtetërore prej të cilave më të rëndësishme janë ministritë. Ato gjatë punës udhëhiqen nga këto parime: në mënyrë të pavarur, në bazë të kushtetutës dhe ligjeve, me përgjegjësi.

Kryetari i Republikës së Maqedonisë

Kryetari i RM-së e përfaqëson Republikën në vend dhe jashtë. Njëkohësisht, ai është komandant i forcave ushtarake të Maqedonisë dhe kryeson me Këshillin e sigurisë. Në sistemin e pushtetit, kryetari i RM-së ka vend mjaft të dalluar, që del nga mënyra sesi ai është zgjedhur. Kryetari zgjedhet në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta, me votim të fshehtë. Ai është i zgjedhur drejtpërdrejtë nga ana e qytetarëve, njëjtë si edhe deputetët. Zgjedhet për mandat pesëvjeçar. Kompetenca e tij është ta caktojë mandatarin (premierin) për përbërjen e Qeverisë.

Pozicioni i pavarur i kryetarit të RM-së në sistemin e pushtetit shihet edhe në kontrollin e punës së Kuvendit. Kryetari mund të vendosë të mos e nënshkruajë dekretin për shpalljen e ndonjë ligji që e ka miratuar Kuvendi. Atëherë, Kuvendi duhet përsëri ta shqyrtojë ligjin.

Pushteti gjyqësor në Republikën e Maqedonisë

Pushteti gjyqësor në RM e zbatojnë gjykatat themelore, të apelit dhe gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë. Ato janë kompetente, duke zbatuar ligjet, të thonë çka është e drejtë dhe në cilën anë është e vërteta.

Gjykatat themelore themelohen për rajonet e një ose më tepër komunave. Ato janë gjykata të shkallës së parë dhe vendosin për vepra penale dhe kundërvajtje tregtare; për konfliktet personale, familjare, marrëdhëniet e punës dhe të banimit dhe të tjera.



Gjykatat e apelit janë gjykata të shkallës së dytë, të cilat janë kompetente të zgjidhin ankesat e vendimeve të gjykatave themelore. Në Republikën e Maqedonisë ka tre gjykata të apelit: në Shkup, në Manastir dhe në Shtip.

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë është gjykata më e lartë me seli në Shkup. Kujdeset për të gjitha gjykatat në Republikën e Maqedonisë që t'i zbatojnë ligjet në një mënyrë të vetme. Përveç kësaj, vendos edhe në ankesat kundër vendimeve të gjykatave të apelit.

Që të mund të vendosin gjykatat është i nevojshëm organ i pavarur i cili do t'i ndjek personat të cilët e kanë shkelur ligjin. Organ i tillë është **prokuroria publike**. Ky emër i shtetit ngre iniciativë për ndjekje penale. Prokurorin publik

e emëron dhe e shkarkon Kuvendi. Ai është i zgjedhur për një mandat gjashtë vjeçar.

Gjykata kushtetuese është organ i shtetit dhe ajo embron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë në Republikën e Maqedonisë. Gjykatësit e gjykatës kushtetuese i zgjedh Kuvendi për një mandat nëntëvjeçar. Në kompetencën e saj është edhe abrogimi ose anulimi i ligjeve, të cilat nuk janë në pajtim me Kushtetutën. Gjithashtu, Gjykata kushtetuese i mbron liritë dhe të drejtat e qytetarëve.

Këshilli republikan gjyqësor

Kuvendi e kontrollon pushtetin gjyqësor përmes keshillit republikan gjyqësor. E përbëjnë shtatë anëtarë, të cilët i zgjedh Kuvendi i Republikës për një mandat gjashtëvjeçar. Këshilli republikan gjyqësor Kuvendit i propozon kandidatë për gjyqtarë, por edhe për shkarkimin e tyre. Vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, e vlerëson profesionalizmin dhe ndërgjegjen e gjyqtarëve gjatë kryerjes së funksionit të tyre.

Avokati i popullit

As një pushtet nuk mund të qeverisë nëse me atë nuk pajtohet pjesa më e madhe e qytetarëve. Prandaj, edhe në të kaluarën pushtetmbajtësit përpiqeshin të mësojnë se çka mendon populli për ata. Në Kinën e vjetër ekzistonin njerëz të veçantë të quajtur mandarinë (nëpunës shtetërorë) të cilët ishin “edhe sy edhe vesh” për perandorin. Ata e njoftonin si punojnë nëpunësit e tij dhe çka mendon populli për punën e tyre. Në shoqëritë moderne demokratike rojtari i të drejtave të qytetarëve është avokati i popullit.

Te ne Avokati i popullit është organ i pavarur i Republikës, i cili i mbron të drejtat e qytetarëve kur janë të shkelura nga ana e zyrtarëve shtetërorë dhe nga personat të tjerë me autorizime publike. Qytetarët mundin, pa formalitete dhe harxhime shtesë t'i drejtohen për intervenim të shpejtë. Avokatin e popullit e zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për një mandat tetë vjeçar.

Vetëqeverisja lokale është gjithashtu institucion shumë i rëndësishëm demokratik. Në Republikën e Maqedonisë ka 127 komuna dhe secila prej tyre ka kryetarin dhe këshillin e vet përmes të cilëve qytetarët menaxhojnë vendbanimet dhe bashkësitë lokale të veta.

Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato



1. Kur dhe me vendimin e kujt është shpallur shtetësia e Republikës së Maqedonisë?
2. Numëroni tre kompetenca më të rëndësishme të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë sipas Kushtetutës të vitit 1991.
3. Sa zgjat mandati i deputetëve, gjyqtarëve dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë?
4. Cilat organizata dhe shoqata joshtetërore janë pjesë e sistemit politik të Maqedonisë?

UNË PRONARË, PRODHUES, HARXHUES

NEVOJAT, PUNA, PRODHIMI DHE KONSUMIMI

Njeriu është qenie biologjike dhe shoqërore dhe për të mbijetuar duhet t'i përmbushë nevojat e veta. Hulumtimet e një numri të madh antropologësh tregojnë se sikundër është e ndërlikuar jeta e njeriut, ashtu janë rritur edhe nevojat e tij. Sot, në shoqëritë moderne, nevojat e njeriut janë në numër të kufizuar.

Psikologu i njohur amerikan Masllov identifikoi disa lloje të nevojave të njeriut: psikologjike, pa të cilat nuk mund të mbijetojë si qenie biologjike (nevoja për ajër, ujë, ushqim, temperaturë trupore), siguri (të cilat i sigurojnë një jetë të sigurtë dhe të mbrojtur), emocionale (përmes së cilave i përmbush dashurinë, lidhshmërinë, butësinë, ndjenjën e përkatësisë), nevoja për të qenë i respektuar, si dhe nevoja për t'u dëshmuar përmes së cilës vjen deri te shprehja e talenteve të tij natyrore. Të gjitha këto nevoja kryesisht mund të ndahen në dy grupe:

- **pimare** përmes së cilave e siguron ekzistencën e vet (mbijetesën fizike) dhe

- **sekondare** të cilat i sigurojnë njeriut jetë më të mirë dhe më kualitative (arsimore, shëndetësore, kulturore, etj.). Këto nevoja nuk janë të domosdoshme, por janë shumë të rëndësishme, për shkak se ia lehtësojnë dhe ia përmirësojnë jetën njeriut.

Me përparimin dhe me zbatimin e teknologjive të reja në të gjitha sferat e jetës shoqërore, nevojat e njeriut vazhdimisht rriten dhe zgjerohen. Ndryshohet edhe mënyra e përmbushjes së tyre. E njohur është se gjetja e radios, telefonit, kompjuterit, në mënyrë të konsiderueshme u rritën nevojat e njerëzve dhe u zhvilluan të reja). Prodhuesit e mallrave ose të shërbimeve të reja ndikojnë në nevojat e njeriut. Ata përmes reklamave, jo vetëm që i njoftojnë konsumatorët se tregu ka produkte të reja, por tek ata stimulon nevoja të reja. Qëllimi i reklamave nuk është vetëm t'i njoftojnë konsumatorët për produktet e reja në treg, por edhe të stimulojë tek ata nevoja të reja. D.m.th., njeriu i përmbush nevojat e veta me ndihmën e begative dhe shërbimeve të ndryshme. Dhe për shkak se njeriu ato i shfrytëzon, prej tyre ka ndonjë dobi dhe fitojnë vlerë të përdorshme.

Njeriu nevojat e veta i përmbush në dy mënyra: përmes shpenzimeve natyrore (vetë prodhon begati materiale për përdorim personal) dhe përmes shitblerjes (blen begati





materiale dhe shërbime të menduar për përmbushjen e nevojave të konsumatorit).

Mbani mend



Prodhimi i shërbimeve dhe të begative materiale të mënduara për shitje quhet prodhim tregtar, kurse begatitë materialet dhe shërbimet, të cilat i përmbushin nevojat e konsumatorëve quhen mall. Malli është cilado begati materiale ose shërbim i prodhuar me qëllim për t'u shitur, dhe me qëllim për të realizuar fitim. Çmimi është vlerë e shprehur e mallit në të holla (para).

Prodhimi i të mirave materiale dhe shërbimeve, si aktivitet i organizuar i njerëzve është i

kushtëzuar nga nevojat e njerëzve. Kjo tregon për lidhshmërinë e prodhimit dhe konsumatorit.

Gjatë prodhimit të mallit, prodhuesit nuk udhëhiqen nga nevojat dhe dëshirat e veta, por nga nevojat, dëshirat dhe shijet e konsumatorëve.

Në ekonomi, procesi i përmbushjes së nevojave njerëzore quhet konsumim personal. Ky konsumim mund të jetë individual dhe i përbashkët (konsumim i përgjithshëm).

Procesi i prodhimit të begative materiale dhe shërbimeve njëkohësisht është proces i **shpenzimit** të një sasive dhe lloji të caktuar të materialeve (të papërpunuara), të begative kapitale dhe të punës. Ky lloj i shpenzimit në ekonomi quhet **konsum i prodhimit**.

Sasia e përgjithshme e produkteve dhe shërbimeve që do të prodhohen dhe do të shiten në një shoqëri në një periudhë prej një viti quhet **prodhimi kombëtar bruto**. Ai paraqet vlerë monetare e të gjitha begative materiale të prodhuara dhe shërbimeve, të cilat shiten te konsumatorët e fundit, në tregjet e organizuara dhe për të cilat është bërë transaksion i regjistruar (shitblerje). Të ardhurat kombëtare bruto janë tregues për shkallën e arritur të zhvillimit të ekonomisë në një shtet, si dhe standardi jetësorë i banorëve të tij.





Mbani mend



Për shkak të përmbushjes së nevojave njerëzit janë të detyruar të **prodhojnë** mallra (begati) dhe shërbime. Kur blejnë dhe shesin begati materiale dhe shërbime, atëherë bëjnë **këmbim**. Kur ndërmarrin aktivitete ekonomike për të realizuar fitim (mëditje, profit, qira, kamatë), atëherë marrin pjesë në **shpërndarje**. Prodhimi, këmbimi, shpërndarja dhe konsumimi janë karakteristika themelore të prodhimit të mallit.

Për prodhimin e çdo lloji të begative dhe shërbimeve janë të nevojshëm tre faktorë: **puna, kapitali dhe toka**. Pa ato nuk mund të fillohet as një proces i punës.

Puna është çdo aktivitet i njerëzve i domosdoshëm për prodhimin e një malli ose shërbimi të caktuar. Puna është ekuivalent me fuqinë punëtore, që nuk nënkupton

vetëm punë fizike, por edhe dije, mjeshtëri, aftësi dhe të ngjashme.

Kapitali është parakusht për cilindo prodhim. Atë e përbëjnë: *mjetet për punë, objektet e punës*. Mjetet për punë janë në realitet mjetet, pajisjet, ndërtesa në të cilat zhvillohet procesi i prodhimit dhe objekte të tjera të ndryshme. Ato mundësojnë prodhimin dhe në një kuptim janë të përhershëm. Nuk konsumohen gjatë një procesi të prodhimit, por përdoren më tepër vjet.

Objektet e punës janë lënda e parë dhe gjysmëprodhimet, të cilat njeriu (fuqia punëtore) në procesin e prodhimit (punës), me ndihmën e mjeteve për punë i ndryshon, i përshtat dhe i shndërron në begati të menduara për tregun me qëllim që të përmbushin ndonjë nevojë njerëzore. Objektet e punës janë material konsumues në procesin e prodhimit.

Toka paraqet objekt të përgjithshëm të punës, por për bujqësinë, pylltarinë, ndërtimtarinë paraqet faktor themelor, parakusht për punë.

Puna	Bërja e përzierjes, fërgimit, lyerjes (mbushjes), formësimit, ujdísjes, shërbimi,
Sende, mallra (begati) kapitale	Shporet, mikser, enë dhe pajisje tjera të kuzhinës
Materiale të përdorura	Miell, vezë, qumësht, sheqer, xhem, ara, shllag, gaz ose rrymë, etj.
Begati të harxhimit	Petulla

Detyrë.



Në tabelë është treguar krahasimi i faktorëve prodhues, gjegjësisht teknologjia për përgatitjen e petullave në restorant. Teknologjinë e njëjtë e përdorin edhe shtëpiaket. Cilat petulla llogariten si mall. Ato të përgatitura në restorant ose ato nga shtëpiaket.

NDARJA SHOQËRORE E PUNËS DHE SPECIALIZIMI EKONOMIK

Tregimi për Robison Kruson në të cilin ai vetë prodhon gjithçka: edhe ushqim edhe veshje edhe mbathje edhe vegla, shikuar nga aspekti i tregtisë së sotme e tregut është një tregim fantastik. Në kushte të tregtisë së zhvilluar me të vërtetë e pamundur që një njeri të prodhojë gjithçka.

A e keni pyetur veten ndonjëherë se çfarë duhet për ta krijuar bukën, e cila është e përditshme në tryezën tonë. Nëse përpiqeni të përshkruani teknologjinë për prodhimin e bukës, do të përfundoni se bëhet fjalë për proces shumë të ndërlikuar të punës.

Nuk është e mundur që një person të ushtrojë aq shumë detyra pune, as që mund të përdorë gjithë ato pajisje dhe makina (traktor me pllug, stërpikës për ujitje, kombaj, traktor me rimorkio, mulli për bluarjen e grurit, furrë). Sot, njerëzit aftësohen të prodhojnë vetëm një lloj të prodhimeve ose të kryejnë

vetëm një lloj të punës. Disa merren me bujqësi dhe prodhojnë ushqim, të dytët prodhojnë mobilje, të tretët vizatojnë plane dhe projekte për ndërtim të ndërtesave, kurse të katërtit i ndërtojnë ndërtesat sipas projekteve të përgatitura. Disa janë të punësuar në industrinë e përpunimit të automobilave, disa dinë të bëjnë dhe të riparojnë këpucë, të qepin veshje dhe të ngjashme. Domethënë, ata prodhojnë vetëm një lloj të begative materiale dhe merren me veprimtari të caktuar. Sipas kësaj ata janë këpucarë, rrobaqepës, bujq, arkitektë, muratorë etj. Gjithë kjo shpie në përfundim se në shoqëritë e sotme ekziston ndarja e punës dhe specializimi ekonomik, të bëra sipas llojit të të mirës së prodhuar dhe orientimi profesional i produkteve.

Edhe pse duket se gjithë këto prodhues janë të pavarur, ata nuk mundin pa njëri-tjetrin. Prodhimi i begative materiale dhe shërbimeve të njërit varet nga të mirat materiale dhe shërbimet të tjetrit. Kështu, për shembull, nëse ndonjë prodhues përcaktohet të prodhojë këpucë, ai është plotësisht i pavarur të planifikojë dhe të organizojë procesin e përpunimit të këpucëve si begati (pasuri) materiale. Megjithatë, ai (produkti i tij) do të varet nga prodhuesit tjerë: ata, të cilët prodhojnë makina për përpunimin e këpucëve, si edhe nga ata, të cilët i sigurojnë materialet për përpunim të këpucëve (prodhuesit e lëkurës, shollë, pe, ngjitës, energji dhe të ngjashme). Si do të përpunohen këpucët do të varet nga ajo sa prodhuesi i këpucës është i specializuar (kualifikuar) për kryerjen e asaj pune.



Mbani mend



Кога еден човек произведува само еден вид производ, или кога се занимава со ограничен број работни активности, станува збор за специјализација.

Kur një njeri prodhon vetëm një lloj të prodhimit, ose kur merret me numër të kufizuar të aktiviteteve, bëhet fjalë për specializim.


Ndarja e aktiviteteve është karakteristikë e shoqërive moderne. Rëndësia e saj burimore është ndarja e punës në detyra të ndryshme të specializuara të punës. Në shoqëritë paraindustriale nuk ekzistonte ndarje e tillë. Zejtarët ishin mjeshtër të cilët prodhonin një produkt nga fillimi deri në fund dhe vetë i ofron në treg për shitje. Zanati mësohej për një periudhë të gjatë. Secili zejtarë së pari bëhej çirak, pastaj shegert, dhe në fund kallfa. Kalimi prej njërës fazë në tjetrën miratohej nga dhënia e provimit përpara esnafit.

Ndryshimet më të mëdha ndodhën gjatë fundit të shek. XVIII, me fillimet e industrializimit. Prodhimi nuk zhvillohej në punëtori të vogla të zejtarëve, por në salla të mëdha të fabrikave në të cilat mijëra punëtorë, me specializime të ndryshme, punonin në prodhimin e një produktit të njëjtë. Çdo fushë e punë së njerëzimit u nda në një numër të madh të degëve të pavarura tregtare.

Sot, në vendet me zhvillim të lartë ekzistojnë shumë lloje të aktiviteteve ekonomike dhe kjo është arsyeja e lindjes së profesioneve të reja në mënyrë të vazhdueshme. Sot, më së shumti përdoret klasifikim sipas së cilit sfera e punës ndahet në sektor primar, sekondar dhe terciar. Sektori primar e përfshinë punën e cila bëhet në bujqësi; pylltaria dhe peshkimi, sektori sekondar, puna e cila bëhet në industri, sektori terciar, puna e cila bëhet në veprimtaritë shërbyese (transport, tregti, veprimtaria e bankave, hotele dhe restorante). Këtij sektori i takojnë edhe shërbimet publike, gjegjësisht shërbimet të cilat u japin qytetarëve përmes institucionet shtetërore. (shëndetësi, arsim, polici).

Proceset e kompjuterizimit dhe automatizimi në prodhimtari nga dita në ditë e redukton numrin e njerëzve të punësuar në sektorin primar dhe sekondar, kurse e rrit numrin e njerëzve të punësuar në sektorin terciar. Sot flitet për vlerë të dyfishtë, gjegjësisht të trefishtë të vendeve të punës në industri (një vend pune i hapur në industri (sektori sekondar)) tërhuqën hapjen e dy, tre ose më tepër vende pune në sektorin terciar.

Prodhimi i mallit është i pamundur pa ndarjen e punës dhe specializimit ekonomik. Ato janë indikatorë shumë të rëndësishëm për një shoqëri. Përmes tyre përcaktohet shkalla e zhvillimit të një shoqërie. Kurse për të zhvilluar llogaritët ajo shoqëri, e cila ka qasje në teknologjinë moderne, e cila ka ndarje





komplekse të ndarjes së punës dhe fuqi punëtore të specializuar (kuadro me arsim të lartë dhe profesionale).

PRONËSIA DHE KAPITALI

Aktivitet hulumtues



Puna, profesioni i njëjtë nuk vlerësohet në mënyrë të barabartë në të gjitha shoqëritë. Analizoni disa profesione në RM, pastaj hulumtoni si këto profesione vlerësohen në vendet tjera. Komentoni rezultatet e fituara. Disa pyetje vijuese përdorini si udhëzues gjatë analizës.

1. Cilit sektor i takon profesioni?
2. A është profesioni prestigj dhe a paguhet mirë?
3. Çfarë përgatitje arsimore dhe çfarë aftësi janë të nevojshme për profesionin?
4. Çfarë lloj të lëvizshmërisë, çfarë karriere mundëson profesioni dhe të ngjashme?

Pronësia dhe të drejtat pronësore

“Garantohet e drejta e pronësisë dhe e drejta e trashëgimisë. Pronësia krijon të drejta dhe detyrime dhe duhet të shërbejë si begati e individit dhe e bashkësisë. Askujt nuk mund t’i merren ose t’i kufizohet pronësia dhe të drejtat të cilat dalin nga ajo, përveç se kur është fjala për interes publik të përcaktuar me ligj”.

Neni 30

i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë

E drejta e pronësisë është e drejtë themelore e njeriut. Ku mendohet për të drejtën e *pronësisë personale* dhe të drejtën e *pronësisë private (individuale)* për pajisjet e prodhimit.



Në pronësinë personale bëjnë pjesë sendet, mallrat (begatitë) për përdorim personal. Pronari ato i përdor për përmbushjen e nevojave të tij. Të tilla janë: shtëpia, veshja, këpucët, vetura, pajisjet për higjienë personale dhe të ngjashme. Por, në qoftë se me disa të mira, të cilat janë pronë personale realizohet veprimtari tregtare (vetura shfrytëzohet për taksì, shtëpia jepet me qira dhe të ngjashme), këto begati nuk janë më pronë personale, por pronë private.

Pronësia private nënkupton pronësi mbi sendet, mallrat të cilat shfrytëzohen për qëllime tregtare. Në shoqëritë moderne kjo pronësi kuptohet si pushtet i individëve ose grupeve mbi pajisjet për prodhim. Pronarët sjellin vendime se si do të shfrytëzohen pajisjet për prodhim, si do të përshtaten rezultatet e punës, por edhe si do të tejkalohen rreziqet eventuale nga puna joproductive. Pronësia private mbi pajisjet për prodhim mund t'u takojë individëve, grupeve familjare ose grupeve të tjera të organizuara. Të drejtat pronësore, respektivisht pushteti mbi pajisjet janë të drejta ekskluzive dhe i takojnë ekskluzivisht titullarit (bartësit) të pronësisë. Askush nuk ka të drejtë me sjelljen e vet të pengojë realizimin e tyre. Për këtë shkak, pronësia

private gjithmonë shprehet si raport ndërmjet pronarëve dhe jopronarëve. E drejta e këtillë pronësore u imponon bartësve të pronësisë edhe detyrime në formë të autorizimeve (funksioneve) të lidhura me

- *menaxhimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi pronësinë,*
- *shfrytëzimi i pajisjeve, të cilat janë në pronësi dhe*
- *e drejta e disponimit me pronën.*

Sipas autorizimit të parë, bartësi i titullarit të pronësisë (ose ata të cilët ai i ka autorizuar të vendosin në emër të tij) sjell vendime për mënyrën sesi do të përdoren pajisjet për prodhim, si do të organizohet procesi i prodhimit dhe kush do të jetë i përfshirë në atë. Por, pronari pajisjet e prodhimit mund t'i vendosë jashtë përdorimit ekonomik, në





goftë se vlerëson se nga ato nuk ka asnjë dobi.

Sipas autorizimit të dytë (funksionit), bartësi i pronësisë ka të drejtë t'i përvetësojë të mira e krijuara nga përdorimi produktiv i mëparshëm i pajisjeve për prodhim (dobi ekonomike). Pronari ka të drejtë t'i përvetësojë të gjitha të mirat e prodhuara (të ardhurat, kamatën, dividendë, rentë, profit) dhe të drejtë të vendos si do t'i shpërndajë të njëjtën.

E drejta pronësore, gjegjësisht e drejta e disponimit me pajisje për prodhim e përfshinë edhe të drejtën e pronarit të njëjtat t'i tjetërsojë përmes shitjes ose dhuratës.

Pronësia private është shumë e rëndësishme për ekonominë e tregut. Nga ajo varet menaxhimi, kontrolli, përgjegjësia mbi ndërmarrjen, por edhe rreziku i punës. Ndërmarrja e suksesshme sipas rregullës tenton ta rris pronën e saj (ta rris vlerën e tregut e të mirave të cilat i posedon), ndërsa ndërmarrja jo e suksesshme e cila punon me humbje e redukton vlerën e tyre.

Shumica e qytetarëve nuk janë pronarë të pajisjeve për prodhim. Ata janë në rolin e fuqinë së lirë punëtore, e cila mund të zgjedh profesion, veprimtari dhe punëdhënësin tek i cili do të punojë.

Pronësia private nuk është formë e vetme e pronësisë. Zhvillimi ekonomik dhe teknologjik e imponuan nevojën e bashkimi të pronës së pajisjeve për prodhim (kapital) dhe krijimin e pronësisë grupore private. Të tilla janë **shoqëritë aksionare**. Në ato më shpesh nuk menaxhojnë pronarët, por ekipet menaxheriale, ndërsa ata marrin fitimin quajtur dividendë.

Për të gjitha shoqëritë e deritanishme është karakteristike pozita jo e barabartë e njerëzve në raport me posedimin e pajisjeve për prodhim. Pronësia e pajisjeve për prodhim është arsye për ndarjen e tyre klasore. Ndikim më të madh përherë kanë pasur (varësisht nga lloji i shoqërisë) plaku i fisit, pronari feudal, punëdhënësi, nëpunësi shtetërorë.

Në shoqëritë industriale mbijeton edhe lloji tretë i pronësisë, të drejtat pronësore të së cilës janë ekskluzivisht kolektive dhe është quajtur **pronësi publike** dhe **shtetërore**.



Kapitali

Një numër i madhe njerëzish, kur përmendet fjala kapital, menjëherë mendojnë për të holla. Ata janë të mësuar që shumën më të madhe të parave të kursyera ta quajnë kapital. Por, nuk janë vetëm paratë kapital. Sipas teorisë moderne ekonomike kapitali mund të paraqitet në disa forma të ndryshme: natyror, të cilin e përbëjnë pasuritë natyrore dhe resurset e një toke, financiare, i cili paraqitet në formë të parave, *infrastrukturore* (rrugë, ura, hekurudhë, instalime telefonike dhe të tjera), *institucionale* (pasuri të institucioneve shtetërore), *njerëzore* (inteligjenca, talenti, dituria, aftësitë e fituara përmes arsimimit) dhe *kulturore* (dituritë shkencore, progresi, trashëgimia kulturore dhe të ngjashme). Pronari i një shërbimi automekanik themi se posedon kapital, nëse në atë ka shumë makina, vegla dhe materiale të tjera me të cilat punon. Kapitali i një pronari të shitores janë raftet e mbushura plot dhe depotë me mall. Për atë që ka hapur llogari bankare në denar ose në deviza në bankë ose i cili ka kursyer para, gjithashtu themi se posedon kapital.

Paratë të cilat i ruajmë për pagesën e llogarive mujore, a janë kapital? Jo, por nëse një pjesë të të ardhurave mujore i kursejmë dhe i lëmë në bankë, ato do të shtohen sipas

shkallës adekuate të kamatës dhe atëherë ato bëhen kapital financiar. Pushimoren të cilën një familje e kalon kohën e lirë nuk është kapital, por nëse e jep me qira, atëherë ajo bëhet kapital.

Prej këtij nxjerrim përfundim se kapitali paraqitet në dy forma dhe atë: **kapital real** (pajisje për prodhim: makina, vegla, ndërtesa, objekte të tjera, lëndë e parë, gjysmëproduktet, rezervat e mallit të gatshëm të pashtitur) dhe **kapitali financiar** (instrumentet financiare, të cilat i sjellin fitim pronarit: kreditë në të holla, depozitat, fletë obligacionet, aksionet, faturat komerciale dhe të ngjashme).

Shembull. Nëse dikush vendos të hapë piceri, duhet të deponojë mjete për rregullimin e saj të plotë. Ato mjete quhen kapital fillestar (K1). Në qoftë se në fund të vitit kapitalin e deponuar e rrit (K2), atëherë themi se është realizuar **përfitim, profit (P)**. Përfitimi është dallimi midis vlerës fillestare dhe vlerës së fundit të kapitalit, gjegjësisht $P = K2 - K1$. Në gjuhën e kontabilitetit ai është dallimi midis **të ardhurave të përgjithshme të realizuara nga shitja** dhe vlera e faktorëve hyrës, respektivisht **harxhimeve në punë**.

Pronarët e kapitalit përpiqen që ai dallim të jetë sa më i madh.



Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato



1. Cili është dallimi themelor ndërmjet pronësisë personale dhe pronësisë private mbi pajisjet për prodhim?
2. Pse në çdo shoqëri janë të rëndësishme raportet pronësore?
3. Vërtetoni, a posedojnë kapital prindërit tuaj ose shokët e afërt? Shpjegojeni për çfarë forme të kapitalit bëhet fjalë.

TREGU DHE PARATË

Tregu dhe veprimi i mekanizmit të tregut

Qëllimi përfundimtar i çdo prodhimi të mallit është malli i prodhuar të arrijë deri tek ata për të cilët është menduar – konsumatorët, gjegjësisht të shitet. Kurse konsumatorët mallin e blejnë me të holla dhe në këtë mënyrë i përmbushin nevojat e veta. Tregu është vend ku ndodh shitblerja (këmbimi i mallit me para). Shitësi e bart pronësinë mbi mallin tek blerësi, kurse për kthim i merr të hollat. Blerësi paguan për të fituar pronësi mbi atë që e ofron shitësi (mall ose shërbim).

Mbani mend



Tregu i përfshin të gjitha aktivitetet e atyre, që duan të tregtojnë me ndonjë mall ose shërbim. Ai përbëhet nga ofertuesit, të cilët dëshirojnë të shesin dhe kërkuesit të cilët dëshirojnë të blejnë. Në treg nuk tregtohet vetëm me mall, por me fuqi punëtore dhe kapital.



Shitja "online" ka rënie drastike. Me siguri nuk u pëlqen konsumatorëve dizajni i "ueb-sitit" tonë!

Treguesi me si mirë për atë se si funksionon një treg është raporti ndërmjet ofertës dhe kërkesës, respektivisht ndërveprimi ndërmjet ofertuesve dhe kërkuesve rreth çmimit dhe sasisë së mallrave (shërbimeve) të cilat këmbehen.

Oferta- prodhuesit

Oferta është ajo sasi e mallrave të prodhuara ose shërbime, të cilat prodhuesit ua ofrojnë blerësve me qëllim që t'ua shesin. E logjikshme është se ata do të dëshironin të ofrojnë sa më tepër sasi të jetë e mundur nga ndonjë mall ose shërbim me çmim më të lartë të mundshëm. Por, kur tregu ka konkurrencë, prodhuesit, që të mund t'i shesin prodhimet e veta me çmim të pranueshëm për blerësit, janë të detyruar t'i ulin çmimet. Ndërsa këtë mund ta bëjnë nëse i ulin shpenzimet për prodhim. Prodhuesit (ndërmarrjet) të cilët kanë sukses në uljen e shpenzimeve të prodhimit (më shpesh e bëjnë me futjen e inovacioneve të teknologjisë në prodhim) janë të suksesshëm, realizojnë fitim dhe përpiqen ta zgjerojnë prodhimin. Ndërmarrjet e pasuksesshme realizojnë humbje dhe dështojnë.

Si do të jetë oferta varet nga disa faktorë:

- sa është numri i prodhuesve (ndërmarrjeve) të mallit të njëjtë,
- sa është vëllimi i prodhimit për secilin prej tyre dhe
- nga mundësitë e rritjes së numrit të prodhuesve të rinj nga ai mall (konkurrenca).

Zhvillimi ekonomik në shumë degë ekonomike shkakton paraqitjen e të ashtuquajturës **ndërmarrje e madhe**. Paraqitet me lidhjen e më tepër prodhuesve (ndërmarrjeve) me qëllim që të eliminojnë konkurrencën ndërmjet veti. Kështu të bashkuar ata forcohen në treg dhe në një moment kalojnë në monopol. Ata i "diktojnë" kushtet e tregut, i përcaktojnë çmimet e prodhimeve dhe sigurojnë fitim të sigurt dhe të përhershëm. Shteti kontratat e tilla sipas rregullës i pengon dhe i ndalon me ligj.



Kërkesa - blerësit

Sa produkte ndërmarrjet do të shesin dhe me çfarë çmimi nuk varet vetëm nga ata, por edhe nga kërkesa. Kërkesën e përbëjnë të gjitha ato fuqi të tregut, të cilat ndikojnë mbi transferimin e njerëzve si blerës (konsumues). Si blerës – konsumues veprojnë individët, amvisëria dhe ndërmarrjet dhe të gjithë ata në këtë mënyrë i përmbushin nevojat e veta. Zakonisht, njerëzit dëshirojnë të blejnë sasi sa më të madhe të mallrave dhe shërbimeve me çmim më të ulët. Në qoftë se rritet çmimi i ndonjë malli ose shërbimi, ulet vëllimi i kërkesës së tyre.

Vëllimi i kërkesës, varet nga disa faktorë:

- nga nevojat dhe dëshirat e konsumatorëve,
- nga fuqia e tyre blerëse dhe
- nga çmimi i mallit.

Njerëzit zakonisht i blejnë ato mallra dhe shërbime, të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e nevojave dhe dëshirave të tyre. Ashtu sikundër rritet intensiteti i nevojave dhe dëshirave ashtu rritet edhe gatishmëria e tyre për blerje. Të gjithë neve

na ka ndodhur që të blejmë prodhim me çmim shumë të lartë, vetëm pse ka qenë shumë mirë i reklamuar dhe për shkak se ka ngjallë te ne dëshirë për ta poseduar. Kurse për ta plotësuar këtë dëshirë është dashur të heqim dorë nga ndonjëra prej nevojave. Në vëllimin e kërkesës ndikon edhe fuqia blerëse dhe blerësit, gjegjësisht lartësia e të ardhurave të tyre. Të ardhurat ndikojnë proporcionalisht në vëllimin e kërkesës. Sikundër rriten të ardhurat e njerëzve, ashtu rritet edhe vëllimi i kërkesës dhe e kundërta. Gjithësesi, kjo nuk vlen për të gjitha llojet e mallrave dhe shërbimeve në mënyrë të barabartë.

E logjikshme është konsumatorët me të ardhura më të ulëta të sillen në mënyrë më racionale dhe të blejnë mallra me çmime më të ulëta. Njerëzit edhe kur kanë para nuk blejnë sasi të mëdha të mallrave të panevojshme, bile edhe kur çmimet janë të ulëta. Ata blejnë atë që kanë nevojë për të plotësuar nevojat e veta.




Njerëzit duan t'i plotësojnë dëshirat e veta, madje edhe në kurriz të nevojave

Përveç plotësimi të nevojave, ata dëshirojnë pjesë nga të ardhurat t'i shpenzojnë edhe në mallra dhe shërbime luksoze, si për shembull sende të shtrenjta, udhëtime ekzotike dhe të ngjashme. Por, prodhuesit (ndërmarrjet) duhet të dinë, cilat mallra dhe shërbime konsumatorët i vlerësojnë si të domosdoshme ose për “domosdoshmërinë” e tyre të informohen përmes hulumtimit të tregut. Në rast të tillë me ulje të vogël të çmimeve, ata fitojnë fitim të madh. Te mallrat dhe shërbimet, të cilat konsumatorët nuk i vlerësojnë si të domosdoshme, me rritjen e çmimeve, shtija bie më shpejtë, që d.m.th., ata “përfituan” humbje.



Mbani mend

Në shoqëritë primitive njerëzit nuk mendonin çfarë dhe sa të prodhojnë. Prodhonin aq sa prodhonin edhe paraardhësit e tyre. Tradita ishte mekanizëm themelor për përcaktimin e llojit dhe sasisë së prodhimit. Prodhimi dhe konsumimi janë zhvilluar në kuadër të amvisërive dhe prandaj është quajtur prodhim natyror. Në shoqëritë klasore detyrimi është faktor i rëndësishëm në zgjidhjen e çështjeve ekonomike. Piramidat egjiptiane, murri kinez, shtëpitë luksoze në jug të SHBA-ve nuk do të mund të ndërtoheshin pa punën e detyruar të skllëvërve. Fuqia themelore lëvizëse e ekonomisë së sotme të tregut është liria dhe zgjedhja e individit në realizimin e interesi të tij ekonomik. Konsumatori mund lirisht të zgjedhë ndërmjet prodhimeve dhe shërbimeve konkurruese, kurse prodhuesi



ka liri për të formuar firmë, të zgjedhë çfarë dhe sa do të prodhojë, ta pronësojë fitimin e mundit të tij. Për punëtorin liria d.m.th e drejta për ta zgjedhur vendin e punës, të anëtarësohet në sindikata, ta ndërrojë punëdhënësin. Gjatë punësimit punëtori lidh kontratë për punë me punëdhënësin, kurse për punën e bëtë merr rrogë ose mëditje.



Aktivitet hulumtues

Ndiqueni ndryshimin e çmimit të ndonjë lloji konkret të mallit në një periudhë të caktuar kohore. Identifikoni faktorët, të cilët ndikojnë në ndryshimin e çmimit. Nga të dhënat e fituara gjatë ndjekjes përgatitni një raport.



Paratë

Paratë janë dukuri historike. U paraqitën në një shkallë të caktuar të zhvillimit të shoqërisë, për shkak të nevojës për të lehtësuar dhe për të thjeshtuar këmbimin (shitblerjen). Këmbimi para paraqitjes së parave bëhej me këmbimin e mallit me mall. Në realitet, paratë përdoren (shumë rrallë) edhe para se tregu të bëhet mekanizëm dominant për zgjidhjen e çështjeve ekonomike. Ekonomia e tregut nuk mund të mendohet pa paratë.

Çfarë janë paratë?

Paratë janë arsyeja për shumë këngë të kënduara, për fjalë të urta, për familjet e varfëra, dashuri të pafat, luftëra. Aktorja e njohur Lajza Mineli në muzikën e njohur – Kabare këndon këngë për paratë në refrenin e së cilës thuhet se “paratë sundojnë me botën”. Paratë janë diçka që gjenden (më pak ose më shumë) në kuletën e secilit se në xhep. Paraqiten në formë të bankënotave, para të vogla metalike, kartela kreditore dhe të ngjashme. Sot çdo punë shpërblehet në formë paresh dhe prandaj me të drejtë mund të thuhet se jetojmë në monetarizimin e jetës shoqërore. Teknologjia e informatikës krejtësisht e ndryshoi punën me para. Sasitë e mëdha të parave sot në botë ekzistojnë në formë të regjistrimeve elektronike në çipa.

Paratë kanë disa funksione themelore:

- **si mjete për këmbim:** e lehtësojnë dhe e thjeshtësojnë këmbimin e mallrave të llojeve të ndryshme.

- Si **mjet pagimi** shfrytëzohen transaksionet kreditore (afatgjate dhe afatshkurte). Deri në momentin e pagesës (kthimit të kreditit), paratë shërbejnë si mjet për pagesën e shtyrë.
- Si **mjet përlllogaritës**. Këtë funksion nuk është e thënë sa herë ta bëjnë paratë. Posaçërisht gjatë periudhës së inflacionit të lartë, ato nuk e bëjnë këtë funksion.
- Si **mjet për ruajtjen e vlerave**. Ky funksion është ngushtë i lidhur me funksionin e parave si mjet për këmbim. Paratë paraqesin një formë të pronës likuide, e cila e ruan vlerën e vetë në kohë. Ato më lehtë mund të shndërrohen në ndonjë lloj tjetër të pronës. Gjatë inflacionit nuk është e arsyeshme që pasuria të ruhet në formë të parave. Më racionale është të blihet rezervë të mallit për konsum, materiale, të mira kapitale, patundshmëri.





Mësoni më tepër

Në pjesë të ndryshme të botës dhe në periudha të ndryshme të zhvillimit të tyre, objekte të ndryshme paraqitnin vlerë dhe ishin të njohura si mjete për pagesë (para). Të tilla ishin guaskat, duhani, lëkura, bagëtia, gruri dhe të ngjashme. Paratë e para, të ngjashme me të sotmet, janë përpunuar në shek. VII p.e.s në mbretërinë e lidisë (në Turqinë e sotme). Paratë e para ishin monedha të farkëtuara në formë të trekëndëshit, katërkëndëshit, rrethit. Ato ishin monedha të farkëtuara me elektrik (legurë natyrore e arit dhe e argjendit) në formë të trekëndëshit, katërkëndëshit, rrethit. Në monedha më shpesh vulosen figurat e perëndive dhe heronjve të njohur. Përparësinë e përdorimit të parave (të hollave) prej letre e zbuluan Kinezët. Paratë prej letre (bankënotat) në Evropë u paraqitën në shek. e XVII. Së pari i jepnin artarët palëve të veta, të cilët tek ata e ruanin arin. Ata u lejonin palëve të marrin para prej letre. Ai ishte fillimi i sistemit të kreditimit.

Me rritjen e tregtisë u paraqitën pagesa me shuma të mëdha. Pagesa e tillë me para prej letre bëhej gjithnjë e më e rëndë. Për këtë arsye u paraqitën paratë e xhiros. Pronarët mund të paguanin ndonjë detyrim të tyre pa i marrë paratë e gatshme nga banka. Atë e bënë me çeqe, kartelë. Bankënotat e para evropiane i ka lëshuar banka në Stokholm (Suedi) në vitin 1661.

Detyrë

Shkruani një ese mbi temën – Paratë. Shpjegoni si është raporti i juaj me paratë. A ndikojnë ato në jetën e njerëzve.



SHTETI DHE TREGU – EKONOMIA SOCIALE E TREGUT

Roli i shteti në ekonomi

Në shoqëritë moderne shteti bëhet aktor gjithnjë më i rëndësishëm në ekonomi. Ai ka përgjegjësi për krijimin e kushteve për ekonomi të sigurtë dhe veprim të lirë të ndërmarrjeve tregtare (të sigurohet stabilitet politik në vend, të vendosë rend dhe rregulla të brendshme, t'i mbrojë kufijtë, të organizojë import dhe eksport). Por, detyra e tij kryesore është të vendosë rregulla të sjelljes në jetën ekonomike. Për këtë qëllim shteti:

- Merr pjesë në ekonomi si **prodhues-punëdhënës**. Të punësojë njerëz, të prodhojë begati dhe shërbime në veprimtaritë siç janë: shëndetësia, arsimimi, policia, shërbimi zjarrfikës, veprimtaritë sociale, ushtri dhe të ngjashme. Shteti u bë pronar i rëndësishëm i mjeteve për prodhim në xehetari, industri, posaçërisht në ato degë, të cilat janë të lidhura me

prodhimin me synim (për ushtrinë, pylltarinë, komunikacionin ujor, transportin);

- Si **rregullatorë mikro-ekonomik** – imponon standarde përmes së cilave siguron mjedis jetësor të sigurtë, kualitet dhe kushte teknike-higjienike në disa prodhime ushqimore, përcakton çmime të disa prodhimeve të domosdoshme për konsumim personal, shërbime komunale dhe të tjera.
- Si **distributor**, ndikon në shpërndarjen e të ardhurave përmes rrogës minimale ose të garantuar, përmes tatimeve;
- Si **rregullator makro-ekonomik** ndikon mbi lartësinë e tatimeve, stabiliteti makro-ekonomik, stabiliteti i valutës kombëtare, politikën e kamatës, investimet dhe të tjera;
- Merr pjesë në realizimin e **projekteve të mëdha zhvillimore për të cilat nevojitet kapital i madh** (ndërtimi i hekurudhave, rrugëve, sistemet moderne për prodhimin e energjisë);
- I **ndihmon ato degë industriale**, të cilat janë bartëse të teknologjisë së re dhe e zhvillimit më të shpejtë ekonomik (elektroindustri, elektroteknikë, industrinë kimike dhe të ngjashme);
- Vepron në fushën e **politikës sociale** dhe sistemin e sigurisë sociale, e garanton rendin publik.

Punësimi dhe tregu i fuqisë punëtore

Njerëzit në procesin e prodhimit të mallit paraqiten si punëdhënës dhe punëtorë. Punëdhënësit janë ata të cilët i sigurojnë mjetet për prodhim (supozimet materiale për prodhim). Ato mund të jenë persona fizik (pronarë privat mbi mjetet për prodhim) dhe persona juridik (ndërmarrje, organe

shtetërore, banka, institucione, etj.), të cilët punësojnë njerëz të cilët nuk kanë mjete të veta për prodhim.

Punëtorët janë persona, të cilët e ofrojnë punën e tyre (fuqi pune) në prodhimin ose veprimtari të tjera për të cilën gjë marrin kompensim si mëditje ose rrogë. Fuqia punëtore është njëra nga faktorët pa të cilët nuk do të mund të mendohej asnjë proces prodhues, asnjë veprimtari terciare. Megjithatë, ajo, gjithnjë e më tepër bëhet e nënshtruar ndaj veprimit të tregut (oferta dhe kërkesa e fuqisë punëtore). Nëse më herët punëtorët vetë ballafaqoheshin me çështjen e papunësisë, sot atë rol e kanë të ashtuquajturit partnerët socialë (sindikatat). Ata në mënyrë të plotë i përfaqësojnë punëtorët në bisedimet me punëdhënësit dhe shtetin. Prej këtyre arsyeve ekonomia merr karakteristikat e ekonomisë sociale të tregut, kurse puna në prodhimin e begative dhe shërbimeve manifestohet përmes punësimit.

Kur një individ punon me mjetet e veta për prodhim, (zejtar, tregtar, fermer), atëherë bëhet fjalë për vetëpunësim. Individët në të njëjtën kohë janë dhe punëdhënës edhe punëtorë. Megjithatë, numri më i madh i popullatës përherë është në rolin e punëtorit, të ardhurat e të cilit shërbejnë për plotësimin e nevojave të tyre.

Në ekonominë e tregut, fuqia punëtore, gjithashtu është mall. Për atë vlejnë ligjshmëritë e ofertës dhe kërkesës si edhe për cilindo mall tjetër.

Çmimi i fuqisë punëtore shprehet në rrogë (mëditje) të cilën e fitojnë për punën e vet.

Në raportet ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve intervenon shteti me normat juridike, kurse sindikatat – merren vesh për punën. Ata bëjnë shtypje mbi shtetin (qeverinë), që ai në mënyrë ligjore t'u sigurojë:

- rrogë shembullore (të ardhura minimale të garantuara);
- mbrojtje në punë;
- të drejtë për pushim vjetor;
- orar të përcaktuar të punës;
- sigurim social (i plakjes, invalidor dhe shëndetësorë);
- mbrojtje gjatë papunësisë (kompensim derisa zgjat papunësia);

Gjithashtu, shteti duhet të sigurojë mundësi për realizimin e disa të drejtave të posaçme të punëtorëve, si për shembull: kompensim për mungesën në punë për shkak të lindjes, pushim të kujdestarit, shtesa fëmijërore, ushqimin, transportin dhe të tjera.

Çdokush ka të drejtë të punojë, zgjedhje të lirë gjatë punësimit, mbrojtje gjatë punës dhe siguri materiale gjatë papunësisë së përkohshme. Vendi i punës është i mundshëm për secilin person të interesuar nën kushte të njëjta. Çdo i punësuar ka të drejtë në përfitim adekuat. Çdo punëtor ka të drejtë në pushim ditor, javor dhe vjetor. Nga këto të drejta punëtorët nuk mund të heqin dorë. Realizimi i të drejtave të punëtorëve dhe pozita e tyre rregullohet me ligj dhe me marrëveshje kolektive.

Neni 32 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë

shkak të mospërputhshmërisë së ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore. Më tepër ndodh në ekonomitë e tregut kapitalist.

Ekzistojnë disa lloje të papunësisë:

- **papunësia sezonale** e cila ndodh si pasojë e ndryshimeve në prodhim, të shkaktuara nga vetë natyra e veprimtarisë, kurse paraqitet në periudha të caktuara të vitit. Kështu, për shembull, një numër i madh i punëtorëve të lëshuar nga puna në sferën e bujqësisë dhe turizmit në periudhën dimërore;
- **papunësia** si pasojë e kalimit nga një ndërmarrje në tjetër, në kërkesën e punësimit të parë pas mbarimit të shkollimit, në pritjen e përkohshme periodike të punësimit dhe të tjera;
- **Papunësia strukturore.** Automatizimi dhe teknologjia e informatikës janë arsye që një kategori e caktuar e punëtorëve (tanimë të punësuar) të largohen nga procesi i prodhimit për shkak të mungesës së kualifikimeve të nevojshme (tepricë teknologjike). Më shpesh janë punëtorë me shkallë të ulët të arsimit, të cilët nuk mund të përgjigjen në detyrat e punës për të cilat nevojiten njohuri teknologjike.

Detyrë




Analizoni një marrëveshje kolektive, pastaj përpikuni të shpjegoni, në cilat raste punëtori mund ta shfrytëzojë të drejtën e punës me orar të shkurtuar.

Papunësia

Të gjitha shoqëritë moderne ballafaqohen me problemin e papunësisë. Të papunë llogariten të gjithë të rriturit, personat e aftë për punë, të cilët kërkojnë punë (punësim). Deri te paraqitja e papunësisë arrihet për



Agjencia për të papunët



Aktivitet hulumtues



Pas vitit 1990 në Republikën e Maqedonisë, si vend në tranzicion, shumë u rrit papunësia. Shumë fabrika dhe ndërmarrje të pasuksesshme u ndalën së punuari. Ishin regjistruar 340000 persona të papunë prej të cilëve pothuajse gjysma ishin më të vjetër se 40 vjet, ndërsa përafërsisht $\frac{1}{4}$ të rinj, në moshën deri 26 vjet. Midis tyre kishte edhe një numër të njerëzve me shkallë të ulët të arsimit si edhe ata të cilët një kohë të gjatë janë të papunë. Disa analist pesimistë parashikuan se numri i papunësisë deri në vitin 2000 do të rritet prej 10 deri 15 mijë për shkak të likuidimit të 12 “humbësve” të mëdhenj në shtet. Përpiqeni të gjeni të dhëna për gjendjen e papunësisë në Republikën e Maqedonisë sot. Krahasoni numrin e papunësisë në 1999 me numrin e papunësisë sot dhe përcaktoni nëse ai numër është rritur ose është zvogëluar. Arsyetoni shkaqet për gjendjen e tillë. Në cilën moshë janë pjesa më e madhe e të papunëve sot. Cilat masa i ka ndërmarrë shteti për ta zvogëluar papunësinë?

NDËRMARRJA DHE SIPËRMARRJA

Ndërmarrja është person juridik, e cila merret me veprimtari ekonomike: prodhon begati materiale dhe shërbime për tregun, me qëllim që të realizojë të ardhura më të mëdha gjegjësisht fitim. *Ndërmarrja e përcaktojmë si njësi të organizuar ekonomike, në të cilën njerëzit me punën e tyre – fuqinë punëtore dhe me ndihmën e mjeteve për prodhim prodhojnë begati materiale ose shërbime për nevojat e të tjerëve, gjegjësisht për shitje.*

Në çdo ndërmarrje puna (fuqia punëtore) është e ndarë në **udhëheqëse** (puna e atyre që vendosin, planifikojnë, e kontrollojnë procesin e punës, japin urdhra) dhe **ata që e bëjnë punën** (puna e atyre, të cilët punojnë në makinë, mirëmbajtje, higjieniku dhe të tjerë).

Prona e ndërmarrjes mund të ndahet në:

- **mjete themelore** ose pronë në investime. Ato janë mjete, të cilat në ndërmarrje përdoren një kohë

më të gjatë (toka, ndërtesat, makinat, pajisjet e zyrës, mjetet transportuese dhe të tjera).

- **mjetet rrotulluese** janë ato të cilat vazhdimisht rinovohen (lënda e parë, materialet).

Në ekonominë e tregut të lirë veprojnë ndërmarrje të llojeve të ndryshme. Sipas llojit të veprimtarisë me të cilën merren ato mund të jenë: zejtare, industriale, tregtare, turistike, të komunikacionit, bankare. Sipas madhësisë ndërmarrjet mund të jenë të vogla, të mesme dhe të mëdha. Sipas ndarje së organizimit juridik ato mund të jenë:

- **Ndërmarrje e personit fizik individual** (pronarë individual).
- **Shoqëri e personave:** ndërmjet ndërmarrjeve të tilla i numërojmë ortakërinë, shoqërinë komanditore dhe shoqëria e fshehtë. Krijohen me bashkimin e më tepër pronarëve individual.
- **Shoqëri të kapitalit:** ato janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare (korporatat). Bartës i drejtpërdrejtë dhe ekonomik i kapitalit është ndërmarrja, si person juridik.

Me ndërmarrjet nuk menaxhojnë pronarët (aksionarët), por ekipie menaxheriale.



Fabrika për telefona celularë



Mësoni më tepër

Ndërmarrja industriale zakonisht ka numër të madh të punëtorëve me vendim, vëllim të madh të prodhimit (prodhojnë sasi të mëdha të produkteve të llojit të njëjtë për konsumuesin e panjohur), shkallë të lartë të ndarjes së punës (puna në shiritin e pafund), në procesin e prodhimit përdoren metoda shkencore.

Për ndërmarrjen e zejtarisë karakteristike janë: ndarje e pazhvilluar teknike e punës, vëllim i ulët i prodhimit (zakonisht me porosi dhe pa rezerva të mëdha), dhe zejтари (pronari) është i përfshirë në prodhim, ndërmjet pronarit dhe punëtorëve ekziston lidhje e posaçme, në prodhimtari janë të përfshirë edhe anëtarët e familjes.


Korporatat janë ndërmarrje të mëdha. Të njohura janë edhe si shoqëri aksionarësh. Me ato menaxhojnë ekipet menaxheriale.

Ndërmarrjet e vogla janë ato, të cilat kanë më pak se 200 të punësuar. Zakonisht me ato udhëheqin vetë pronarët.

Sipërmarrja

Teoria moderne ekonomike e kupton dhe e përcakton sipërmarrjen si pronësi të rëndësishme të njerëzve (fuqisë punëtore) në procesin e prodhimit të begative dhe shërbimeve, por edhe si faktor i rëndësishëm prodhues.

Karakteristikë themelore e sipërmarrjes është novatore – (ndjekje dhe zbatim i risive teknologjike, të tregut dhe risive të tjera në procesin e prodhimit). Kjo d.m.th. se sipërmarrësi, jo vetëm që përshtatet me gjendjet e tregut, por me veprimin e tij e përshtat tregun për nevojat dhe aftësitë e veta. Sipërmarrësi e organizon procesin e prodhimit, menaxhon me atë, por edhe i merr parasysh rreziqet që dalin nga ai.



Burimi: Enti shtetërorë për statistikë në Republikën e Maqedonisë (numri i të papunëve sipas anketës së vitit 2007)

Ekzistojnë dy lloje të sipërmarrjes: individuale dhe e kooperimit. E para bazohet në konkurrencën midis ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Analizat ekonomike tregojnë se shtetet, të cilat kanë sektorë të fuqishëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme më shpejtë i zhvillojnë ekonomitë e tyre. Për shembull, Japonia më tepër se 50% të punësuarve punojnë në ndërmarrje të vogla. Sipërmarrja e kooperimit është ajo e ndërmarrjeve të mëdha. Për shkak të madhësisë së tyre të madhe dhe jo fleksibilitetit të tyre më rëndë depërton noviteti. Për këto arsye shumë korporata moderne përpiqen të ndahen në njësi më të vogla të pavarura ekonomike.



Detyrë

Sipas ligjit për shoqëritë tregtare në Republikën e Maqedonisë, secili që ka kapital, kurajë dhe ide mund të fillojë biznes. Përpiqu të gjejsh informacione për atë çfarë është e nevojshme (cila është procedura) për të regjistruar një firmë private.



Qënder biznesi

JETA SHOQËRORE DHE POLITIKA SOCIALE

Popullsia (nacionet themelore, struktura dhe lëvizja e popullsisë)

Popullsia paraqet përmblendhje të njerëzve të cilët jetojnë në një hapësirë të caktuar gjeografike (territor). Ky është element shumë i rëndësishëm nga i cili varet organizimi dhe kualiteti i jetës në një shoqëri. Për shembull, nga numri i popullsisë dhe karakteristikave të tij varet sa do të jetë potenciali i punës në ekonomi (sa është numri i popullsisë që janë të aftë për punë), si do të jetë tregu dhe konsumi në atë shoqëri.


Shkenca e cila merret me studimin e popullsisë quhet gjeografi. Ky term del nga fjala greke “demos” që do të thotë popull dhe “grafein” – përshkruan. Ai e studion numrin e popullsisë, shpërndarjen territoriale të popullsisë dhe strukturën e saj (profesionet, angazhimin në punë, gjendje pronësore, shkallën e arsimimit,

moshën dhe të tjera). Veçanërisht interesohet për lëvizjet natyrore të popullsisë (sa lindin dhe sa vdesin), si për lëvizjen mekanike të popullsisë (migrimet).

Struktura e popullsisë përcaktohet sipas disa nishaneve: gjinisë, moshës, arsimimit, pozitës ekonomike dhe përkatësinë etnike, prandaj mund të flasim për strukturën biologjik, ekonomike, të moshës, strukturën etnike të popullsisë.

Për t'u përcaktuar struktura biologjike, duhet të dihet gjinia dhe mosha e popullsisë. **Struktura biologjike sipas gjinisë** tregon shpërndarjen e popullsisë në persona mashkull dhe femër. Kjo strukturë përcaktohet përmes pjesëmarrjes në përqindje të meshkujve dhe femrave në popullsinë e përgjithshme ose numrin e burrave në raport me 100 ose 1000 gra. (koeficienti i maskulinit).

POPULLSIA NË MOSHËN PREJ 15 VJET E MË TEPËR SIPAS ARSIMIT MË TË LARTË TË MBARUAR, REGJISTRIMI 2002




Burimet e të dhënave: Enti shtetërorë për statistikë në Republikën e Maqedonisë, Maqedonia në numra 2009, Shkup 2009, faq. 17.

Popullsia sipas grupeve të moshës, 2008

Gjendja: 30.06.2008

Sipas rajoneve statistikore



Popullsia sipas grupeve të moshave



Popullsia e përgjithshme



Vlerësimi i popullsisë së
përgjithshme, 30.06.2008

2046898

*Popullsia në Republikën e Maqedonisë sipas grupeve të moshave në rajone të veçanta
Burimet e të dhënave: Enti shtetërorë për statistikë në Republikën e Maqedonisë,
Maqedonia në numra 2009, Shkup 2009, faq. 11*

Struktura biologjike e popullsisë është shumë e rëndësishme për shkak se nga ajo varet shtimi i popullsisë, vëllimi i fuqisë punëtore, potenciali ushtarak në një bashkësi dhe të tjera.

Struktura biologjike e popullsisë sipas moshës e tregon shpërndarjen e popullsisë sipas grupeve të moshës. Më shpesh ndarja bëhet në tre grupe të moshave: prej 0.-14 vjet, nga 15 deri 64 vjet dhe mbi 64 vjet. Kjo strukturë varet nga më tepër faktorë, por më së tepërmi nga nataliteti, mortaliteti, shtimi natyrorë, lëvizjet e migracionit, krizat ekonomike, luftërat, epidemitë dhe katastrofat natyrore.

Struktura sociale-ekonomike e popullsisë e përshkruan struktura ekonomike e një vendi. Ajo tregon sa është numri i popullsisë që janë aktiv ekonomikisht, me çfarë veprimtarie dhe profesioni merren individët, cili është statusi i tyre në profesione, çfarë raporti kanë me pronësinë. Gjithashtu, përmes kësaj strukture mund të përcaktohet përfaqësia e popullsisë urbane dhe rurale, ndarja në amvisëri sipas burimeve dhe lartësisë së të ardhurave dhe të tjera.

Struktura e arsimit e tregon shpërndarjen e popullsisë sipas arsimit të tyre, sipas shkollimit dhe shkallës së përgatitjes arsimore dhe disa karakteristika tjera të arsimit.

Lëvizjet e popullsisë

Kur flitet për lëvizjet e popullsisë mendohet në ndryshimet që ndodhin tek popullsia si pasojë e lëvizjes natyrore dhe mekanike të popullsisë. Lëvizja natyrore të popullsisë shkaktojnë: natalitet (lindje e fëmijëve) dhe mortalitet (vdekshmëria). Lëvizjet mekanike të popullsisë shkaktojnë migrime (shpërngulje të popullsisë nga një territor në tjetrin). Migrimet mund të jenë të brendshme dhe të jashtme. Gjatë migrimeve të brendshme popullsia shpërngulet nga një vend në tjetrin, por nuk e lëshon shtetin në të cilin jeton. Gjatë migrimeve të jashtme popullsia shpërngulet në territor jashtë kufijve të shtetit. Në varësi nga kohëzgjatja e migrimeve ato mund të jenë të përhershme, të përkohshme, sezonale, javore dhe ditore.



Migrimet ditore çdo ditë shtohen, posaçërisht në vendet e Unionit evropian. Mos ekzistimi i kufijve ndërmjet shteteve mundëson qytetarëve të Unionit të jetojnë në një shtet kurse të punojnë në shtet tjetër.



Mësoni më tepër

Numri i përgjithshëm i popullsisë në botë në fillimin e neolitit lëvizte ndërmjet 3 dhe 5 milion njerëz. Për disa miliona vjet, deri në shek. XVIII, ai numër u rrit në një miliard, kurse sot në Tokë ka rreth 6 miliard banorë. Me gjithçka po vërtetohet supozimi i ekonomistit anglez Robert Maltus se popullsia në botë shtohet sipas progresionit gjeografik, për dallim nga ushqimi dhe mjetet për ekzistencë, të cilat shtohen sipas progresit aritmetik. Kjo mosbaraspeshë ndërmjet zhvillimit të popullsisë dhe zhvillimit të ngadaltë të resurseve sipas Maltus, “duhet ta baraspeshojnë uria, sëmundjet, luftërat dhe katastrofat natyrore”. Kjo pikëpamje në demografi quhet teoria e maltusit. Edhe pse nga aspekti shkencor është e papranueshme, megjithatë duhet të pranohet se “Kalorësit e Apokalipsës” edhe sot sundojnë në shumë vende të pazhvilluara në botë. Nëse në të ardhmen nuk ndërmerret diçka në mënyrë më radikale për sa i përket planifikimit të zhvillimit demografik, bota mund të ndeshet me shtime të shumta të popullsisë. Në këtë kuptim shumë pritet nga politika e popullsisë.

Aktivitet hulumtues

(punë në grupe)



Bashkë me disa shokë të tjerë bëni hulumtim. Përcaktoni sa është struktura ekonomike dhe arsimore e prindërve të nxënësve në paralelen tuaj, kurse pastaj përcaktoni sa ka qenë ndikimi i tyre në zgjedhjen e profesionit tuaj. Përveç kësaj, përpikuni t'i përdorni teknikat dhe metodat, të cilat aplikohen gjatë hulumtimeve shkencore.

POLITIKA DEMOGRAFIKE (E POPULLSISË)

Politika demografike është sistem i masave dhe aktiviteteve, të cilat ndërmerren nga shteti për të ndikuar në proceset demografike, me qëllim që të përshtatë numrin, strukturën dhe lëvizjen e popullsisë, me synimet ekzistuese ekonomike, politike dhe synime të tjera. Kjo politikë mund të jetë e zgjeruar, e kufizuar, e rishpërndarë, por mund të jetë arsye për fenomenet devijuese në shoqëri.

Detyrë

Lexojeni tekstin, pastaj arsyetojeni mendimin tuaj. Politika demografike e quajtur “një fëmijë”, e cila aplikohet në Kinë ndërmjet viteve të 80-ta dhe të 90-ta jo vetëm që shkaktonte prishje të raporteve midis gjinive, por ishte

POPULLSIA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

	1998	2003	2008
Popullsia në fund të vitit	2 012 705	2 029 592	2 040 619
Meshkuj	1 007 266	1 010 660	1 025 804
Femra	1 005 439	1 011 232	1 021 815
Qytetarë të ardhur të Republikën e Maqedonisë	595	567	219
Të huajt e ardhur	462	575	121
Qytetarët emigrant të Republikës së Maqedonisë	241	112	740
Të huajt emigrant	7	32	11

Burimi: Enti shtetërorë për statistikë i Republikës së Maqedonisë, Maqedonia në numra 2009, sh, faq. 8

edhe shkak për rritjen e kriminalitetit në Kinë. Pikërisht, Kina nga arsyet tashmë të njohura vendosi politikë demografike të restriksioneve me të cilën familjeve u ndalohej të kenë më tepër se një fëmijë, me përjashtime të rralla në mjediset rurale (nëse fëmija i parë është i gjinisë femërore, atëherë lejohet edhe i dytë). Familjet të cilat nuk i respektonin ndalesën dënoheshin në mënyra të ndryshme. Për çdo fëmijë “tepricë”, shteti nuk siguronte mjete për shkollim, mbrojtje shëndetësore dhe të tjera. Me këtë politikë u vendos kontrolli i lindjeve, por nga ana tjetër u prish baraspesha ndërmjet gjinive, u rrit numri i “abortet selektive”. Të udhëhequr nga tradita (për të pasur djal me çdo kusht), gratë kineze masovikisht e ndërpritnin shtatzëninë menjëherë sapo të mësonin se gjinia e fëmijës është femër. Politika “një fëmijë” shkaktoi në Kinë zgjerim të fëmijëve meshkuj (110 meshkuj në për secilën grua të njëqind). Sot, kjo gjeneratë e “një fëmije” të fëmijëve meshkuj në Kinë gjendet në moshë të pjekur. Kanë nga 30 vjet dhe ende të pamartuar. Kanë problem në lidhjen e martesës. Përqindje e konsiderueshme prej tyre janë problem edhe me ligjin (të paktën një herë ka bërë vepër penale). Rezultatet e një hulumtimi të fundit të bërë nga hulumtuesit kinez dhe amerikan vërtetuan se gjithë kjo është pasojë e politikës demografike restriktive.

Planifikimi i familjes paraqet rregullimi i gjinisë në mënyrë të vetëdijshme nga ana e çifteve në martesë (planifikimi i numrit të fëmijëve në familje dhe intervali ndërmjet lindjeve të tyre). Në kuptimin më të ngushtë të fjalës nënkuptohet kontrolli i lindjeve me ndihmën e mjeteve kontraceptive ose sterilizimin e njërit nga bashkëshortët. Aborti zakonisht nuk llogaritet metodë e planifikimit të familjes.

Koncepti i sotëm për planifikimin e familjes bazohet në vendosjen e lirë individuale të secili individ për numrin fëmijëve dhe kohën e lindjes së tyre përmes shfrytëzimit të diturive dhe mjeteve për mbrojtje nga shtatzënia e padëshiruar. Planifikimi i familjes duhet të kuptohet si e drejtë e njeriut. Maqedonia

është vend demografik heterogjen. Sipas të dhënave të Entit shtetërorë për statistikë, nga 31 dhjetori i vitit 2008, në republikën e Maqedonisë jetojnë 2048619 banorë.

Në periudhën nga 1994 deri 2008 vërehet rënie e vazhdueshme e lindjeve në vend. Shkalla e rritjes së popullsisë është më i vogël në rajonin lindor, të vardarit dhe rajonin juglindor, pak më i lartë në rajonin verilindorë dhe në rajonin e Shkupit, kurse më e lartë është në rajonin e pollogut. Në të tre rajonet e përmendura (lindor, i vardarit dhe Juglindor) rritja e popullsisë është minimale dhe është për shkak të rritjes së popullsisë në qendrat e më pashme komunale. Sot në shumicën e komunave ai ka parashtesë negative.

Në rajonin Verilindor, rritje të popullsisë ka vetëm në tre komuna, prej gjithsej tetë. Më e ulët është në Kriva pallankë, kurse mjaft e madhe në Kumanovë dhe Likovë. Ulje intensive të popullsisë shënojnë komunat Kileçove, Orashaci dhe Staro Negoriçane. Rajoni i Shkupit dallohet nga të tjerët. Madje 43% e rritjes së përgjithshme të popullsisë në vend i takon këtij rajoni. Nga gjithsej 16 komuna, në 13 është shënuar rritje e popullsisë për më tepër se 2%. Të tilla janë komuna e Shuto orizarit, Haraqinës, Studeniçanit, Sarajit, Kondovës, Ilindenit, Gjorçe Petrovit. Popullsia ka ulje në komunat Zelenikovë, Qendër dhe Sopište.

Rajoni i pollogut, në raport me të tjerat ka rritje më të madhe të popullsisë. Ky rajon merr pjesë 31.1% të rritjes së përgjithshme të popullsisë në vend. Numri më i madh i komunave (16 prej gjithsej 19) shënojnë rritje të popullsisë. Më e madhe është në Banjica e Poshtme dhe në Kamnjani (me mbi 2% të shkallë së rritjes), kurse me mbi 1% shkallë të rritjes së popullsisë janë komunat: Vrutoku, Gostivari, Negotina e Pollogut, Bogovinë, Vratnicë, Zhelinë, Tetovë, Xhempçishtë, dhe Shipkovicë. Në këtë periudhë popullsia është zvogëluar vetëm në komunat Mavrovë, Rostushe dhe Sërbinovë.

Dallimet në intensitetin e rritjes së popullsisë në përgjithësi dhe në komuna të veçanta, në masë të madhe kushtëzohen nga dinamika

STATISTIKË VITALE

	1998	2003	2003
Të lindur	26 630	23 596	22 945
Meshkuj	13776	12170	11 826
Femra	12863	11 426	11 119
Të vdekur	16628	17013	10 982
Meshkuj	3900	9699	9 972
Femra	7 640	8114,	9010
Martesa të lidhura	13993	14402	14695
Martesa të shkurorëzuara	1028	1405	1 209
Në 1000 banorë			
Të gjallë	133	11.6	11.2
Të vdekur	0.3	8.8	9.3
Martesa	7.0	7.1	7.2

Burimet e të dhënave: Enti shtetërorë për statistikë i Republikës së Maqedonisë, Maqedonia në numra 2009.

e ndryshme e komponentëve të lëvizjeve natyrore të popullsisë dhe pjesëmarrjes së tyre në ripërtrirjen e popullsisë.

Në bazë të këtyre të dhënave dhe analizave të bëra mund të nxirret përfundim se shkalla e riprodhimit të popullsisë së përgjithshme në RM tregon dy tendenca të ndryshme: riprodhimi jo i mjaftueshëm i popullsisë maqedonas dhe popullsisë tjetër të krishterë dhe riprodhimi i rritur i popullsisë shqiptare, turke dhe rome. Kjo do me thënë se problemi aktual në pjesën perëndimore të Maqedonisë është si të zvogëlohet riprodhimi i popullsisë, kurse në pjesën lindore si të rritet. Republika e Maqedonisë në vitin 1987 solli Rezolutë për politike të popullsisë, qëllimi i së cilës ishte bashkësia shoqërore, të kontribuojë me prindër të vetëdijshëm dhe dashuri prindërore, për përmirësimin e kushteve

jetësore dhe të punës dhe për përshtatjen zhvillimit demografik, social dhe ekonomik në vend.

Mplakja e popullsisë


Në literaturë nuk ekziston definicion i vetëm dhe i përgjithshëm i pranuar për nocionin mplakja demografike e popullsisë, por më së shpeshti me këtë nocion nënkuptohet procesi i rritjes së numrit të popullsisë me moshë 60 dhe mbi 65 vjet. Mplakja e popullsisë fillon kur: plakja mesatare e popullsisë do të arrijë 30 vjet, kur indeksi i plakjes (raport midis popullsisë më të vjetër se 60 dhe më të re se 20 vjet) është më e madhe se 40% dhe kur pjesëmarrja e personave pleq (persona më të vjetër se 60 vjet) në

popullsinë e përgjithshme është mbi 12%. Sipas ekspertëve të OKB-së në qoftë se në një vend popullsia e vjetër 65 dhe më tepër vite është mbi 7% nga numri i përgjithshëm i popullsisë, atëherë bëhet fjalë për vend me popullsi të mplakur. Duke u nisur nga këto indikatorë me të drejtë mund të përfundojmë se Republika e Maqedonisë është kapluar nga procesi i plakjes demografike.

Pasojat nga mplakja e popullsisë mund të ndahen në tre grupe: demografike, ekonomike dhe sociale. Secila grup e pasojave imponon nevojë përtëndërmarrë masa konkrete në formë të politikës demografike, ekonomike dhe sociale të shtetit konkret. **Pasojat demografike** të plakjes së popullsisë janë: rritja më e ngadaltë e shkallës së rritjes natyrore të popullsisë, rritja e shkallës së përgjithshme të vdekshmërisë, zvogëlimi i lëvizshmërisë (migrimit) të popullsisë dhe të tjera. **Pasojat ekonomike** të plakjes së popullsisë janë: zvogëlimi i ofertë së fuqisë punëtore, zvogëlimi i produktivitetit të punës. **Pasojat sociale** të mplakjes së popullsisë manifestohen përmes shkuarjes në pension dhe rritjes së varësisë dhe kujdesi për këta persona nga më të rinjtë. Në familjet tradicionale më shpesh për personat e moshuar kujdesen anëtarët tjerë të familjes, ndërsa në familjet moderne për ata kujdesen institucionet e specializuara. Në rastin e parë, personat e moshuar janë të integruar ndërmjet anëtarëve të familjeve të tyre dhe u sigurojnë mbështetje emocionale dhe siguri.



Struktura e shfrytëzuesve të pensionit



Personat e moshuar kanë nevojë për mbrojtje materiale, sociale dhe mbrojtje shëndetësore, si dhe mbështetje morale nga familja. Në raste të pa aftësisë fizike ose mentale, ndihma për personat e moshuar është e domosdoshme. Ekziston edhe numër i madh i personave të moshuar të cilët nuk janë martuar, nuk kanë fëmijë ose janë pa lidhje farefisnore. Atyre duhet t'u sigurohet ndihma përmes institucionet sociale dhe shëndetësore. Për shkak të të gjitha këtyre pasojave të plakjes së popullsisë, çdo shtet duhet të sigurojë për popullsinë mbrojtje sociale dhe politikë sociale.



Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato

1. Çfarë nënkuptojmë me nocionin mplakje e popullsisë?
2. A ekziston në Republikën e Maqedonisë proces i plakjes demografike?
3. Numëroni treguesit për procesin e plakjes së popullsisë.

Shteti	PDVi shprehur në bilionë \$ (2008)	Dendësia e popullsisë (nr. i njerëzve në km ²)
SHBA	14.264	44
Japoni	4.909	337
Kinë	3.860	138
Gjermani	3.653	232
Maqedoni	9.5	82
UE	17.696	112
Botë	60.115.459	45

Pasuria dhe dendësia e popullsisë ndikon në planifikimin e familjeve

MBROJTJA SOCIALE DHE POLITIKA SOCIALE

Shtetet moderne, posaçërisht ato të zhvilluara ekonomikisht qytetarëve të vet ua garantojnë të drejtat e mbrojtjes sociale dhe sigurisë sociale. Ato vendosin sisteme të mbrojtjes sociale dhe të sigurisë i cili u pamundëson paraqitjen e jo sigurisë sociale tek qytetarët, veçanërisht në rast të sëmundjes, plakjes, invaliditetit, amësisë, papunësisë. Sistemi i këtillë parasheh edhe masa të mbrojtjes sociale, posaçërisht në raste kur punëtorit i mungojnë mjete bazike për jetë. Mbrojtja sociale dhe e sigurisë përfshinë edhe parandalimin e paraqitjes së rreziqeve të përmendura, si dhe kompensimin e dëmit i cili ndodh me paraqitjen e tyre. Numri i përgjithshëm i masave dhe aktiviteteve të cilat shteti i ndërmerret me qëllim që të sigurojë mbrojtje sociale dhe siguri për gjithë kategoritë e popullsisë, si dhe masat të cilat mundësojnë zbatimin e asaj mbrojtjeje dhe sigurie quhet politikë sociale.

Krijues themelorë dhe bartës i mbrojtjes sociale dhe politikës sociale është shteti. Ai i përcakton masat, normat juridike dhe rregullat të cilat qytetarëve u garantojnë siguri sociale. Shikuar historikisht, mbrojtja sociale dhe politika sociale ka ndodhur si aktivitet i shteti me qëllim të sigurimit dhe të përmbushjes së nevojave ekzistenciale të njeriut. Kontribut të posaçëm kanë sindikatat, të cilat përmes lëvizjeve të organizuara sindikaliste u kanë ndihmuar punëtorëve të luftojnë për të drejtat e tyre (shpërbli

adekuat, mbrojtje më të mirë dhe më të madhe në punë, sigurim pensional, mbrojtje shëndetësore dhe sigurim invalidor).

Proceset e tranzicionit si edhe ndryshimet në zhvillimin ekonomik, politik dhe shoqëror në Republikën e Maqedonisë e imponuan nevojën e ndërtimit të sistemit të ri të mbrojtjes sociale i cili do të jetë në funksion të realizimit dhe afirmimit të parimeve Kushtetuese. Në këtë drejtim u soll Ligji për mbrojtje sociale dhe rrjeta e institucioneve sociale përmes së cilave do të realizohet. Ligji definonte disa lloje të rreziqeve sociale: rrezik për shëndetin, rreziqe të plakjes, rreziqe të amësisë dhe familjes, rreziqe nga papunësia dhe mos përshtatja me mjedisin social.

Të drejtat dhe masat për sigurim dhe mbrojtje në rast të papunësisë

E drejta e punës është e drejtë themelore e njeriut dhe prandaj ajo është inkorporuar në kushtetutat pothuajse të të gjitha vendeve në botë. Por, nuk është e mjaftueshme shtetet ta njohin këtë të drejtë e punës. Ato duhet të krijojnë edhe kushte për realizimin e saj në praktikë. Për këtë qëllim, shtetet zbatojnë disa hulumtime, analiza, përmes së cilave



Shteti duhet t'i sigurojë mbrojtje sociale dhe siguri secilit punëtorë

i përcaktojnë kushtet ekzistuese ekonomike, por edhe programet zhvilluese përmes së cilave i analizojnë mundësitë për hapjen e vendeve të reja të punës. Tërësinë e këtyre aktiviteteve e përbëjnë përmbajtjen e politikës së punësimit.

Në rast të papunësisë, personat kanë më tepër të drejta, dhe atë: të drejtën në ndihmë dhe ndërmjetësim gjatë punësimit ose gjatë zgjedhjes së profesionit; e drejta e aftësimin profesional dhe rikualifikim; të drejtën e kompensimit në rast të lëndimeve ose sëmundjeve. Një e drejtë shumë e rëndësishme të cilën e kanë punëtorët është e drejta e kompensimit në rast të papunësisë ose pengesës për punë.

Masat të cilat i ndërmerr një shtet për zvogëlimin e papunësisë janë të ndryshme dhe atë:


- Hapjen e vendeve të reja të punës, pa mos u mbyllur ata ekzistues,
- lirimi i vendeve të reja të punës, përmes organizimit më ndryshme të orarit të punës (shkurtimi i orarit të punës nga 45 në 35 orë në javë),
- arsimim profesional, arsim për rikualifikim,
- përparësi gjatë punësimit ndaj personave të kategorisë së pambrojtur.

Sigurimi social

Sigurimi social ekziston me qëllim që të sigurojë siguri ekonomike për individët në të gjitha periudhat e jetës. Sigurimi është më i nevojshëm për të sëmurët, personat invalid, prindërit dhe pensionistët.

Mbani mend

Sigurimi social është i bazuar me ligj dhe mbrojtje e përcaktuar materiale me qëllim për të mbrojtur të punësuarit dhe anëtarët e familjes së tyre në rast të sëmundjes, fatkeqësisë në punë, dobësimi, mplaçka, vdekja dhe papunësia, si dhe në raste tjera të parapara me ligj.



Mësoni më tepër

Format e para të sigurimit social i takojmë në Suedi dhe ishin quajtur "kujdesi për të varfrit". Shfrytëzoheshin për zbutjen e pasojave nga varfëria masive dhe vdekja masive. Kah mesi i shek. XIX, në periudhën e industrializimit, populli e lëshoi prodhimin e zejtarisë dhe në mënyrë masive punësohej nëpër firma. Puna ishte e rëndë, kushtet banesore të rënda, kurse punëtorët nuk kishin asnjë farë mbrojtjeje. Sëmundjet, fatkeqësitë në punë u rritën, kurse për shkak të mungesave të shpeshta, punëtorët nuk merrnin të ardhura

personale. Të domosdoshme ishin reformat sociale. Kah fundi i shel. XIX punëtorët filluan të themelojnë të ashtuquajturat “arkat për të sëmurët” të cilat i shfrytëzonin punëtorët të cilët ishin në pozitë të vështirë. Më vonë këto arka i mbushte shteti. Sot, ato mbushen nga taksat dhe tatimet të cilat detyrimisht i paguajnë të gjithë suedezët, kur atyre u jepet e drejta t'i shfrytëzojnë këto mjete kur u nevojiten më së tepërmi.

Kur flasim për sigurimin social mendohet në tre degë të sigurimit: **shëndetësor, pensional dhe invalidor**. Secila prej këtyre degëve të sigurimit social siguron ndonjë mbrojtje. Sigurimi shëndetësor ka për qëllim t'u sigurojë mbrojtje shëndetësore të gjitha atyre me gjendje shëndetësore të keqe ose për shkak të paaftësisë për punë. **Sigurimi pensional** ka për qëllim sigurimin e sigurisë sociale të individit gjatë hyrjes në moshë ose anëtarëve të familjes së tij në rast të vdekjes së tij. **Sigurimi invalidor** ka për qëllim sigurimin në rast të zvogëlimit ose të humbjes së aftësisë për punë për shkak të invaliditetit, dëmtimeve trupore ose sëmundjeve profesionale.

Sigurimi social, shëndetësor, pensional dhe invalidor si edhe shfrytëzimi i të drejtave në bazë të këtyre sigurimeve sigurohen me pagesën e kontributeve nga ana e punëtorëve, nga fitimi i ndërmarrjeve dhe punëdhënësve, si dhe nga ana e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë në fonde përkatëse.

Sigurimi social ka tre dimensione: *social-humanitar, politike dhe ekonomike*. Sociale-humanitare shikohet në lirimin e njeriut nga frika për ekzistencën materiale, e cila paraqitet veçanërisht nëse individ nuk është i aftë për punë. Dimensioi politik shikohet në ndjenjën e sigurisë e cila u jep individëve vet sistemi i sigurimit social. Në këtë mënyrë i iket një numri të madhe të implikimeve të cilat mund seriozisht ta prishin stabilitetin politik të një shteti. Sigurimi social paraqet pjesë të standardit jetësor dhe shoqëror në një vend. Përmes tij sigurohen mjetet për mbijetesën e personave (dhe të familjeve të tyre), të cilët për një sërë arsye nuk janë

në mundësi të njëjtat t'i realizojnë. Në këtë shihet dimension i ekonomik i sigurimit social.

Aktivitet hulumtues

Mësoni çfarë lloje të mbrojtjes shëndetësore (shërbime) mund të shfrytëzojnë njerëzit përmes sigurimit shëndetësor. Kontrolloni nëse sigurimi shëndetësor u mundëson njerëzve (siguruesit) shërbime të llojit operacione estetike dhe sipas cilave kushte. Si fitohet e drejta e sigurimit shëndetësor dhe pensional.

EKOLOGJIA – MBROJTJE E MJEDISIT JETËSOR

Shoqëritë moderne gjithnjë e më tepër bëhen shoqëri të ndotura. Nga dita në ditë rritet numri i materieve ndotëse të cilat shpërndajnë nëpër atmosferë, truall, ujë dhe e shkatërrojnë mjedisin jetësor. Zhvillimi i shpejtë i industrisë, komunikacionit, mjetet motorike, përdorimi masiv i thëngjillit, naftës, gazit në mënyrë serioze e rrezikojnë mbijetesën e gjithë botës së gjallë në planetin – Tokë.



Ndryshimet në klimën globale, rritjen e dyoksid karbonit në atmosferë si rezultat i prodhimit industrial, reduktimin e zonave pyjore të mbrojtura në Tokë, efektet planetare nga lloji “kopshtet të qelqta”, zvogëlimi i mbështjellëses së ozonit e cila e mban rrezatimin ultra vjollcë, rritjen e rrezatimit radioaktiv të shkaktuar nga provat nukleare janë dëshmi se njerëzimi gjendet para një kthese të madhe. Ai duhet të vendos nëse do të vazhdojë në rrugën e cila çon deri në vetëvrasje ose do të përshtat jetën e vet me mundësitë e planetit Tokë.

Ekologjia është shkencë e cila studion raportin e qenieve të gjalla dhe mjedisit jetësor, gjegjësisht raportin e qenieve të gjalla me mjedisin në të cilin jetojnë. Mesazhi i saj më i njohur është “mendoni globalisht, ndërsa veproni lokalisht”. Mesazhi qartë tregon se nuk është e mjaftueshme të dihet çka paraqet kërcënimi i tij, por ai duhet të dijë si ta pamundësojë paraqitjen e kërcënimit.

Domethënë, çështja themelore ekologjike e cila sot paraqitet para njerëzimit është: çfarë duhet të bëhet që të mbrohet mjedisi jetësor nga ndotja e mëtutjeshme dhe shkatërrimi? Së pari, e domosdoshme është të zhvillohet dhe të ngritet vetëdija për nevojën e mbrojtjes mjedisit jetësor, gjegjësisht të krijohet tek mbarë popullsia një vetëdije e zhvilluar ekologjike për atë se çka ndodh në rrethinën tonë, fillimisht të gjithë ne jemi përgjegjës. Për mbrojtjen e mjedisit jetësor, në shumicën e vendeve në botë, ekzistojnë shoqata dhe organizata, të cilat ndërmarrin një sërë aksione, pikë së pari për ngritjen e vetëdijes ekologjike, pastaj edhe për ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Për mbrojtjen e mjedisit jetësor, në një numër të madh të shteteve sot ekzistojnë ministri të posaçme. Edhe në Republikën e Maqedonis ekzistojnë Ministri për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Nocioni ekologji vjen nga fjalët greke “Rikos” që do me thënë shtëpi, vendbanim dhe “Jogos” që d.m.th. shkencë. Themeluesi i ekologjisë llogaritet Çarls Darvini, i cili në veprën e vet Prejardhja e specieve përpunoi një numër të madh të fenomeneve ekologjike. Fjalën ekologji së pari e ka përdorur Ernes Hekel në vitin 1868 dhe për atë ekologjia është: “studim i lidhjeve të ndërsjella të qenies së gjallë me mjedisin i cili e rrethon (si organike ashti edhe joorganike), por para së gjithash raportet miqësore dhe jo miqësore me shtazët dhe me bimët me të cilët bie në kontakt”.



Aktivitet hulumtues

Ngrohja globale momentalisht është problem më serioz ekologjik, si edhe ndotja e ajrit, ujit, zhdukja e një numri të madh të llojeve shtazore, shirat acidik, dhe të tjera. Ngrohja globale shkakton ndryshme serioze klimaterike, kurse ato në kombinim me ajrin dhe ujin e ndotur janë shkaktarë të shumë sëmundjeve dhe arsye për rritjen e vdekshmërisë së planetit Tokë. Edhe përkundër kësaj njerëzit ende nuk ndërmarrin aktivitet adekuat në nivel global, përveç disa aktiviteteve më të vogla. Disa shkencëtarë mendojnë se tashmë është vonë të ndërmerren çfarëdo qoftë hapash në këtë drejtim, kurse të tjerët mendojnë se ende ka shpresë (të paktën të ndërpritet keqësimi i mëtutjeshëm i gjendjes). Gjeni të dhëna të cilat flasin për aktivitetet e ndërmarra deri tani në drejtim të pengimit të katastrofës ekologjike, dhe pastaj shkruani një ese sipas pyetjeve vijuese:

1. Si e përjetoni ndotjen e mjedisit jetësor?
2. Cilat masat sipas jush duhet të ndërmerren për të mbrojtur mjedisin jetësor nga shkatërrimi i mëtutjeshëm?
3. Kush duhet të jetë bartës i aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit jetësor në nivel global?



Veprimi humanitar

Të jesh human d.m.th se jeni njeri, të kesh raport aktiv me vlerat, posaçërisht me njerëzit të cilat prej cilat do arsye nuk janë të gjendje t'i përmbushin nevojat e veta. Humaniteti nuk krijon varësi midis njerëzve, por kundrazi, respektimin e personalitetit, aftësitë dhe potencialet e tij.


Veprim humanitar quhet çdo aksion i organizuar për ndihmë me qëllim zbutjen e vuajtjeve të njerëzve si pasojë e konfliktit të armatosur ose katastrofës natyrore (tërmet, epidemi, thatësi, vërshime, vullkane).

Organizata më e thirrur dhe më masive e cila kujdeset për humanitetin dhe veprimin humanitar është Lëvizja ndërkombëtare e Kryqit të kuq. Detyra e saj është gjatë konflikteve të armatosura dhe trazirave të veproje si ndërmjetësues neutral ndërmjet palëve në konflikt. Ofron mbrojtje dhe ndihmë për viktimat në luftërat ndërkombëtare, luftërave qytetare, trazirat e brendshme dhe organizon spitale në vend të hapur dhe të tjera. Marka e kësaj organizate është kryqi i kuq në prapavijë. Misioni i saj është: ta pengojë dhe të zbus vuajtjen e njerëzve kudo që gjenden; ta mbrojë jetën dhe shëndetin; të sigurojë respekt dhe dinjitet për njeriun, posaçërisht gjatë konflikteve të armatosura, fatkeqësi dhe katastrofa; të punojë në parandalim të sëmundjeve dhe përparimin e shëndetësisë dhe mirëqenien sociale të njerëzve; të nxis angazhim vullnetar dhe përgatitje të vazhdueshme për dhënien e ndihmës si dhe ndjenjë universale për solidaritet dhe humanizëm.

- Shtatë parime mbi të cilat bazohet veprimi humanitar i Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq:



- Humanitet – dhënia e ndihmës të lënduarve në konfliktet e armatosura pa diskriminim, me qëllim mbrojtjen e jetës, mbrojtjen dhe respektimin e dinjitetit të çdo individi,




- Paanshmëria – zbutja e vuajtjeve të njerëzve sipas nevojave të tyre varësisht nga cila klasë ose racë bëjnë pjesë ata;




- Neutraliteti – ruajtja e besimit; lëvizja nuk mbron asnjërën nga palën në konflikt në bazë fetare, klasore, racore ose politike;




- Pavarësi – çdo lëvizje kombëtare e Kryqit të kuq në mënyrë të pavarur planifikon dhe organizon aktivitetet e veta humanitare;



- Voluntarizmi – aktivitetet humanitare bazohen në punën vullnetare, e jo në arritjen e dobisë personale.



- Unitet – në një shtet të pranuar ndërkombtarisht mund të ekzistojë vetëm një shoqatë kombëtare e Kryqit të kuq, e cila është në dispozicion të të gjithëve; aksionet humanitare duhet të zbatohen nëpër tërë territorin e shtetit;



- Universal – Kryqi i kuq është lëvizje botërore; organizatat e saj kombëtare kanë pozitë të barabartë, bashkëpunojnë dhe janë të drejta të barabarta.



Mësoni më tepër

Mjek pakufi është organizatë ndërkombëtare joqeveritare humanitare, e cila u jep ndihmë medicinale viktimave në konfliktet e armatosura, epidemi dhe katastrofa natyrore ose të shkaktuara në mënyrë artificiale. Përveç kësaj, ajo ofron ndihmë për të gjithë ata, të cilët janë jashtë kësaj mundësie dhe ndihmë rëndë e arritshme medicinale nga arsye të ndryshme. Organizatën e kanë formuar një grup mjekësh francezë në vitin 1971, me seli në Gjenevë. Çdo vit rreth 3000 mjekë, motra dhe personelë tjerë mjekësorë shkojnë në detyra të ndryshme në mbarë botën. Veprojnë në më shumë se 70 vende të botës (japin mbrojtje primare shëndetësore, e vaksinojnë popullatën, aftësojnë spitale dhe ambulanca, zbatojnë programe të ndryshme sanitare, e trajnojnë popullatën lokale dhe të tjera). Kanë fituar çmim Nobël për paqe.

Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato



1. Në cilat kushte më së shumti vjen në shprehje veprimi humanitar?
2. Përmendini shembujt të angazhimit të të rinjve në veprime humanitare.

NE NË EVROPË DHE NË BOTË

Bota moderne dhe globalizimi i saj

Sot në planetin tonë jetojnë mbi 6 miliard njerëz, me vendbanime në mbi 200 shtete të pranuar dhe të pavarura, të cilat dallohen sipas madhësisë së territorit dhe numri të banorëve. Nga 6 kontinente në botë, më dendësi më të madhe është Evropa, kurse me rrallë Australia. Si shtete më të mëdha dhe më të populluara janë Kina dhe India, kurse si më të vogla edhe sipas madhësisë edhe sipas numrit të banorëve është Barbadosi, Andorra, Monako, San Marino.

Por, vendet dallohen edhe sipas pasurisë natyrore dhe shkallës së zhvillimit të tyre shoqëror. Ato dallime janë rezultat i faktorëve klimaterik, të vegjetacionit, gjeografik, në potencialet jo të barabarta natyrore dhe energjetike, por edhe dallimet në zhvillimin e tyre historik dhe socio-kulturor. Tregues më i mirë për zhvillimin e vendit është prodhimi i tij bruto shoqëror. Sipas kësaj, vendet më të zhvilluara dhe më të pasura në botë janë Kanadaja, Norvegjia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Japonia (prodhimi i tyre bruto shoqëror për një banor është mbi 35 000 dollarë në vit), kurse vendet më pak të zhvilluara dhe më të varfëra do të ishin si, për shembull, Siera Leone, Etiopia, Burundi (me më pak se 500\$ prodhim bruto për kokë banori).

Se bota është me pamje të ndryshme flet edhe fakti që në atë fliten rreth 5000 gjuhë të ndryshme dhe shumë më tepër dialekte, qindra religjione të ndryshme, kombe dhe grupe etnike, kultura nga më të ndryshmet, besime, tradita, lloje të bashkësive shoqërore. Mënyra e prodhimit, stili i jetës, zhvillimi i profesioneve, zakonet në të gjitha anët janë të ndryshme. Një pasuri dhe vlerë kulturore e civilizimit të sotëm.

Nga ana tjetër, bota nuk është vetëm me pamje të ndryshme, por edhe e ndarë në vende të zhvilluara dhe të pasura dhe në të pazhvilluara dhe të varfra. Zakonisht, vendet më të pasura njëkohësisht janë edhe më të zhvilluara në teknologji. Prodhimi dhe

industria e tyre janë shumë produktive, mjetet moderne informatike dhe e komunikimit janë shumë të përfaqësuara, kurse popullata në masë të madhe shkollohet dhe e mbrojtur nga sëmundjet. Karakteristike është se në vendet e tilla papunësia është relativisht e ulët. Shumica e banorëve jetojnë në qytete. Përveç nevojave themelore për jetë – shumë mjete ndajnë për kulturë, zbavitje, sport, rekreacion.

Në grupin tjetër të vendeve – të pazhvilluara dhe të varfëra, prodhimi është kryesisht primitiv dhe atë më shpesh me bujqësi, kurse teknologjia moderne dhe informatika janë pak të përfaqësuara. Në ato vende sipas rregullës ekziston analfabetizëm i lartë, natalitet dhe vdekshmëri të fëmijët, por edhe jetë relativisht të shkurtë. Shpesh sundojnë sëmundje dhe epidemi dhe ndonjëherë edhe uria. Gjuha dhe dallimet midis vendeve të pasura dhe të varfëra paraqet një nga problemet më të mëdha të njerëzimit dhe të sotmes. Edhe pse bashkësia ndërkombëtare ndërmerr masa të shumta për të përshpejtuar zhvillimin e vendeve jo mjaft të zhvilluara dhe të varfra, ato tregojnë pak rezultate. Kjo na përket të gjithë neve dhe kërkon mbështetje kolektive, solidaritet dhe ndihmë për vendet e pazhvilluara.

Karakteristika e ardhshme e botës sot është se ajo bëhet gjithnjë e më e lidhur dhe më e gërshetuar. Gjithnjë e më tepër rritet bashkëpunimi dhe lidhjet ndërmjet vendeve dhe popujve. Këtë proces e quajmë globalizim i botës. Vendet në botë tregtojnë ndërmjet veti, kurse teknologjitë moderne të informatikës u mundësojnë njerëzve shumë më tepër se më parë të komunikojnë, të njihen, të informohen ndërmjet veti, të prodhojnë bashkërisht, të shpenzojnë begatitë e njëjta. Mediumet masive janë të pranishme për qindra milionë njerëz (televizioni, radioja, shtypi, interneti). Firmat e mëdha ekonomike siç janë Koka-kola, Nestle, Ford, Microsoft, Mitcubishi, e të tjerë prodhojnë ose shesin, pothuajse, gjithkund në botë. Prandaj, vendet dhe njerëzit bëhen edhe më të varur dhe më të drejtuar midis veti.

Për këtë arsye disa shkencëtarë planetin tonë e quajnë “fshati global” i gërshetuar me “autostrada të informatikës”.

Por, sa më tepër bota globalizohet dhe bëhet i varur, aq më tepër rritet edhe nevoja e institucioneve dhe organizatave, të cilat e përbëjnë dhe e përshtatin zhvillimin e tyre drejt arritjes së synimeve dhe vlerat civilizuese të përbashkëta. Të tilla janë një numër i madh i organizatave ndërshtetërore, joshtetërore, profesionale dhe humanitare dhe shoqata të tjera. Detyra e tyre është të harmonizojnë zhvillimin e shoqërive dhe të pengojnë si dhe të zgjidhin mosmarrëveshjet, por edhe konfliktet e armatosura, të cilat ndodhin për shkak të dallimeve të mëdha ekonomike dhe sociale ndërmjet shteteve.

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) është organizatë universale botërore, e cila vepron në drejtim të pengimit të konflikteve ndërmjet shteteve në bazë të respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Është krijuar në vitin 1945 në San Francisko. Organet e saj kryesore janë Asambleja e përgjithshme, e cila mbledhet çdo vit rregullisht, si edhe Këshilli i sigurimit.

Organizata disponon me agjenci speciale dhe organizata, të cilat veprojnë në drejtim të harmonizimit të zhvillimit në botë. Të tilla janë për shembull FAO (organizata e ushqimit dhe bujqësisë), UNESCO – (për arsim, kulturë dhe shkencë), UNIDO – për zhvillim industrial dhe shumë të tjera.

Kombet e bashkuara, gjithashtu e drejtojnë edhe veprimtarinë e Bankës botërore dhe Fondit monetar ndërkombëtar. Banka dhe fondi u japin vendeve në zhvillim hua me kushte të volitshme dhe përmes projekteve avancohet ekonomia e tyre. Por, shumë me rëndësi është të gjitha vendet dhe të gjithë njerëzit në botë të marrin pjesë në krijimin e mendimit publik dhe aksionet e përbashkëta të drejtuara kah synimet paqedashëse, humanitare dhe zhvilluese.

Detyrë



Shkruajeni një ese, në të cilën do të shpjegoni dallimin dhe ndarjen e botës.



Evropa dhe integrimi saj

Krijimi i unionit evropian

Evropagjithmonëkaqenëngabrendashumë e ndryshme, e ndarë dhe kundërthënëse. Në Evropë ekzistojnë shtete nga më të voglat deri te më të mëdhatë, shumë të zhvilluara dhe skajshmrisht të pazhvilluara. Fliten qindra gjuhë, të cilat kryesisht bëjnë pjesë në grupin e gjuhëve indoevropiane. Midis religjioneve mbizotëron krishterimi. Këto dallime kanë shkaktuar nëpër gjithë historinë e Evropës shumë luftëra, konflikte, tensione. Të njohura janë luftërat, të cilat i kanë udhëhequr shtetet antike greke, luftërat e perandorive maqedonase, romake, bizantine, dhe perandorisë osmane. Në mesjetë janë udhëhequr luftëra të gjata fetare, në shek. e XIX luftërat e Napoleonit, kurse në shek. XX dy luftërat botërore, të cilat kryesisht kanë ndodhur në territorin evropian.

Por, në Evropë që moti ekzistonin lëvizje dhe ide paqësore që kontinenti të bashkohet dhe të bëhet një lidhje e madhe e shteteve, me treg të përbashkët, me kufi të hapur, me këmbim të pasur ekonomik dhe kulturor dhe me dëshirën e vetme për respektimin e të drejtave dhe lirive qytetare të njeriut. Midis ideve të para për bashkim paqësor të Evropës është ajo e shkrimtarit të njohur francez Viktor Hygo që në vitin 1849. Ai është i njohur për fjalët e tij: “Do të vijë dita kur të gjitha kombet në këtë kontinent do të bashkohen me një nivel më të lartë të bashkimit dhe të krijojnë Vëllazërinë Evropiane, pa mos i humbur karakteristikat e veta dhe individualitetin e tyre të famshëm. Do të vijë dita kur mendjet do t'i bëjnë betejat e vetme – në tregun e hapur të ideve. Do të vijë dita kur fletat e votimit do t'i zëvendësojnë plumbat dhe bombat”.



Pasojat e Luftës së dytë botërore treguan se shtetet kombëtare nuk do të mund t'u mundësojnë sukses ekonomik shtetasve të vet, nëse nuk mbështeten vetëm në interesin e vet, nëse nuk kujdesen për interesat e shteteve tjera. Politikani francez Robert Shuman këtë e shpjegon më së miri kur thotë: "E nevojshme është secili të njihet nga besimi se ne kemi nevojë për njëri-tjetrin. Shtetet janë të paafta të përballojnë problemet e mëdha, të cilat u imponohen vetëm me ndihmën e forcave të veta".

Faza e parë e bashkëpunimit evropian filloi para vitit 1948 kur ishte formuar Organizata evropiane për bashkëpunim ekonomik. Detyra e saj ishte ta shpërndajë ndihmën amerikane të menduar për vendet evropiane të djegura gjatë luftërave. Për t'u mbajtur në kontroll zhvillimin e industrisë së rëndë gjermane, ministri francez për punë të jashtme Robert Shuman propozoi një plan për krijimin e Bashkësisë Evropiane, e cila do të kontrollojë prodhimin e thëngjillit dhe çelikut në Republikën Federale të Gjermanisë dhe të Francës. Për shkak se propozimi ishte pranuar me 9 maj 1950, kjo datë edhe sot llogaritet si ditëlindje e Unionit Evropian dhe çdo vit festohet si "Ditë e Evropës". Ky propozim më vonë u mbështet

nga Italia, Belgjika Franca, Holanda dhe nga Luksemburgu.

Kështu në Paris në vitin 1951, gjashtë vende: R.F. e Gjermanisë, Franca, Italia, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu e nënshkruan marrëveshjen, me të cilën themelohet Bashkësia Evropiane për thëngjill dhe çelik (BETHÇ). Këto shtete vendosin bashkë për të menaxhuar me thëngjillin dhe çelikut në një mënyrë simbolike, kurse materialet e luftës shndërrohen në mjete për pajtim dhe për arritjen e paqes.

Në vitin 1973 në Bashkësinë Evropiane ekonomike iu bashkëngjitën edhe vendet: Danimarka, Irlanda, Mbretëria e Bashkuar, ku numri i vendeve anëtare u rrit në 9. Në vitin 1995 në Unionin Evropian u bashkuan edhe tre vende: Austria, Finlanda dhe Suedia. Sot në këtë Union janë anëtare 27 vende evropiane.

 Austria	 Belgjika	 Qiproja	 Republika e Çekisë	 Danimarka
 Estonia	 Finlanda	 Franca	 Gjermania	 Greqia
 Hungaria	 Irlanda	 Italia	 Letonia	 Lituania
 Luksemburgu	 Malta	 Polonia	 Portugalia	 Sllovakia
 Sllovenia	 Spanja	 Suedia	 Holanda	 Mbretëria e bashkuar
 Bullgaria	 Romania			

Simbolet e Unionit Evropian

Simbolet e Unionit Evropian janë flamuri dhe himni i Unionit. Flamuri i Unionit Evropian është i përbërë nga 12 yje të verdha të arta, të vendosura në rreth, me prapavijë të kaltër. Pesë krahët e yjeve simbolizojnë bashkimin e popujve të Unionit, kurse zgjedhja e numrit të yjeve (12) i përket simbolikës së numrit.

Ky numër paraqet simbol të përsosmërisë dhe të unitetit. Himni i Unionit Evropian është tema e simfonisë së nëntë “Ode e gëzimit”, e kompozuar në vitin 1823 nga kompozitori Ludving van Betoven. Himni paraqet shprehje të vizionit të Betovenit për afrimin e popujve dhe racave në botë. Himni evropian, flamuri evropian, modeli i pasaportës evropiane, modeli i patentave të shoferit paraqesin simbole për mbështetjen e identitetit të përbashkët evropian, gjegjësisht ndjenjën e përbashkët të përkatësisë. Futja e eurobankotave dhe monedhave, si dhe me heqjen e kontrollit të pasaportave në zonën Shengen, ndikojnë te qytetarët të formojnë ndjenjë se bëjnë pjesë në një sferë të vetme gjeografike.

Tre institucionet më të rëndësishme të unionit evropian janë: Këshilli i Unionit Evropian, Parlamenti Evropian, Komisioni Evropian. Këto institucione i përfaqësojnë interesat e vendeve anëtare veç e veç, por edhe interesat e përbashkëta të Unionit. Këshilli i Unionit Evropian është institucioni udhëheqës, trup vendimmarrës i cili përfaqëson interesat e vendeve anëtare. Parlamenti Evropian është trup i zgjedhur i

cili përfaqëson qytetarët e Unionit Evropian. Komisioni evropian është pushteti ekzekutiv i Unionit Evropian.

Mbani mend



Përfitimi kryesor i krijimit të Unionit Evropian është vendosja e tregut të përbashkët. Mallrat e prodhuar në një vend të Unionit mund lirisht të shiten në vendet tjera në Unionin Evropian, dhe për këtë të mos paguhet doganë. Tregu i përbashkët i Unionit Evropian mundëson edhe lëvizje të lirë të kapitalit. Kjo d.m.th. se ndonjë ndërmarrje ose individ i një vendi të Unionit Evropian mund të blejë fabrikë në një vend tjetër ose të ndërtojë të re. Krijimi i tregut të përbashkët evropian e imponon nevojën e futjes së të *hollave të vetme – euro*.

Kontrollojini njohuritë tuaja dhe përdorini ato



1. Si u paraqit ideja e krijimit të Unionit Evropian?
2. Shpjegojini hapat në krijimin e Unionit Evropian?
3. Shpjegojeni si realizohet lëvizja e lirë e njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit nëpër Unionin Evropian?



Знамето на Европската Унија

Liria, drejtësia dhe siguria në Unionin Evropian

Falë Unionit Evropian, qytetarët e vendeve anëtare mund të udhëtojnë, të jetojnë dhe të punojnë në gjithë Evropën. Mësuesi britanik ka mundësi të ligjërojë gjuhë angleze në një shkollë në Romë, kurse një i ri francez i diplomuar mund të paraqitet në një konkurs për punësim në ndonjë institucion shtetëror në Belgjikë. Mundësitë të këtyra fituan qytetarët evropianë, meqë Unioni vendosi sistemin për njohje të ndërsjellë të arsimit sipëror ndërmjet vendeve anëtare. Ata u obliguan t'i barazojnë studimet universitare dhe të sigurojnë kualitetin e duhur të studimeve. Në këtë mënyrë, çdo person shtetas i ndonjë vendi anëtar të Unionit mund të punësohet në shëndetësi, arsim dhe në sektorët tjerë publikë gjithkund nëpër Unionin Evropian, vetëm jo në polici, në forcat e armatosura dhe në shërbimet e punëve të jashtme.

Unioni vite me radhë siguron liri dhe siguri për lëvizjen e qytetarëve të tij me një sërë kontratash dhe aktesh. Në vitin 1985 ai ndërmori një hap, me të cilin u lehtësoi udhëtimet nëpër evropë. Qeveritë e Belgjikës, Francës, Gjermanisë, Luksemburgut dhe Holandës nënshkruan marrëveshje në qytetin e vogël Shengen, ku i hoqën kontrollet në pikat kufitare për qytetarët e tij, kurse me vendet, të cilat nuk janë anëtare të Unionit Evropian, zbatuan politikë të përbashkët për dhënie e vizave. Në këtë mënyrë, ata krijuan zonë pa kufi të brendshme, e njohur si zona Shengen.

Nga viti 2004, qytetarët evropian, të cilët udhëtojnë nëpër Union, nga qeveritë e tyre kombëtare fitojnë edhe kartelë për sigurim shëndetësor evropian. Kjo ndihmon në mbulimin e shpenzimeve mjekësore në rast të sëmundjes, që i sëmuri e ka fituar derisa ka qenë në vend tjetër.

Unioni posedon sistem efikas për ndjekjen e migruesit dhe pengimin e migrimit ilegal.



Përmes aktiviteteve të koordinuara me sukses merret edhe me luftën kundër krimit të organizuar, tregtisë me njerëz dhe me forma të ndryshme të eksploatimit, posaçërisht të grave dhe fëmijëve.

Vendet e Unionit Evropian bashkëpunojnë në fushën e punës policore dhe të drejtësisë me qëllim që Evropa të jetë më e sigurtë dhe më e mbrojtur. Përparim më i madh në këtë drejtim Unioni ka arritur me formimin e Evropollit. Ky trup i Unionit i përbërë nga nëpunësit policorë dhe të doganës, të cilët përmes aktiviteteve mirë të organizuara me sukses merren me krimin ndërkombëtar. Me futjen e fletarrestit Evropian në janar të vitit 2004 Unioni ua lehtësoi pushteteve kombëtare hetimore të vendeve anëtare drejtimin e hetimeve dhe procedurave kriminale të ekstradimit. Fuqinë e saj mbrojtëse, Unioni e organizon në paktin e Atlantikut verior, NATO. Në këtë pakt bëjnë pjesë edhe SHBA dhe Kanadaja. Vendet e Unionit janë pjesëmarrës edhe në marrëveshjen mbrojtëse të quajtur Partneriteti për paqe, Pakti për stabilitet dhe të ngjashme.

Por, përkrah Unionit Evropian, ekzistojnë edhe organe tjera gjith Evropiane dhe organizata në të cilat janë të anëtarësuar, pothuajse të gjitha shtetet e Evropës. Të tilla janë Këshilli i Evropës, i cili kujdeset për zhvillimin e demokracisë dhe të drejtat e njeriut dhe Organizata për siguri dhe bashkëpunim (OSBE), e cila drejton përpjekjet për paqe dhe mirëqenie në kontinentin evropian.

Identiteti evropian

“Ne nuk i shoqërojmë shtet, ne i bashkojmë qytetarët”,

Politikani francez Zhan Mone,

Unioni evropian ekziston një gjysmë shekull dhe për këtë periudhë kanë ndërtuar vlera të plota mbi të cilat e ndërton identitetin e saj. Paqja dhe zgjidhja e konflikteve në mënyrë paqësore janë vlera të plota evropiane. Dëshira për paqe ishte motiv i fortë për krijimin e Unionit, por është kusht themelor për ekzistimin e saj.

Në UE vlejnjë parimet e barazisë dhe të unitetit. UE-ja nuk do të mund t'i zgjidh problemet me të cilat ballafaqohet, nëse nuk ekziston lidhshmëri e brendshme dhe barazi të pakushtëzuar. Në UE të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe askush nuk guxon të ndjehet inferior, i diskriminuar në asnjë farë baze. Kjo e dëshmon edhe moton në të cilën thirret Unioni Evropian, e cila është “Të bashkuar në diversitete”.

Liria e lëvizjes është privilegj i qytetarëve evropian. Ata posedojnë model evropian të pasaportës dhe lejes së shoferit, të cilat u mundësojnë të jetojnë dhe të udhëtojnë nëpër gjithë Unionin, të zgjedhin punë sipas dëshirës, të studiojnë sipas programeve arsimore evropiane. Kështu, për shembull, në periudhën 2007-2013, tre milion studentë do të kenë mundësi të studiojnë sipas programës evropiane “Erazmus”.

Solidariteti është vlerë themelore mbi të cilën Unioni Evropian e ndërton identitetin e vet. Vendet anëtare të Unionit tregojnë solidaritet të ndërsjellë, që vjen në shprehje, posaçërisht në kushte të fatkeqësisë së motit, katastrofave natyrore dhe të ngjashme.

Paqja dhe zgjidhja paqësore e konflikteve janë vlerë e plotë evropiane. Përfitim i posaçëm i Unionit është respektimi i të drejtave themelore të qytetarëve dhe sundimi i së drejtës. Në UE vlejnjë parimet e

barazisë dhe të unitetit dhe prandaj të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk guxon të ndjehet inferior, i diskriminuar në asnjë farë baze. Të gjitha këto vlera të plota e përbëjnë identitetin ekonomik. Përmes tij qytetarët e Unionit Evropian dallohen nga bota tjetër. Unioni Evropian është mënyra e vetme si të ruhet trashëgimia kulturore evropiane.

Zgjerimi i Unionit Evropian

Unioni Evropian është i hapur për secilin vend evropian, në qoftë se i përmbush kriteret për anëtarësim. Me zgjerimin, Unioni jo vetëm që e rrit sipërfaqen dhe popullsinë, por përpiket t'i kalojë të gjitha mosmarrëveshjet dhe konfliktet. Zgjerimi i Unionit Evropian është i një rëndësi të madhe, si për vendet, të cilat dëshirojnë të bëhen pjesë e Unionit, po ashtu edhe për vetë Unionin. Funksionimi i suksesshëm i Unionit Evropian gjatë dekadave të fundit e vërtetoi idenë se vetëm “Evropa e bashkuar” mund të nënkuptojë edhe “Evropë të fuqishme”.

Me zgjerimin e Unionit dhe futjen e vendeve anëtare të reja rritet zona e paqes, demokracisë, stabilitetit dhe prosperitetit, ku rritet edhe siguria e popujve në Evropë. Zgjerimi i Unionit Evropian domethënë edhe rritje e fuqisë ekonomike dhe hapjen e vendeve të reja të punës në vendet anëtare të vjetra dhe të reja të Unionit. Me hyrjen në UE qytetarët e fitojnë mundësinë që papengesë të udhëtojnë, mësojnë dhe punojnë gjithkund nëpër Union, e përmirësojnë kualitetin e jetës. Zgjerimi i Unionit Evropian me vende anëtare të reja, domethënë edhe rritje e pasurisë kulturore dhe diversitetit, mundësi për këmbim të ideve dhe mirëkuptim më i mirë ndërmjet popujve.

Kontrolloni njohurit e juaja dhe përdorni ato



1. Cilat janë vlerat e Unionit Evropian sipas të cilave përcaktohet identiteti i tij?
2. Cilat janë përfitimet nga zgjerimi i Unionit Evropian?

Maqedonia si pjesë e familjes evropiane

Fitimi i statusit “vendi kandidat” për anëtarësim në Unionin Evropian e vërteton faktin se Maqedonia paraqet pjesë përbërëse të Evropës dhe atë jo vetëm gjeografikisht. Rruga e përbashkët nëpër histori me popujt e Evropës, si dhe pjesa e madhe e Maqedonisë në trashëgiminë e pasur kulturore të Evropës flasin për atë se vendi i Maqedonisë, padyshim, është në Evropë.

Si shumë vende të tjera, po ashtu edhe Republika e Maqedonisë dëshiron të jetë pjesë e Unionit Evropian. Qysh në pavarësimin e saj, ajo u përcaktua për integrim në strukturat dhe institucionet euroatlantike. Rrugën drejt këtyre integritimeve, Republika e Maqedonisë e filloi në vitin 1995, kur u vendosën raportet diplomatike me të dy integritet euroatlantike: Unionin Evropian dhe NATO. Në vitin 2000 Këshilli i Evropës dërgoi direktivat për bisedime me Republikën e Maqedonisë në lidhje me Marrëveshjen për stabilizim dhe asocim, kurse në vitin 2001 në Luksemburg ishin përfunduar bisedimet dhe ishte nënshtruar marrëveshja. Kuvendi i RM-së e ratifikoi këtë marrëveshje, kurse më vonë e ratifikuan edhe parlamentet e të gjithë anëtarëve të Unionit.

Proceset e integritimit të Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian kërkojnë një angazhim të madh dhe bashkim të të gjitha resursve në dispozicion dhe duke i ikur qasjes së partizuar. Prandaj, u imponua nevoja nga riorganizimi i institucioneve të sistemit dhe mbështetje të fortë nga qytetarët e Maqedonisë.

Hapi i parë më i madh politik drejt eurointegritimeve u bë në vitin 1997 me themelimin e Komunitetit për integrim evropian. Ky trup është nën udhëheqësinë e drejtpërdrejtë të premierit të Maqedonisë, kurse e përbëjnë të gjithë ministrat, guvernatori i Bankës Popullore të Maqedonisë dhe kryetari i AMSHA (Akademia Maqedonase e Shkencës dhe Artit).

Më vonë u formuan edhe trupa të tjerë në Qeveri dhe në Kuvend, të obliguar për zbatimin e politikës për integrimin e Maqedonisë në UE.

Me anëtarësimin në Unionin Evropian, vendi do të ketë përfaqësuesit e vet në të gjitha institucionet e saj. Ata do t'i përfaqësojnë interesat e Maqedonisë, por edhe do të përkushtohen për zhvillim të mëtutjeshëm të Unionit.

Për t'u realizuar kjo, vendi ynë duhet të bëjë një numër të madhe të reformave me të cilat do të afrohet me standardet e Unionit Evropian. Maqedonia do të dihet t'i përmbush të gjitha detyrimet të cilat dalin nga Marrëveshja për stabilizim dhe asocim në afat sa më të shkurt, nëse dëshiron të gjendet në Unionin Evropian.

Maqedonia duhet të zhvillohet në frymën e vlerave evropiane. Ajo duhet të vendosë paqe dhe siguri të vazhdueshme për territorin e vet, ta përforcojë demokracinë, të mundësojë kushte për sundimin e së drejtës dhe të drejtësisë. Duhet të bëjë përpjekje të mëdha për të rritur zhvillimin e saj ekonomik, t'u sigurojë qytetarëve mbrojtje më të mirë sociale, e cila do të ketë zhvillim të qëndrueshëm. Republika e Maqedonisë duhet të gjejë mënyra si ta reduktojë papunësinë dhe ndotjen e mjedisit jetësor. Vetëm kështu dielli i ynë do të bëhet yll i flamurit të Unionit Evropian.

Kontrollojini njohuritë tuaja
dhe përdorini ato



1. Çfarë duhet të bëjë Republika e Maqedonisë që të bëhet anëtare e Unionit Evropian?
2. Pasi të bëhet anëtare e Unionit, cilat janë përfitimet e Republikës së Maqedonisë?
3. Cili është kontributi juaj që të mundë Maqedonia të bashkohet në familjen evropiane?

Maqedonia në Evropë dhe në botë

Vendi ynë gjendet në mesin e Evropës, në gadishullin Ballkanik i cili çdoherë ka qenë i rëndësishëm, por jo edhe regjion i zhvilluar dhe i qetë në Evropë. Edhe në përmasa evropiane edhe në atë botërore, Maqedonia është shtet i vogël dhe relativisht jo i zhvilluar. Ai është shteti, i cili nuk ka dalje në det dhe nuk ka potenciale të pasura natyrore, të mallrave të papërpunuara dhe potenciale energjetike. Por, në Evropë dhe në botë,



vendi ynë është i njohur për politikën e tij paqësore, për luftën e tij për liri dhe për trashëgiminë kulturore, për marrëdhëniet e mira ndëretnike dhe posaçërisht për potencialin krijues njerëzor.

Dihet se Maqedonia rrethohet me monumente të rëndësishme kulturore dhe historike të cilat dëshmojnë për të kaluarën e saj të famshme. Gjithashtu, është e njohur se shkrim leximi sllav dhe arsimimi prej këtu filloi të përhapet në Evropë, posaçërisht me veprimtarinë e Shën Qirilit dhe Metodit, pastaj me Shën Klimentin dhe Shën Naumin, të cilët ishin themelues të Universitetit të Ohrit, njëri ndër universitetet më të vjetra në Evropë. Veprat e piktorëve, piktorëve afreske dhe zdrukthtarët mesjetarë maqedonas edhe sot janë shumë të njohur në botë, gjithashtu edhe arkitektura, zejtaria dhe arti kishtar maqedonas. Kryengritja e Ilindenit dhe luftërat çlirimtare, të cilat i kanë udhëhequr të parët tanë janë padyshim të njohur në Evropë dhe në botë. Prandaj, Maqedonia i përket prej më përpara kulturës dhe civilizimit evropian.

Por, për shkak të shumë arsyeve historike, bile nga krijimi i shtetit në vitin 1944 dh posaçërisht nga pavarësimi i saj i plotë, si shtet i pavarur dhe sovran, në vitin 1991. Maqedonia në mënyrë aktive paraqitet në skenën ndërkombëtare dhe në politikë.

Në vitin 1993 Republika e Maqedonisë ishte pranuar në Kombet e Bashkuara dhe menjëherë pastaj në të gjitha organizatat dhe agjencitë e saj. Në vitin 1995 pranohet edhe për anëtare në Këshillin e Evropës, në OSBE dhe në Partneritetin për paqe. Vendi ynë bashkëpunon ngushtë me Unionin evropian dhe ka lidhur marrëveshje për



bashkëpunim dhe tregti, kurse për një kohë të shkurtë duhet të bëhet edhe anëtare e Unionit Evropian. Kuptohet, synim i kamotshëm është Maqedonia të bëhet anëtare e barabartë e Unionit Evropian, në NATO dhe në të gjitha asociacionet integruese evropiane.

dhe bashkëpunimit me të gjitha vendet evropiane, në raporte të mira miqësore me vendet e regionit dhe të marrë pjesë në të gjitha iniciativat ndërkombëtare, marrëveshje dhe aktivitete, të cilat nuk hapin dhe nuk lidhin me Evropën dhe botën.

Në këtë rast do ta jap kontributin e plotë në Unionin Evropian, do të marr pjesë në politikat e saj, përfaqësi, gjyqësi, pushtet ekzekutiv dhe mbrojtje. Por, për t'u përfshirë plotësisht në Unionin evropian, vendi ynë duhet plotësisht ta harmonizojë dhe ta përshtatë rendin e brendshëm juridik dhe demokratik me atë të Unionit, të sigurojë edhe t'i mbrojë të gjitha të drejtat e plota të njeriut dhe liritë qytetare dhe t'u garantojë shkallë të lartë të rendit dhe sigurisë së qytetarëve të vet. Ende më me rëndësi është në mënyrë të shumëfishtë ta risë prodhimin, produktivitetin, kualitetin dhe konkurrencën e vet e të begative të veta, ta rrisë eksportin, ta pakësojë papunësinë dhe varfërinë e qytetarëve dhe të ketë barazi qytetare, paqe dhe bashkëpunim të qytetarëve nga të gjitha nacionalitetet, religjionet dhe shtresat.

Sa është Maqedonia e rëndësishme si vend evropian edhe më tutje e drejton dhe e realizon politikën e vet të pasjes

Detyrë



Shkruani një ese në temë – Maqedonia në Evropë dhe në botë. Udhërrëfyes nëpër ese le të jenë këto çështje:

1. Si do të ishte jeta e qytetarëve maqedonas kur Maqedonia do të bëhej anëtare e Unionit Evropian?
2. Cilat do të ishin përfitimet e të rinjve nga anëtarësimi i Maqedonisë në Unionin Evropian?



Fjalori terminologjik

A **Aksion humanitar** – ndihmë e organizuar, e cila ka për qëllim zbutjen e vuajtjeve të njerëzve si pasojë e konfliktit ose katastrofës natyrore (tërmet, epidemi, thatësi, vërshime, vullkan).

Aksionar - pronar i aksioneve në ndonjë ndërmarrje industriale ose tregtare në kapitalizëm.

Aparhejt – politika e segregacionit racor (ndarje) sipas racës dhe ngjyrës, të cilën e zbatonte pakica e bardhë mbi popullsinë afrikane në Republikën e Afrikës së Jugut.

Asocim – shoqatë, lidhje, përafrim

Autoritet – reputacion, ndikim i ndonjë personaliteti, drejtori, parim, ligj, mendim që ka për ndonjë personalitet tjetër, e cila është fituar në bazë të vlera të pranuara në përgjithësi

B **Biznes** – aktivitet i punës ose profesionin, të cilin e ushtron personi si detyrë ose mënyra për të fituar mjete për jetë.

Buxhet – shqyrtim i të ardhurave dhe shpenzimeve të një subjekti, individi, institucioni, shteti (sot institucioni financiar me të cilin financohen veprimtaritë e shtetit).

Ç **Çift martesor** – burrë dhe grua në bashkësi martesore

D **Demant** – deklaratë me të cilën mohohet saktësia për lajmin e publikuar.

Demografi – shkenca, e cila merret me studimin e popullsisë (strukturën, lëvizjen, rritjen natyrore, natalitetin, mortalitetin).

Demokraci – pushtet i popullit, barazi dhe e drejta e çdo qytetari të marrë pjesë në vendosjen për punët publike dhe shtetërore.

Demokracia kushtetuese – shoqëria demokratike në të cilën me kushtetutë garantohen të drejtat dhe liritë e qytetarëve.

Diktaturë – formë e qeverisjes e individit ose grupit më të ngushtë me pushtet të pakufizuar, i cili në të shumtën e rasteve fitohet në rrethana të jashtëzakonshme shoqërore (goditje shtetërore, grushtshtet dhe të ngjashme).

Dinjitet - të qenit i trajtuar me respekt.

Diskriminim – sjelljes jo e drejtë ndaj individëve ose grupeve; marrja ose heqja e disa të drejtave nga të drejtat dhe liritë që i gëzon shumica.

E Ekonomi – rregulla të punës së bizneseve të veçanta; aftësi të menaxhimit me biznesin; aftësi për të fituar begati të nevojshme për jetën dhe të dobishme për amvisërinë.

Entocentrizëm – qëndrim i frymëzuar me emocione dhe paragjykime, se grupi i vet, raca, shoqëria është superiore me cilësitë racore dhe kulturore në raport me të tjerët.

G Grup etnik – grup anëtarët e së cilës i lidh ndjenja e përkatësisë së përbashkët e ndërtuar në bazë të jetës në territor të përbashkët, gjuhë të përbashkët, religjion, traditë, zakone, kulturë.

Grupim – lidhje e njerëzve, bashkëveprimi social që nuk është i organizuar dhe për këtë shkak nuk formohet grup, por ka karakteristika të ngjashme me grupin.

I Ideologjia – sistem i të kuptuarit, supozime dhe nocione me të cilat shprehet pikëpamja e përgjithshme e ndonjë grupi për gjithë atë çka është punuar rreth saj në sisteme religjioze, filozofike dhe shkencore.

Industria – formë e organizuar dhe e rregulluar e raporteve të përbëra dhe të shumta që bëjnë pjesë njerëzit duke kryer aktivitetet të caktuara shoqërore.

K Karrierë – ngritje të suksesshme, avancim në fushën e veprimtarinë shoqërore, të punës, shkencore dhe të tjera veprimtari.

Koalicion – lidhje politike ose ushtarake të shteteve, partive politike ose grupeve më të ngushta sociale për aksion të përbashkët ose për arritjen e një synimi të përbashkët.

Konflikt – ndeshje, grindje, zënka, ndeshje e armatosur.

Konventë – kontratë ndërkombëtare me të cilën rregullohet një tërësi e raporteve ndërkombëtare.

Kunved (parlament) – ekziston në të gjitha demokracitë kushtetuese, organ më i lartë përfaqësues, kuvendi organ më i lartë i pushtetit, që sipas rregullës zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme.

Kushtetutë – akti më i lartë shtetëror i një shteti, rrjedh nga fjala latine *constitutio*, që tregon ligj të rëndësishëm më të lartë.

L Luftë – akti dhune i ndërmarrë, me qëllim që pala kundërshtare të detyrohet të përmbushë vullnetin e dikujt.

M **Marrëveshje** – kontratë ndërmjet dy ose me tepër shteteve në të cilat rregullohen raportet e tyre politike, ekonomike dhe kulturore ndërmjet veti.

Martese - bashkësi personash të gjinisë së kundërt, e bazuar në marrëdhënie dhe lidhje të vazhdueshme dhe marrëdhënie të pranuar në përgjithësi dhe marrëdhënie tjera shoqërore

Mas-mediume – mjete për komunikim (gazeta, revista, libra, radio, televizion, Internet)

Mendim publik – mendimi, qëndrimi i një grupe të caktuar ose bashkësi globale shoqërore e cila formohet për ndonjë fenomen ose çështje të interesit të grupeve shoqërore ose shoqërisë në tërësi.

O **Organizatë humanitare** – organizatë e cila merret me zgjidhjen e problemeve humanitare;

P **Perëndi** – qenie me cilësi mbinatyrore

Pluralizmi politik – sistem politik në të cilin ekzistojnë më tepër subjekte të pavarura partiake të cilat shprehin interesa, programe, përcaktime të ndryshme.

Popullsia aktive – të gjitha personat që kryejnë ndonjë profesion, si dhe personat, të cilët për shkak të arsyeve të caktuara, nuk janë në gjendje të kryejnë detyrën.

Premier – Ministri i parë, Kryetari i qeverisë

Prona – përmblendhje e begative të lëvizshme dhe të palëvizshme materiale dhe të gjitha të drejtat dhe obligimet që i takojnë individit ose grupit, dhe të cilat mund të shprehen në të holla.

Pronësi në grup – formë e pronësisë kolektive mbi mjete për prodhim, ku si pronarë paraqitet ndonjë grup parciale shoqërore

Publik – grup i qytetarëve, të cilët relativisht gjatë marrin pjesë në jetën shoqërore dhe politike të një shoqërie, kurse në raportin e vet aktiv e shprehin përmes qëndrimeve politike.

Pushtet – e drejta e drejtimit, posedimi i fuqisë politike, juridike dhe fuqisë ekonomike të shtetit

Q **Qeveria** – të gjitha organet shtetërore, të cilat kanë pushtet, organ administrativ – ekzekutiv

Qytetarë – përmblendhje e pjesëtarëve të një shteti ose persona, të cilët banojnë në një territor të caktuar dhe janë bartës të së drejtave, lirive dhe obligimeve të caktuara në shtet

Shoqëri aksionare- lloji i ndërmarrjes kapitaliste, kapitali i së cilës është i ndarë në pjesë të barabarta (aksione) të cilat në lloj të letrave me vlerë i blejnë kapitalistët, punëtorët më të pasur, shteti ose të tjerë, të cilët bëhen pronarë të ndërmarrjes, marrin pjesë në menaxhimin e saj dhe në shpërndarjen e profitit.

Shtet – formë themelore dhe më e rëndësishme e organizimit politik në shoqëri.

Sistem/rend juridiko-politik – mënyrë e organizimit të pushtetit në një shtet (organizatat, institucionet, kultura politike) dhe të ngjashme.

Sjellje devijante – sjellje, e cila vepron në mënyrë shkatërrimtare në shoqëri, e cila heq dorë nga normat e konstatuara nga bashkësia shoqërore dhe e cila tërheq reaksion shoqëror.

Sovranitet/sovran – pavarësi shtetërore, pavarësia e shtetit vetë t'i rregullojë punët e brendshme dhe raporteve me shtetet tjera.

Vepër humane – mbrojtja e jetës së dikujt dhe dinjitetin ose ndihma ndaj dikujt, që zakonisht nuk i jepet.

Votimi – të shprehurit e vullnetit ose të mendimin, në zgjedhje, me dhënien e votës për një kandidat të caktuar të grupeve shoqërore, organizatave dhe të ngjashme (me deklaratë formale ose me ndonjë shenjë).

Votues – person i cili ka të drejtë vote, i cili e realizon të drejtën e vet aktive me dhënien e votës (“për” ose “kundër”) ndonjë kandidati.

Literatura e shfrytëzuar

1. Група автори, Граѓанско образование за средни стручни училишта, Скопје:Биро за развој на образованието, 2002
2. Ѓуровска, д-р Милева, Социологија, Филозофски факултет, Скопје, 2006
3. Мирчев, д-р Димитар, Трајкова, Гордана, Социологија за втора година средно образование, Македонска искра, Скопје, 2003
4. Трајковски, д-р Ило, Глобализирањето, индивидуалноста и општеството, Универзитет "Св. Кирил и Методиј", Филозофски факултет, Скопје, 2006
5. Gollob, Rolf and Krapf, Peter, Prirucnik za obrazovanje za demokratiju i ljudska prava, Vjese Evrope, Stasbourg i Sarajevo, 2005
6. Група автори, Истражување на меѓународното хуманитарно право, Биро за развој на образованието, Скопје, 2007
7. Граѓанско образование, прво издание, центар Отворено општество, 1995
8. We the people, project of the Centar for Civic Education, Calabasas, 1998
9. Донели, Џек Меѓународни човекови права, Книгоиздателство МИ-АН, Скопје, 2004
10. Петровски, д-р Добри, Демократија и граѓанско образование, Педагошки факултет, Битола 2003
11. Трајковски, д-р Ило, Политика на човековите права, Филозофски факултет, Скопје, 2005
12. Угриновски, Ксенофон, Социологија за стручно образование, Македонска искра, 2006
13. Група автори, Социолошки термилошки речник, Институт за социологија, Филозофски факултет, Скопје, 1995